

Familjarët
Shërbimi sekret
e montoi
"Monstrën"

Fq.5



**SEANCA
NGA FILLIMI**
Për Alimirin,
Jovevski nuk
dallon nga Zverlevski

Fq.4



Babai i
WEB-it
jep
alarmin!

Tim Berners-Lee

Fq.13



Koha

www.koha.mk



Asgjë e re për
Mançesterin

Fq.22

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3317 · e enjte 15 mars, 2018

0°C | +6°C

15 DEN

FORUM

Trajçe



Ndjesia e të qenurit i lirë është e shenjtë. Ti atë liri mbase dhe nuk do ta përdorësh ndonjëherë, por vetë ideja se s'ke ndalesë, të jep qetësinë. Shqiptari është i lidhur shumë ngushtë me gjuhën, lirinë e percepton nëpërmjet saj, sepse ajo i është ndaluar në vazhdimësi, ndërkohë ajo është bartësi kryesor i gjenezës tonë. Në kontekst modern, një shërbim më shumë në shqip, vetëm do sjellë një qetësi më shumë. E bëj këtë analogji, sepse jam i bindur, si në shumë rrethana të tjera, se e drejta dhe liria që... Fq.10

RAJON

Plani amerikan për Kosovën

Fq.14

PROFILE

Përse Trumpi largoi Tillersonin

Fq.13

DOSSIER

Bugsy, lumë gjaku dhe parash

Fq.12



MIRATOHET LIGJI I GJUHËVE, VMRO-DPMNE TENSIONON SEANCËN

SHQIPJA ZYRTARE



Miratimi i Ligjit ndodhi në një situatë plotë tensione, ndërsa ishte sigurimi i Parlamentit ai që pengoi një përplasje fizike mes kryeparlamentarit Talat Xhaferi dhe ish-kreut të VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski. Gruevski u ngjit lartë në foltore dhe i kërkoi Xhaferit ta ndërpresë punën e Parlamentit, ndërsa i dershi gotën me ujë dhe arriti t'ia marrë kartelën elektronike për votim Fq.3

Shqiptarët dyfish më pak shkolla se maqedonasit

Shkup, 14 mars - Ndryshimi i kushteve në të cilat shkollohen nxënësit varësisht gjuhës në të cilën e zhvillojnë mësimin - nuk është vetëm një perceptim mbi bazën e paraleleve të ngarkuara më tepër se sa duhet apo edhe të shkollave që punojnë në dy dhe tre ndërrime kur janë në pyetje nxënësit shqiptarë. Ky fakt verifikohet edhe me të dhënat zyrtare të Entit Shtetëror të Statistikave (ESHS) në analizën

mbi numrin e shkollave dhe hapësirave që ndajnë nxënësit në rajone të ndryshme. Nëse krahasohen rajoni i Pollogut me kryeqendër Tetovën dhe ai i Pellagonisë me kryeqendër Manastiri, do të vijmë në konstatimin se rajoni i parë (i banuar kryesisht me shqiptarë) ka dyfish më pak hapësira shkollore se rajoni i dytë (i banuar kryesisht me maqedonas). Për rrjedhojë nxënësit shqiptarë... Fq.4



EDITORIAL

"LUFTËRAT HIBRIDE"



Emin AZEMI

Vrasja në rrethana të dyshimta e ish agjentëve ruse në truallin britanik, mund të prishë statusquon e rrejshme midis Perëndimit e Rusisë. Tash së fundmi, kryeministria Theresa May i ka dhënë afat Rusisë që të përgjigjet në lidhje me përfshirjet e sigurimit sekret rus në rastet e dyshimta të helmimit të spiunit Sergei Skripal dhe vajzës së tij Yulia. Në rast se Moskë refuzon këtë kërkesë të Londrës, ka të ngjarë që kryeministria britanike të nisë një luftë të fuqishme ekonomike, e cila parasheh sanksione radikale, që mund të përfundojnë edhe me bojkotimin e kampionatit botëror të futbollit që do të mbahet sivjet në Rusi.

Në vllugun e këtyre përplasjeve të mëdha, pashmangshëm ndodhet edhe rajoni ynë. "Propaganda serbe kundër shqiptarëve, sidomos Kosovës, është shtuar. Britanikët paralajmërojnë keqësim të mëtejshëm të marrëdhënieve me Rusinë. Nëse keqësimi i situatës vazhdon, Kosova do të jetë vendi ku do të 'thyhen shtizat' britanike dhe ato Perëndimore kundër Rusisë", ka shkruar studiuesi nga Londra, Daut Dauti, në profilin e tij në FB. Ai ka përsëritur edhe maksimën e njohur të ish sekretarit britanik të NATO-s, Lord Roberston, 'NATO in, Serbia out' (NATO brenda, Serbia jashtë). Daut Dauti është i mendimit se Robertson dhe të gjithë zyrtarët britanik duket se janë të mendimit që kjo maksimë duhet të vazhdojë. Britanikët ende e konsiderojnë Kosovën si projekt të tyre dhe të përbashkët me Perëndimin. Ekziston një dro se si do ta konsideron Donald Trump situatën e re me Rusinë dhe si do ta cilësojë ai 'Projektin Kosova'. Ndërkohë shumë qendra studimi dhe institute të specializuara kanë paralajmëruar se përdorimi i teknikave të fshehta nga ana e Rusisë në disa shtete ish-sovjetike dhe në Ballkan shpërfaq nevojën që NATO-ja të përgatitet për "luftëra hibride". Në qendër të këtyre paralajmërimeve vihet në dukje se aksionet destabilizuese të Rusisë kanë emërues të përbashkët "luftën hibride" të saj e cila përfshin "fushata të sofistikuara që kombinojnë operacione të nivelit të ulët dhe speciale; aksione kibernetike dhe operacione psikologjike". Tani për tani, kanosje më të drejtpërdrejt ruse, po përjeton Ukraina, prandaj jo rastësisht Presidenti ukrainas, Petro Poroshenko, ka akuzuar Moskën për "luftë hibride në botë", derisa i ka bërë thirrje Perëndimit të rrisë presionin mbi Kremlinin për ndikimin e saj në Ukrainë. Poroshenko, i ka bërë këto akuza në fjalimin e tij të mbajtur në konferencën për siguri që u mbajt javë më parë në Mynih dhe ai ka akuzuar Moskën, që sipas tij po kërkon të shkatërrojë demokracinë e Ukrainës dhe atë Perëndimore. Sikundër dihet Lufta Hibride përbëhet nga: atakët kibernetike (cyberattacks), propaganda për të nxitur panikun dhe pasigurinë dhe protestat, futjen e forcave speciale pa shenja përkatëse për të provokuar dhunë në shkallë të kufizuar e vetëm në ato zona që kërkohen. Një test-provë Rusia e kishte manifestuar në Gjeorgji dhe në Ukrainë, por edhe në Estoni në shtator të 2014, kur një grup i vogël i forcave të sigurimit rus u futën papritur brenda kufijve të Estonisë dhe rrëmbyen një oficer të inteligjencës estoneze. Sipas raporteve të mëvonshme doli që qëllimi i kësaj ndërhyrje ishte destabilizimi i vendeve baltike. Kërcënimet hibride në kohët moderne në Ballkanin Perëndimor dhe ndikimi rus në Maqedoni dhe rajon, nuk e ka patur përgjigjen e duhur të shoqërive përkatëse, të cilat më tepër janë marrë me frustrimet që ka prodhuar politikbërja e keqe në këto vende. Por, tash më është fakt që Rusia gjithnjë e më tepër po tenton që të shtrijë influencën e saj në rajone të ndryshme të botës duke përfshirë edhe Ballkanin perëndimor përmes mjeteve të ndryshme dhe kjo dëshmon se në fakt Rusia asnjëherë nuk është tërhequr nga ky rajon. Mjafton të përkujtojmë situatën e krijuar me trenin e nisur nga Serbia me mbishkrime drejtuar kundër Republikës së Kosovës. Ky tren ishte ardhur nga Rusia dhe porosia ishte e qartë. Betejat kundër "luftërave hibride" ruse nuk mund të fitohen me këto politika hermaphrodite të BE-së kundrejt Ballkanit Perëndimor. Shoqëritë e dala nga tranzicioni stërgjatur, tash më nuk po munden ta kalojnë situatën postraumatike dhe kanë nevojë për një qartësi më të madhe në qasje dhe në veprim të Brukselit. Objektivi i BE-së për ta favorizuar vetëm Serbinë, si kundërvënien Rusisë, në këtë rrugëtim të vështirë euroingerues, mund të ketë mirëkuptim përderisa kjo qasje nuk zgjerohet duke e futur gjithë rajonin në të njëjtën dioptri. Në të kundërtën gjithë betejat e BE-së kundër "luftërave hibride" ruse mund të përfundojnë në manovra shkollore me fishekë të lagur.



MOS PËSHYNI NË PUSIN E VJETËR

"Shumë kohë përpara, prindërit tonë mendjendritur, thoshin: 'nëse hapni një pus të ri dhe pini nga uji i tij, bëni kujdes...', mos pëshytni në pusin e vjetër!' Ç'është e vërteta, sot, disa harrestarë të mëdhenj, lëre që pëshytnë por edhe urinojnë në to!. dikur, në kopshtin e vogël të gjyshit tim, kishte patur një bunar shumë të vockël. E kishin dhe e mbanin për sevap. Shumë kohë më vonë, në mënyrë të çuditshme, pusi ishte shter! sa gjynah!.. ehe, sa dehumane dhe denigruese kjo thënie që llafos këtë vaki!", shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti Fadil Lushi.

KOSOVA NË MES PERËNDIMIT DHE RUSISË

"Promovimi i librit të biografisë së Hashim Thaçit që u bë të martën në Londër tërhoqi vëmendjen e gazetarëve, politikanëve, diplomatëve dhe ushtarakëve britanikë. Promovimi u bë në ditën kur kryeministria britanike, Theresa May, i dha afat Rusisë që të përgjigjet në lidhje me përfshirjet e sigurimit sekret rus në rastet e dyshimta të helmimit të spiunit Sergei Skripal dhe vajzës së tij Yulia. Vdekja e Nikolai Glushkovit, një rus tjetër britanik, e cila duket se është poashtu vrasje, e vështirëson edhe më tej situatën. Merret vesh që Theresa May është duke planifikuar 'Luftë Ekonomike'. Sanksionet ka mundësi të jenë radikale sa që është e mundur edhe bojkotimi i kampionatit botëror futbollistik që do të mbahet sivjet në Rusi. Prandaj, kjo ishte arsyeja që Kosova, në mënyrë të konsiderueshme, ishte temë e fjalimeve, debatit dhe bisedave private që u zhvilluan gjatë promovimit të librit në fjalë. Tani më është publike përzjerja e Rusisë në Ballkan. Propaganda serbe kundër shqiptarëve, sidomos Kosovës, është shtuar. Britanikët paralajmërojnë keqësim të mëtejshëm të marrëdhënieve me Rusinë. Nëse keqësimi i situatës vazhdon, Kosova do të jetë vendi ku do të 'thyhen shtizat' britanike dhe ato Perëndimore kundër Rusisë. Ish Sekretari i NATO-s, Lord Robertson, në fjalimin e rastit e përsëriti maksimën e tij të njohur 'NATO in, Serbia out' (NATO brenda, Serbia jashtë). Robertson dhe të gjithë zyrtarët britanik duket se janë të mendimit që kjo maksimë duhet të vazhdojë. Britanikët ende e konsiderojnë Kosovën si projekt të tyre dhe të përbashkët me Perëndimin. Ekziston një drojë se si do ta konsideron Donald Trump situatën e re me Rusinë dhe si do ta cilësojë ai 'Projektin Kosova', ka shkruar në profilin e tij në FB, studiuesi nga Londra Daut DAUTI.



RAMA, IDIOT DHE HAJDUT I CERTIFIKUAR

"Flitet për skenare ruse, shantazhe ruse, ndërhyrje ruse. Një rus i madh Dostojevski ka shkruar një kryevepër "Idioti", por te një idioti te dobishëm. Kemi edhe ne një idiot, por tërësisht te padobishëm e kemi dhe ne krye te qeverise. Por ju mos ja përmendni idiotësinë se këtë alibi do ai, qe te thonë 'vjedh se është idiot dhe nuk kupton'. Por në fund prapë se prapë mbetet idiot dhe hajdut i certifikuar. Kërshërinë që ta merrim vesh se është idiot na e shoi vite më parë Mero Baze, një profesionist i njohur i gazetarisë, që në shërbim të transparencës publikoi edhe kartelën e tij mjekësore", shkruan në Facebook kreu i Grupit të LSI, Petrit Vasili.



NËSE NUK E KENI DITUR...

ÇFARË KA QENË BASHTINA?

Bashtina ka qenë kategori e pronës tokësore në zotërim vetjak gjatë mesjetës. Zotëruesi i bashtinës (bashtinari), që kishte të drejtë ta shiste ose ta linte trashëgim, ishte i ngarkuar me disa shërbime kundrejt kryezotit feudal. Me zhvillimin e marrëdhënieve feudale, bashtina që punohej nga zotëruesi fshatar,

MEDIACitate

Në pritje të konfirmimit nga Lista Serbe, zyrtarë të partive në pushtet kanë vazhduar me deklaratat optimiste se gjatë kësaj jave do të ratifikohet Marrëveshja e demarkacionit me Malin e Zi. Vetë deputetët e subjektit kryesor serb në Kosovë nuk kanë pranuar të flasim për këtë çështje. Deputeti Slavko Simiq, i cili gjendej në Kuvendin e Kosovës të enjten, ku është mbajtur seanca plenare me pika të tjera, nuk është përgjigjur nëse janë marrë vesh me koalicionin qeverisës për ta votuar demarkacionin. Marrëveshja e arritur mes koalicionit qeverisës dhe partisë opozitare-LDK është e pamjaftueshme për t'i siguruar dy të tretat.

(Koha Ditore, 14 mars)

Ishte një rrugë e gjatë kësaj here, por kancelarja Angela Merkel arriti të zgjidhet në mandatin e katërt nga Bundestagu, gjashtë muaj pas zgjedhjeve parlamentare në Gjermani. Të mërkurën (14.03), 364 deputetë nga 709 gjithsej i dhanë votën kancelares Merkel. Shumica e kërkuar ishte 355 vota. Në votimin e fshehtë, Merkel mori 35 vota më pak se 399 vendet e aleancës qeveritare mes CDU/CSU dhe Partisë Socialdemokrate, SPD: Rizgjedhja e Merkelit u bë e mundur pas koalicionit me socialdemokratët dhe votës Po të bazës së Partisë Socialdemokrate më 4 mars. Tani qeveria e re mund të fillojë nga puna. Sfidat më të madhe konsiderohet aktualisht përplasjet tregtare me SHBA, pas vendimit të Donald Trump për vendosjen e doganave ndaj çelikut dhe aluminit të importuar.

(DW, 14 mars)

Ambasadorja e Shqipërisë në Bashkimin Europian, Suela Janina, në një intervistë për Europeanësternbalkan, thotë se Shqipëria pret të marrë rekomandimin e pakushtëzuar për çeljen e negociatave në prill. "Shqipëria pret hapjen e negociatave të anëtarësimit me BE-në brenda këtij viti. Shpresojmë të marrim një rekomandim të pakushtëzuar për çeljen e bisedimeve në raportin e Komisionit Europian në prill, dhe presim që Këshilli i BE në qershor të miratojë vendimin për hapjen e negociatave", thotë Janina. Duke folur për strategjinë e miratuar në shkurt nga instancat e BE-së, Janina thotë se më shumë se komentimi, tani është koha të adresohen pa vonesë veprimet.

(Gazeta Shqip, 14 mars)

kaloi bashkë me të nën vartësinë e një feudali të veçantë. Në periudhën osmane bashtina ishte ajo pjesë e tokës në pronësi të shtetit osman që u ishte lënë në përdorim fshatarëve raja të krishterë. Me emrin "bashtinë" quheshin deri në shek.XVI edhe tokat që i ishin lënë në përdorim shtresës së ushtarakëve të vegjël kundrejt shërbimeve ushtarake të caktuara.



Na shqetësojnë kërcënimet ndaj gazetarëve

Shkup, 14 mars - Dënojmë akte të dhunës dhe kërcënime ndaj gazetarëve, në demokraci nuk ka vend për gjëra të këtilla, të cilat e pengojnë luftën për liri të shprehjes dhe lirinë e mediave. Këtë të mërkurën e deklaroi ambasadori amerikan Xhes Bejli në pyetjen e gazetarëve gjatë forumit të parë vjetor të kryetarëve të komunave në organizim të Korpusit paqësor të SHBA-së në Maqedoni dhe Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale. "Shikoni ndonjëherë se deri ku mund të shkojnë gjërat, duke i pasur parasysh ngjarjet e pahijshme të paradokoshme në Sllovaki. Kjo është diçka që duhet të shqetësojë edhe këtu në Maqedoni, por edhe në gjithë botën. Njëkohësisht, incidentet fillestare të cilat sollën deri në krijimin e kësaj situatë shumë thonë për gjendjen e mosndëshkimit dhe është shumë e rëndësishme që liderët t'i respektojnë standardet e larta në pikëpamje të qeverisjes së të drejtës", tha Bejli. (O.Xh)

NË NJË SEANCË PLOTË ME TENSIONE DHE ULËRIMA



MIRATOHET LIGJI I SHQIPES

Miratimi i Ligjit ndodhi në një situatë plotë tensione, ndërsa ishte sigurimi i Parlamentit ai që pengoi një përplasje fizike mes kryeparlamentarit Talat Xhaferi dhe ish-kreut të VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski. Gruevski u ngjit lartë në foltore dhe i kërkoi Xhaferit ta ndërpresë punën e Parlamentit, ndërsa i dershi gotën me ujë dhe arriti t'ia marrë kartelën elektronike për votim



Shpresë nga vizita e Koxiasit

Shkup, 14 mars - Vizita e ministrit të Punëve të Jashtme të Greqisë, Nikos Koxias në Maqedoni, e cila pritet javën e ardhshme, është hap para në lëvizjen drejt zgjidhjes përfundimtare të kontestit, deklaroi zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski. Ai potencoi se data e saktë e ardhjes së Koxiasit në Shkup ende nuk u konfirmua. I pyetur lidhur me deklaratën e kryeministrit, Zoran Zaev të dhënë gjatë konferencës së djeshme për shtyp me ndihmës sekretarin shtetëror amerikan për Evropë dhe Euroazi, Ues Miçel, se pret ndihmë nga SHBA-ja lidhur me kontestin me emrin, Boshnjakovski e përsëriti qëndrimin qeveritar se procesi për zgjidhjen e kontestit me emrin po udhëhiqet nën patronazhin e KB-së me ndërmjetësim të mediatorit Methju Nimic. "Çdo zgjidhje do të shkojë përmes ndërmjetësuesit Nimic. Zgjidhja do të arrihet me kompromis të përbashkët në interes të të dy palëve. Marrëveshjen që do ta arrijmë do të jetë kompromis i ndërsjellë i pranueshëm për të dy palët, zgjidhje dinjitoze. Ende nuk kemi ardhur në ndonjë fazë ku na nevojiten garanci për marrëveshjen", tha Boshnjakovski.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 14 mars - Me 64 vota "për" dhe asnjë kundër, Parlamenti i Maqedonisë e miratoi Ligjin për gjuhët, pa debat për 35.000 amendamentet e VMRO-DPMNE-së. Për Ligjin votuan deputetët shqiptarë si dhe ata nga bashkësitë joshumicë, të cilët me 24 vota e miratuan Ligjin. Deputetët e opozitës u përpoqën ta pengojnë votimin e Ligjit dhe të kërkojnë fjalim procedural, por ishte kryeparlamentari Talat Xhaferi ai që e ndërpreu seancën dhe me sigurimin doli nga salla plenare.

Paraprakisht gjatë tentimit të Xhaferit që ta hapë pikën, deputetët e opozitës kërkuan fjalë për drejtim procedural, por ai i injoroi dhe vazhdoi me punë, me ç'rast disa deputetë të VMRO-së, midis të cilëve edhe ish-lideri Nikolla Gruevski, dolën në foltore. Gruevski i dershi ujë Xhaferit ia nxori kartelën, me ç'rast Xhaferi ishte i detyruar të japë pauzë prej 15 minutave.

Miratimi i Ligjit ndodhi në një situatë plotë tensione, ndërsa ishte sigurimi i Parlamentit ai që pengoi një përplasje fizike mes kryeparlamentarit Talat Xhaferi dhe ish-kreut të VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski. Gruevski u ngjit lartë në foltore dhe i kërkoi Xhaferit ta ndërpresë punën e Parlamentit, ndërsa i dershi gotën me ujë dhe arriti t'ia marrë kartelën elektronike për votim.

Paraprakisht, koordinatori i grupit të deputetëve të VMRO-DPMNE-së, Dragan Danev, tha se deri te Xhaferi me shkrim do të dorëzojë dy kërkesa - edhe atë që Komisioni për çështje të mandatit të imunitetit dhe punës të debatojë se nëse ata kanë të drejtë të punës të dorëzojnë dhe të debatojnë për amendamentet për Ligjin për gjuhët dhe të vazhdimin të seancës së 32-të të hapet debat për mbi 35.000 amendamente për ligjin të dorëzuar nga ata. Xha-

feri në seancë plenare paralajmëroi se do të ketë takim me deputetët e VMRO-DPMNE-së që të dakordohen për rrjedhën e mëtejme të seancës dhe dha pauzë deri në orën 16. Por, nga grupi i deputetëve të VMRO-së informuan se takim nuk do të ketë, gjë që ashtu edhe ndodhi.

Që në fillim të seancës, në vërejtje procedurale Ilija Dimovski nga VMRO-DPMNE kërkoi të debatohet për ligjin e gjuhëve dhe seanca të ndërpritet, ndërsa Komisioni për çështje të mandatit dhe imunitetit të debatojë për të gjitha aspektet e lidhura me mbi 35.500 amendamente.

Dimovski potencoi se amendamentet e tyre kanë të bëjnë vetëm me 19-të nenet për të cilët presidenti i shtetit ka thënë se janë jokushtetuese. "Presidenti i shtetit me të drejtë të plotë të garantuar me Kushtetutë dhe prej mbi 550 mijë vota i vërejtjei Kuvendit se ligji që kaloi në fazë paraprake

është jokushtetues në 19 nene. Deputetët e VMRO-DPMNE-së dorëzuan amendamente jashtëzakonisht për këto nene për të cilët presidenti i shtetit vërejtje se janë jokushtetuese. Nuk ka asnjë amendament ndaj ndonjë neni të ligjit për të cilin presidenti i shtetit nuk pati vërejtje se është jokushtetues", tha Dimovski.

Ai duke iu referuar dokumentit të nënshkruar nga kryetari i Kuvendit Talat Xhaferi nga 22 janari në të cilin ai i ka njoftuar deputetët se mund të dorëzojnë amendamente më së voni deri më 27 janar të vitit 2018. ky dokument, sipas Dimovskit, tregon se deputetët kanë të drejtë të dorëzojnë amendamente për zgjidhjen e propozuar ligjore. Siç dihet, deri më tani gjuha shqipe ishte zyrtare në nivel lokal, në përdorimin e dokumenteve personale, ndërsa pati një avancim të ndjeshëm më ndryshimet ligjore të vitit 2011.

PROTESTË PARA PARLAMENTIT

Para Parlamentit të Maqedonisë dhjetëra qytetarë maqedonas, kryesisht të moshës së tretë, kanë protestuar tërë ditën kundër sjelljes së Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Protesta është zhvilluar qetë dhe pa incidente. Para Parlamentit, gjithashtu janë vërejtur forca të shumta të policisë.



Nëse krahasohet rajoni i Pollogut me kryeqendër Tetovën dhe ai i Pellagonisë me kryeqendër Manastirin, do të vijmë në konstatimin se rajoni i parë (i banuar kryesisht me shqiptarë) ka dyfish më pak hapësira shkollore se rajoni i dytë (i banuar kryesisht me maqedonas)

Koha

Laura PAPANIKU

Shkup, 14 mars - Ndryshimi i kushteve në të cilat shkollohen nxënësit varësisht gjuhës në të cilën e zhvillojnë mësimin - nuk është vetëm një perceptim mbi bazën e paraleleve të ngarkuara më tepër se sa duhet apo edhe të shkollave që punojnë në dy dhe tre ndërrime kur janë në pyetje nxënësit shqiptarë. Ky fakt verifikohet edhe me të dhënat zyrtare të Entit Shtetëror të Statistikave (ESHS) në analizën mbi numrin e shkollave dhe hapësirave që ndajnë nxënësit në rajone të ndryshme. Nëse krahasohen rajoni i Pollogut me kryeqendër Tetovën dhe ai i Pellagonisë me kryeqendër Manastirin, do të vijmë në konstatimin se rajoni i parë (i banuar kryesisht me shqiptarë) ka dyfish më pak hapësira shkollore se rajoni i dytë (i banuar kryesisht me maqedonas). Për rrjedhojë nxënësit shqiptarë nga njëra anë dhe nxënësit maqedonas nga ana tjetër mësojnë në kushte krejtësisht të ndryshme edhe atë me dallime drastike.

ESHHS PËR HAPËSIRAT QË NDAJNË NXËNËSIT

SHQIPTARËT DYFISH MË PAK SHKOLLA SE MAQEDONASIT



Duke i gjykuar vetëm në bazë të numrit të nxënësve të qyteteve kryesore, pra Tetovën dhe Gostivarin bashkë në njërin anë si dhe Manastirin dhe Prilepin në anën tjetër, i bie që të kemi 6382 nxënës përballë 3894 nxënësve. Shifrat tregojnë për një diferencë prej rreth 2500 nxënës, ndërsa të dyja rajonet kanë numër thujse të barabartë objektsh shkollore, pra 23 rajoni i Pellagonisë dhe 24 i Pollogut

Konkretisht, të dhënat e ESHS-së për ndarjen e hapësirave shkollore në nivelin e arsimit të mesëm për vitin 2016 tregojnë se në rajonin e Pellagonisë ka 23 objekte, në të cilat zhvillohet mësimi, kurse në rajonin e Pollogut - 24 objekte. Mirëpo, Tetova ka dyfish më tepër nxënës se Manastiri. Konkretisht, sipas Entit të Statistikave, në vitin shkollor 2016 vetëm Tetova kishte 4060 nxënës në shkollat e mesme, ndërsa Manastiri 2113 nxënës. Në rajonin e Pollogut bie edhe qyteti i Gostivarit me numër gjithashtu të madh nxënësish të shkollave të mesme, konkretisht me 2322 nxënës, kurse në rajonin e Pellagonisë - krahas Manastirit, qytet tjetër i madh është Prilepi me 1781 nxënës. Nëse i krahasojmë të dyja këta rajone, duke i gjykuar vetëm në bazë të numrit të nxënësve të qyteteve kryesore, pra Tetovën dhe Gostivarin bashkë në njërin anë si dhe Manastirin dhe Prilepin në anën tjetër, i bie që të kemi 6382 nxënës përballë 3894 nxënësve. Shifrat tregojnë për një diferencë prej rreth 2500 nxënës, ndërsa të dyja rajonet kanë numër thujse të barabartë objektsh shkollore, pra 23 rajoni i Pellagonisë dhe 24 i Pollogut.

shkollore, pra 23 rajoni i Pellagonisë dhe 24 i Pollogut. Shpërndarjejo e drejtë vërehet edhe në numrin e shkollave si subjekte juridike, ku në Tetovë dhe Gostivar kemi 11 subjekte juridike, ose njëlloj sa në Manastir dhe Prilep, pavarësisht faktit se kemi rreth 2500 nxënës më tepër. Rajoni me numrin më të madh të shkollave dhe objekte shkollore të mesme është ai i Shkupit, ku krahas 26 shkollave të rregullta të mesme, janë edhe katër shkolla speciale dhe dy shkolla të mesme

shkollore, pra 23 rajoni i Pellagonisë dhe 24 i Pollogut. Shpërndarjejo e drejtë vërehet edhe në numrin e shkollave si subjekte juridike, ku në Tetovë dhe Gostivar kemi 11 subjekte juridike, ose njëlloj sa në Manastir dhe Prilep, pavarësisht faktit se kemi rreth 2500 nxënës më tepër.

Rajoni me numrin më të madh të shkollave dhe objekte shkollore të mesme është ai i Shkupit, ku krahas 26 shkollave të rregullta të mesme, janë edhe katër shkolla speciale dhe dy shkolla të mesme

fetare. Vijnë pas saj rajoni i Pollogut (24), Pellagonisë (23), rajoni Lindor me kryeqendër Shtipin (18), rajoni Jugperëndimor me kryeqendër Ohrin (16), rajoni i Vardarit me kryeqendër Velesin (15), rajoni Verior me kryeqendër Kumanovën (14) dhe rajoni juglindor me kryeqendër Strumicën (11). Në rrjetin e institucioneve arsimore të nivelit të mesëm bie në sy mungesa e tyre në disa komuna, konkretisht në 23 komuna nga 81 gjithsej. Dallimet nuk mungojnë as këtu. Komuna me popullsi kryesisht maqedonase që nuk kanë shkolla të mesme janë me numër shumëfish më të vogël nxënësish se komunat që banojnë me popullsi kryesisht shqiptare. Konkretisht, nuk kanë shkolla të mesme komunat maqedonase si Konçe, Pehçeva, Pllashica apo Rosomani me nga 279, 210, 337 dhe 399 filloristë gjithsej. Por komunat kryesisht shqiptare si për shembull Studeniçani dhe Haraçina - kanë nga 2043, respektivisht 1060 nxënës të shkollave filllore. Do të thotë se numri potencial i nxënësve kandidatë për regjistrim në shkollën e mesme në komunat maqedonase është disa herë më i vogël se numri i nxënësve kandidatë në komuna shqiptare.

SOT FILLON LËNDA GJYQËSORE NGA FILLIMI

PËR ALIMIRIN, JOVEVSKI NUK DALLON NGA ZVËRLEVSKI

"Dje më ka kontaktuar zëvendësja e Lubomir Jovevskit, prokurorja Liljana Spasovska, e cila kërkoi t'ia tregoj adresën se ku duhet ato të na dërgojnë përgjigjen për shkarkimin ose jo të prokurores së rastit. Ju thash se nuk ka nevojë për një gjë të tillë, për shkak se të enjten Almirin do ta rivrisni për të dytën herë. Po çuditë si kanë mundur ta gjejnë telefonin dhe nuk ma kanë gjetur adresën", tha Nijazi Aliu

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 14 mars - Rikualifikimi i lëndës nga "vrasje me paramendim" në "aksident me pasojë



vdekje" në rastin e vogëlushit Almir Aliu pritet të bëhet në seancën e sotme në Kumanovë. Fjalët përfundimtare që janë caktuar të jepen për datë 15 mars (e enjte), sipas familjarëve të viktimës, do të bëhen në favor të vrasësit Boban Iliq. Ditëve të fundit, familjarët e vogëlushit të vrarë Almir Aliu dhe përfaqësues nga Prokuroria Publike dhe ajo e Kumanovës kanë zhvilluar disa takime. Kryefamiljari Nijazi Aliu këto takime i ka cilësuar si një lloj parapërgatitje nga prokuroria për ngjarjet që pritet të ndodhin në seancën e fundit. Aliu,

të premten në protestën e organizuar para Prokurorisë Publike në Shkup, tha se zëvendësja e kryeprokurori Lubomir Jovevski, prokurorja Liljana Spasovska, përmes telefonit ia ka kërkuar adresën për dorëzimin e përgjigjes lidhur me kërkesën e tyre për shkarkimin e prokurores Suzana Kusigerka.

"Nuk i dimë interesat e gjykatës dhe prokurorisë, sepse kaq shumë po mbrohet vrasësi Boban Iliq. Nuk mundemi ta kuptojmë se pse kaq shumë po mbrohet ky person. Të njëjtën pyetje ia kemi parashtruar edhe

prokurorëve. Por, ata nuk u përgjigjen për çka e mbrojnë kaq shumë vrasësin Boban Iliq. Ankesën për shkarkim të prokurores e kemi bërë para katër muajve. Prokuroria Publike nuk na është përgjigjur fare. Ndërsa dje më ka kontaktuar zëvendësja e Lubomir Jovevskit, prokurorja Liljana Spasovska, e cila kërkoi t'ia tregoj adresën se ku duhet ato të na dërgojnë përgjigjen për shkarkimin ose jo të prokurores së rastit. Ju thash se nuk ka nevojë për një gjë të tillë, për shkak se të enjten Almirin do ta rivrisni për të dytën herë. Po çuditë si kanë mundur ta gjejnë telefonin dhe nuk ma kanë gjetur adresën", tha Nijazi Aliu.

Në ndërkohë, para Parlamentit, të mërkurën u protestua sërisht për Almir Aliun. Sipas organizatorëve të protestave, aktivistes Anita Latifi, është për t'u habitur fakti se pikërisht një ditë para se të shpallet vendimi për rastin e Almirin, Prokuroria ka thirrur briefing me gazetarët. Qëndrimi i organiza-

torëve të protestave për rastin "Almir" është se në Maqedoni me ndryshimin e prokurorëve asgjë nuk ka ndryshuar.

"Asgjë nuk ka ndryshuar, nuk ka asnjë informatë të re, nuk e dimë nga ideja që pas dy viteve proces gjyqësor me rastin e Almirin, Prokuroria sot ka thirrur briefing me mediat dhe opinionin. Ky veprim vërtet po na befason. Në kohë kur prokuroria pritet të brifoj për këtë rast, ne nuk dimë çfarë të komentojmë. Thjesht po habitemi pse deri sot ju si gazetarë, ne si opinion kemi pasur shumë pak informata rreth kësaj ngjarje, kurse tash gjithçka më është para aktit të kryer, nesër përfundon ky proces, ata vendosin t'ju shpalosin detaje në lidhje me këtë rast. E vetmja gjë që mund ta themi se me ndryshimin e prokurorëve republikan nuk po ndryshon edhe gjendja e drejtësisë në Maqedoni, apo thjeshtë iku Zverlevski erdhi Joveski", tha Anita Latifi, organizatore e protestës. (O.XH)

VRASJA NË LIQENIN E SMILKOVËS NË DUART E KATICA JANEVËS

SHËRBIMI SEKRET E MONTOI "MONSTRËN"



"Qeveria e kaluar në thoshte ndryshe, kjo e reja tash krejtësisht një version tjetër na e jep për vrasjen e bijve tanë. Pushteti aktual thotë se vetura 'Opell Omega', është pronë e MPB-së, dhe se në vendin e ngjarjes është gjetur një celular i një funksionari të lartë të shërbimit për zbulim. Telefoni është gjetur në Liqenin e Smilkovës...", tha babai i Aleksandar Naçevskit, i vrarë në Liqenin e Smilkovës në prill të vitit 2012

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 14 mars - Rastin "Monstra" e kanë montuar agjentë të shërbimit sekret të Maqedonisë. Kështu të premtën para gazetarëve është shprehur prindi i Aleksandar Naçevskit, i vrarë në Liqenin e Smilkovës, ndërsa tha se nga takimet me zyrtarë të lartë të Qeverisë aktuale, i është thënë se vetura "Opell Omega", është pronë e Ministrinë për Punë të Brendshme dhe se në Liqenin e Smilkovës, është gjetur një celular i një agjenti të lartë të shërbimit për zbulim. Të indinjuar dhe të prekur nga kalkulimet, zvarritjet dhe mos zbardhjen e plotë të rastit, familjarët e viktimave në sallën e Gjykatës Penale të Shkupit kërkuar nga Trupi i ri gjykues që procesin gjyqësor të mos e fillojnë derisa në aktakuzë nuk përfshihen organizatorët e vërtetë. Kështu, ato nuk u shprehën se çka mendojnë për gjashtë shqiptarët e akuzuar,

nëse janë apo jo fajtorët e vërtetë të krimit.

"Qeveria e kaluar në thoshte ndryshe, kjo e reja tash krejtësisht një version tjetër na e jep për vrasjen e bijve tanë. Pushteti aktual thotë se vetura 'Opell Omega', është pronë e MPB-së, dhe se në vendin e ngjarjes është gjetur një celular i një funksionari të lartë të shërbimit për zbulim. Telefoni është gjetur në Liqenin e Smilkovës. Ne nuk dëshirojmë të fillojë ky proces gjyqësor, deri sa nuk bëhet deklasifikimi i sekreteve shtetërore për këtë lëndë. Me emër dhe mbiemër të gjithë të ulën në bankën e të akuzuarve. Jemi në huti, nuk dimë kujt ti besojmë", tha prindi i Aleksandar Naçevskit, njërit prej pesë të vrarëve në Liqenin e Smilkovës.

Prokuroria për luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, më datë 12 mars ia ka dorëzuar për shqyrtimin lëndën e "Monstrës" Prokurorisë Speciale

Publike. Brenda tetëve ditëve, nga koha e pranimit të lëndës, prokuroria e udhëhequr nga Katica Janeva duhet të prononcohet se valë do ta përfaqësojë tutje rastin ose i njëjti do t'i kthehet për procedimin Prokurorisë për krim të organizuar. Ky lajm të mërkurën u bë i ditur nga gjykatësi Ognen Stavrev, i cili është kryesues i Këshillit të ri për shqyrtimin e rigjykitimit të rastit "Monstra". Për këtë arsye, ai theksoi se seanca për vrasjen e pesëfishtë në Liqenin e Smilkovës do të anulohet për datë 17 prill. Ndaj vendimit për prolongimit të kësaj seance, bujshëm reagon familjarët e viktimave të vrarë në Liqenin e Smilkovës në prill të vitit 2012. Ata, po ashtu revoltën e tyre e shprehën edhe ndaj prokurorës speciale Katica Janeva, për të cilën thanë se ajo ka premtuar se zbardhja e "Monstrës" do të jetë në mesin e lëndëve prioritare të saj. Megjithatë, pas më shumë se dy viteve, ky premtim po përmbushet.

Pala mbrojtës e të akuzuarve Sami Luta, Agim Ismailloviq, Haki e Fejzi Haziri, dhe dy të tjerëve Halil Demiri dhe Afrim Ismailloviq, u shprehën të kënaqur që rasti "Monstra" përfundimisht gjendet në duart e PSP-së për shqyrtim dhe se presin që në seancën e ardhshme prokurorët e Katica Janevës, të paraqiten si përfaqësues të aktakuzës së re.

"Mendojmë se pas afatit ligjor për shqyrtim, PSP do ta merr lëndën. Argumentet të cilat i ka parashtruar PSP për këtë lëndë mendoj se janë të qarta, pasi kompetencë e saj është procedimi i lëndëve që burojnë nga përgjimet e përcjella në mënyrë jashtëligjore. Është e sigurt se materialet të cilat i posedon PSP për këtë lëndë, do ta zbardhin në tërësi këtë lëndë, respektivisht pres që me zbardhjen e kësaj ngjarje, të zbulohen edhe autorët e vërtetë", tha avokati Naser Raufi. Njëkohësisht, avokati tjetër i palës mbrojtëse, Sasho Dukovski,

tha se zbulimi i të vërtetës është më rëndësi për të dyja palës, qoftë për të akuzuarit, të cilët padrejtësisht qëndruan gjashtë vite në burg, ashtu edhe për familjarët e të vrarëve, të cilët nuk e dinë se kush u ka vrarë të afërmit e tyre.

Ndryshe, debati më serioz në palën maqedonase se rasti "Monstra" është i montuar, mori hov me paralajmërimin e "bombave" nga LSDM, në kohën kur ajo ishte opozitë. Mirëpo, kryeministri aktual, Zoran Zaev, atë kohë tha se me publikimin e tyre në opinion, mund të shkaktohet revoltë e madhe dhe në këtë mënyrë të tensionohet situata në vend. Për këto arsye, ai materialet që burojnë nga përgjimet e jashtëligjshme e që kishin të bëjnë me vrasjen te Liqeni i Smilkovës, i dorëzoi në PSP, e cila përgjatë dy viteve të kaluara, vazhdimisht thoshte se është në duke punuar në procedurën para hetimore të lëndës.

MBI 1600 AKSIDENTE TRAFIKU GJATË 2017-ës

SHKUPI KRYESON ME VDEKJE

Shkup, 14 mars - Shkupi është qyteti ku gjatë viti 2017 ka pasur më shumë aksidente në trafik dhe atë 1652 aksidente me pasoja të rënda për jetën e pjesëmarrësve në komunikacion. Prej tyre 1617 aksidente kanë përfunduar me lëndime të rënda trupore, ndërsa 37 prej tyre kanë vdekur. Kështu thuhet në raportin e fundit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), sipas të cilës, në rrugët e Maqedonisë pothuajse çdo ditë ndodhë nga një aksident, gjegjësisht vitin e kaluar gjithsej 2500 persona kanë qenë drejtpërsëdrejti të involvuar në aksidente komunikacioni, ku përveç dëmeve materiale - ka pasur edhe persona që kanë humbur

jetën si pasojë e aksidenteve të rënda në komunikacion. Sipas këtyre të dhënave të MPB-së, dëmet materiale të shkaktuara nga aksidentet në trafik përgjatë vitit 2017 kapin shifrën totale prej 116.803.187 denarë apo rreth 2 milionë euro. Shkupi është qyteti ku më së shumti kanë ndodhur aksidente në trafik ku të lënduar kanë mbetur 1617 persona, me pasoja të rënda 218 persona dhe me lëndime të lehta 2245 persona, ndërsa 37 kanë gjetur vdekjen. Dëmet materiale në të gjitha këto aksidente të evidentuara nga MPB kapin vlerën prej 29.390.434 denarë apo rreth 478.000 euro. Pas Shkupit, numër më të madh të aksidenteve

në komunikacion ka pasur në qytetin e Strumicës, ku jetën e kanë humbur 30 persona dhe në Manastir gjatë vitit 2017 si pasojë e aksidenteve të rënda në komunikacion jetën kanë humbur 28 persona. Në qytetin e Krushevës ka pasur vetëm dy aksidente në trafik me pasoja të rënda trupore, ndërsa në Berovë kanë ndodhur 8 aksidente trafiku po ashtu më pasoja të rënda trupore, por në asnjërin në këto aksidente nuk ka pasur të vdekur. Në ndërkohë, numri i personave të vdekur në aksidentet e rënda është 155 persona, prej të cilëve 77 janë vozitës të automjeteve, 44 persona udhëtarë dhe 34 persona këmbësorë. (Z.V)



PËR 24 ORË, 13 AKSIDENTE NË SHKUP

Shtatë persona u lënduan lehtë në gjashtë prej gjithsej 13 fatkeqësive të komunikacionit që kanë ndodhur gjatë ditës së djeshme në rajonin e SPB Shkup, ndërsa në gjashtë janë shkaktuar dëme materiale. Nga MPB informojnë se mbrëmë policia e trafikut ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të shkeljeve. Tridhjetë e dy shoferë kanë qarkulluar me shpejtësi më të madhe se e lejuara, tetë shoferë kanë kaluar në udhëkryq në të kuqe dhe pesë shoferë për tejkalim të parregullt. Është sanksionuar edhe një këmbësor, i cili ka kaluar udhëkryq në dritë të kuqe.

MBI 23 PËRQIND E TURISTËVE NGA KOSOVA DHE SHQIPËRIA

MAQEDONIA, DESTINACIONI I SHQIPTARËVE DHE GREKËVE

Në krye të listës janë turistët nga Shqipëria (3819 turistë) që përbëjnë 12.6 për qind të numrit të përgjithshëm, si edhe grekët (3670 turistë), pas tyre vijne bullgarët (3562 turistë), shqiptarët nga Kosova (mbi 10 për qind e numrit të përgjithshëm), e të tjerë



zita profesionale dhe afariste dhe në një përqindje më të vogël janë ato që lidhen me ndjekjen e ngjarjeve dhe manifestimeve religjioze. Në përgjithësi huajt shpenzojnë më shumë për akomodim dhe ushqim në objekte hotelierike dhe gastronomike dhe as 4 për qind për kulturë dhe zbatimje. Të huajt nga Greqia, Kosova dhe Shqipëria janë kategoria e vizitorëve që shpenzojnë më shumë nëpër spitale, banja termale, e të tjera, për dallim nga turistët italianë, sllovenë apo amerikanë. Vizitorët e anketuar vënë në pikë të parë mikpritjen dhe lokalitetet arkeologjike, ndërsa i zhgënjën higjiena publike, infrastruktura rrugore dhe siguria. Maqedonia e arriti kulmin e fluksit turistik gati dhjetë vjet më parë, kur Qeveria nisi realizimin e megaprojektit kontrovers "Shkupi 2014", duke e shndërruar kështu kryeqytetin në atraksionin dhe destinacionin kryesor të të huajve, kryesisht nga Greqia, Turqia, Kosova, e të tjera. I njëjti rikthim mund të pritët edhe këtë vit, me ndryshimet e parajlmëruara dhe heqjen e një sërë përmendoresh dhe objektësh të tjera që u ndërton si pjesë e projektit të qeverisë së ish kryeministrit Gruevski.

Koha Evis HALILI

Shkup, 14 mars - Maqedonia ka qenë një destinacion i preferuar turistik në këtë fillimvit. Sidomos për shqiptarët, nga Shqipëria dhe Kosova të cilët përbëjnë gati një të katërtën e numrit të përgjithshëm të turistëve për muajin janar. Sipas të dhënave zyrtare fluksi turistik ka nisur mbarë, me një rritje të përgjithshme të numrit të turistëve prej më shumë se 20 për qind më shumë se vitin e kaluar. Në krye të listës janë turistët nga Shqipëria (3 819 turistë) që përbëjnë 12,6 për qind të numrit të përgjithshëm, si edhe grekët (3 670 turistë), pas tyre vijne bullgarët (3 562 turistë), sh-

qiptarët nga Kosova (mbi 10 për qind e numrit të përgjithshëm), e të tjerë. Qytetet si Struga dhe Ohri janë më të frekuentuara nga turistët shqiptarë, ashtu si edhe Kodra e Diellit dhe Mavrova, sidomos për shkak të pistave të skijimit dhe komplekseve atraktive të turizmit dimëror. Ajo që bie në sy këtë vit është përgjysmimi i numrit të turistëve bullgarë, të cilët gjatë të gjithë vitit të kaluar dhe sidomos në muajin dhjetor përbënin mbi 20 për qind të numrit të përgjithshëm të turistëve. Edhe turqit nuk e vizitojnë më si dikur Maqedoninë, të paktën gjatë stinës së dimrit. Numri i tyre është reduktuar ndjeshëm, duke mos arritur as deri

në 10 për qind të numrit të përgjithshëm. Në total numri i turistëve ka arritur në rreth 50 mijë persona (mbi 14 për qind më shumë) dhe i bujtjeve në hotele e vende të tjera akomodimi në mbi 107 mijë net (mbi 22 për qind më shumë). Këto shifra tregojnë një rritje të përgjithshme si të numrit të turistëve, po aq sa edhe të qëndrimit të tyre, edhe pse vendet turistike dhe kurative vizitohen më pak nga turistët vendas. Atraksioni më i madh turistik për Maqedoninë mbetet kryeqyteti. Sidomos për të huajt, thuhet gjysma e të cilëve qëndrojnë në Shkup. Vendet malore janë më pak të preferuara për të huajt dhe më të frekuentua-

ra nga vendasit, ndërsa pikat turistike pranë liqeneve në dimër vizitohen më shumë nga turistët e huaj. Hotelet me pesë dhe tre yje janë lokacionet e akomodimit për pjesën më të madhe të vizitorëve nga jashtë vendit, ndërsa turistët vendas kryesisht kanë shfrytëzuar akomodimin në banjat termale.

Por jo gjithmonë të huajt vijnë për pushime. Sipas anketave më të fundit të ESHS, edhe pse që nga viti 2016 numri i të huajve që frekuentojnë Maqedoninë është në rritje, një pjesë e mirë e tyre vijnë për t'u kuruar në qendra spitalore, si edhe për të vizituar të afërmit e tyre. Ndërsa në një numër më të vogël për turizëm, vi-

Gjykimi kundër Llatasit shtyhet për më 16 maj

Shkup, 14 mars - Seanca për rastin "Lëndina" të Prokurorisë Speciale që i përket ndërtimit pa leje të shtëpive në Zelenikovë, ndërsa në të cilin i akuzuari i parë është gazetari Dragan Pavloviq-Llata me kërkesë të mbrojtjes sot është shtyrë për më 16 maj. Nga Prokuroria Speciale Publike shprehin dyshim për veprimet penale-juridike të tre personave për ndërtim të tre

vikend-shtëpizave në Komunën e Zelenikovës pa pas leje për ndërtim të këtyllë. Sipas dëshmive të mbledhura të PSP, mes të cilëve edhe xhirime satelitore, ekspertizë, si dhe dokumentacion tjetër, këto tre vikend-shtëpiza kanë filluar me ndërtim në vitin 2011, ndërsa leje për ndërtimin e tyre nga komuna është marrë në vitin 2013, kur kishin përfunduar.



Raporti pa praninë e mediave

Shkup, 14 mars - Debati për raportin e "AKMIS-it", të cilën vitin e kaluar e përgatiti Ministria e Drejtësisë, para Këshillit Gjyqësor të Maqedonisë, është zhvilluar pa prezencën e mediave dhe opinionit. Kryetari i Këshillit Gjyqësor, Zoran Karaxhovski, në seancën e mbajtur të mërkurën, kërkoi ndërsa 10 anëtarët tjerë e mbështetën dhe në këtë mënyrë - mediat u larguan nga salla ku diskutohet për keqpërdorimin e sistemit elektronik për ndarjen e lëndëve në Gjykatën Penale të Shkupit dhe Gjykatën Supreme. "Tema është e ndjeshme, ndërsa opinioni duhet të përjashtohet. Përkundër faktit se nga raporti është larguar kushti i sekretit, ne këtu duhet të konstatojmë situatën e caktuar për disa kryetar gjykatash dhe gjykatës", tha Vllade Bogdanovski, anëtar i Këshillit Gjyqësor. Po ky anëtar, në seancën e kaluar të Këshillit Gjyqësor, i kritikoi gazetarët sepse, siç tha ai, mediat janë fajtorët kryesorë për se "kanë lejuar disa persona Këshillit Gjyqësor ta karakterizojnë si xhelatin kryesor të problemeve në gjyqësor". Gjykatësi Vllatko Samarxhiski ishte në mesin e anëtarëve të paktë që kërkoi

praninë e mediave. Kërkesën e tij e mbështetën edhe tre anëtarë tjerë, mirëpo jo mjaftueshëm për të qëndruar gazetarët. Me këtë rast, ai e shfrytëzoi mundësinë e fjalimit dhe citoi një pjesë të raportit për "AKMISIN". "Në raportin e Ministrisë së Drejtësisë është konstatuar se në Gjykatën Penale të Shkupit, në vitin 2016, me sistematizimin e shpeshtë të gjykatësve, janë marrë lëndë gjyqësore nga një gjykatës dhe u janë dhënë tjerëve. Po ashtu, në këtë raport është konstatuar se vlerësimi i gjykatave nuk është bërë në mënyrë objektive. Pikët dhe notat më të larta, siç thuhet në raport, u janë dhënë gjykatave, të cilët kanë pasur më tepër lëndë", tha në reagimin e tij Samarxhiski. Ndryshe, të mërkurën Këshilli Gjyqësor për ushtrues detyre kryetar i Gjykatës së Apelit në Shkup, e zgjodhi gjykatësen Lidija Dimçevska. Ky emërim bëhet pasi kryetarja e deritanishme Liljana Shopova ka dalë në pension. Ushtruesi i detyrës kryetar i Gjykatës së Apelit, gjykatësja Lidija Dimçevska, në biografinë e saj ka mbi 30 vite përvojë punë në gjyqësor. (O.Xh)

BUJQIT ME KËRKESA DECIDE

TREG DHE PAGESA TË SIGURTA

Bujqit ankohen se një pjesë e grumbulluesve, përveç se nuk i respektojnë marrëveshjet me prodhuesit, ato edhe i zvogëlojnë çmimet e kontraktuara me bujqit. Kërkohen ndryshime ligjore që do garantojnë pagesën me kohë të mundit të tyre.

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 14 mars - Tregtarët dhe përpunuesit të shkurtojnë afatet e pagesës së prodhimeve të tyre nga 90 ditë në 15-30 ditë. Kjo është kërkesa e prodhuesve bujqësorë, të cilët po këmbëngulin edhe për rritjen e kontrolleve gjatë pagesës ose ndryshime ligjore. Ata po kërkojnë që të ketë afat ligjore prej 15 ditë nga data e dorëzimit të perimeve të grumbulluara deri në datën e pagesës së prodhimeve bujqësore.

"Nevojitet që ekzekutivi i ri të gjejë mënyrë që në një afat sa më të shkurtër të paguhen të hollat për prodhuesit bujqësor, ndërsa duhet të mendohet edhe për vendosjen e çmimeve garantuese të grumbullimit. Një zgjidhje e tillë imponohet edhe për shkak të faktit se nëse dëshirojmë të kemi rritje të prodhimtarisë, në atë rast patjetër është që mjetet e prodhuesve bujqësor, në bazë të prodhimeve të shitura bujqësore, të paguhen jo më gjatë se 15 ditë, për shkak se prodhuesi bujqësor në fazën e prodhimtarisë paguhet me para të gatshme", thonë nga Lidhja e Sindikatave të Bujqve të Maqedonisë.

Bujqit ankohen se një pjesë e grumbulluesve, përveç se nuk i respektojnë marrëveshjet me prodhuesit, ata edhe i ulin çmimet e kontraktuara me bujqit. Prandaj kërkohen ndryshime ligjore që do garantonin pagesën me kohë të mundit dhe djersës së tyre. Edhe fermerët në terren ankohen se afati i tanishëm është shumë i gjatë dhe kërkojnë që ai të shkurtohet, për shkak se shpesh ndodhë që të hollat nga viti i kaluar të paguhen në vitin e ardhshëm. Përveç vonesave të tilla, bujqve iu krijohet telashe të tjera edhe me tatimin, ku të hollat mund ti marrë edhe Drejtoria e të Ardhurave Publike.

Përveç vonesës me muaj të tërë të pagesës së mallit të grumbulluar, bujqit janë të pafuqishëm edhe në aspektin financiar, që borxhet e tyre ti kërkojnë në gjyq, andaj një nga



NDRYSHIMET LIGJORE GARANTOJNË PAGESA TË SIGURTA

Nga ekzekutivi i ri kanë premtuar se do të punojnë që të sigurojnë plasman të sigurt për bujqit, ndërsa qeveria pritet të jetë edhe partner i fermerëve në negociatat për çmimet grumbulluese. Në takimin fundit me bujqit në Strumicë, Ministri i Bujqësisë, Ljupço Nikollovski theksoi se krahas takimeve me të gjitha palët, po bëhen edhe analiza serioze që do të kontribuojnë që me ndryshimet adekuate ligjore të mundësohet edhe pagesa e sigurt e mjeteve që grumbulluesit ju kanë borxh bujqve.

zgjidhjet është edhe ajo që çdo grumbullues të ketë garanci bankare.

"Vonesa të tilla të pagesës nuk ndodhin askund në botë për shkak se në ekonominë e tregut vlen parimi blej dhe paguaj. Bujqit askush nuk i pyet se a kanë të paguajnë me kohë lëndën e parë, plehrat artificial e kështu me radhë, kështu që mendoj që afati i pagesës duhet të jetë 30 ditë", thotë Vanço Mitev nga shoqata e kultivuesve të perimeve Eko Perime nga Strumica.

Nga ekzekutivi i ri kanë premtuar se do të punojnë që të sigurojnë plasman të sigurt për bujqit, ndërsa qeveria pritet të jetë edhe partner i fermerëve në negociatat për çmimet grumbulluese.

Në takimin fundit me bujqit në

Strumicë, Ministri i Bujqësisë, Ljupço Nikollovski theksoi se krahas takimit me të gjitha palët, po bëhen edhe analiza serioze që do të kontribuojnë që me ndryshimet adekuate ligjore të mundësohet edhe pagesa e sigurt e mjeteve që grumbulluesit ju kanë borxh bujqve. Ndryshe, bujqit në Maqedoni për çdo vit janë në hall me shitjen e prodhimeve të tyre bujqësore, koston e lartë të punës që shpesh nuk i mbulon as harxhimet, çmimet e ulëta të grumbullimit që diktohen nga tregtarët, mosrespektimin e kontratave për shitblerje, si dhe vonesat në pagesa të pemë-perimeve të grumbulluara. Viteve të fundit kishin ndër të tjerash probleme edhe me mosgrumbullimin e rrrushit, si dhe çmimin e ulët i blerës të specave që si-

pas Lidhjes së Sindikatave të bujqve në vend prej 20 deri 24 denarë siç është kontraktuar, grumbulloheshin prej 10-12 denarë. Gjithashtu për problemet me grumbullimin me çmim të ulët janë ankuar edhe prodhuesit e grurit si dhe më shumë prodhues të tjerë bujqësor. Në vitet paraprake, problemi me plasmanin e domateve u zbut me dhënie subvencione prej 6.5 denarë për një kilogram të domateve të dorëzuara në fabrikat konservuese, ndërsa kishte edhe subvencione shtesë në të holla edhe tek prodhuesit e tjerë.

Në ndërkohë, ekzekutivi i ri në Ministrinë e Bujqësisë në vitin e kaluar intervenoi me qëllim të stabilizimit të tregut të pjeshkave dhe bostanit me vendosjen e plus 6 denarë subvencione për pjeshka të dorëzuara tek grumbulluesit dhe me dy denarë shtesë subvencione për kilogram të bostanit të dorëzuar tek tregtarët.

Nga ana tjetër akoma nuk është paguar tërësisht borxhi i Bodrumi të verës "Povardarie", ndaj prodhuesve të rrrushit për vitet 2014, 2015 dhe 2016, përkundër angazhimeve qeveritare se një gjë e tillë do të realizohet deri në fund të vitit 2017. Kjo kompania para pesë muajve është zotuar se nga shitja jashtë e rezervave për eksport do të realizojë pagesat ndaj vreshtarëve. Nga Federata e Fermerëve para një muaji, kanë paralajmëruar se do intervenojnë ndaj "Povardarie" që të paguajë borxhin për rrrushin e grumbulluar dhe ndaj institucioneve shtetërore që të ndërmarrin masa ligjore ndaj këtij grumbulluesi.

Sot skadon afati për dorëzimin e të ardhurave tatimore, priten edhe 100 mijë

Shkup, 14 mars - Sot skadon afati për paraqitjen e të Ardhurave tatimore vjetore për konfirmimin e tatimit personal të të ardhurave dhe paraqitjen e të ardhurave të cilat qytetarët i kanë realizuar në vitin 2017. Të dhënat e fundit të DAP-it tregojnë se deri tani janë parashtruar gjithsej 334.360 paraqitje. Gjatë ditës së djeshme dhe të sotme në DAP presin të paraqiten edhe rreth 100 mijë ATV. Më së shumti ose 125.165 paraqitje janë parashtruar në Shkup, në Manastir 46.400, Tetovë 28.621, Strumicë 29.982, Prilep 45.652 dhe Shtip 58.540 paraqitje tatimore vjetore. Paraqitjet përveç se në sportele mund të parashtrohen edhe në mënyrë elektronike ose nëpërmjet postës. "Me qëllim të shmangies së tollovive, veçanërisht në Drejtorinë rajonale Shkup, apelojmë që qytetarët t'i paraqesin të ardhurat edhe në sportelet e DAP-it të cilat janë të hapura për praninë të të Ardhurave tatimore vjetore në Qendër, si dhe në komunat Gjorçe Petrov, Butel, Gazi Babë, Aero-drom dhe sporteli mobil tatimor në Draçevë, që do të stacionohet më 15 mars para bashkësisë lokale në periudhën nga ora 10:00 deri në orën 14:00. Për dorëzimin jo me kohë, përkatësisht paraqitje tatimore të padorëzuar dhe të ardhura të paraqitura jo të plota Ligji parasheh gjobë prej 100 deri në 200 euro, në kundërvlerë të denarit.

MATTO kërkon subvencione për investitorët në bujqësi

Shkup, 14 mars - Qeveria të sjellë program për përkrahje të investitorëve në bujqësi, të sigurojë subvencione për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në periudhë prej 49 viteve, duke u dhënë nën koncesion tokë bujqësore nga 5.000 - 10.000 metra katror për ndërtim të firmave të vogla ose për marrje me qira, ta përmirësojë infrastrukturën në zonat industriale për eko-

nominë e vogël dhe t'i ndërpresë akcizat për petro - koks si përkrahje për industrializimin dhe rritjen e konkurrencës, propozon Oda Ekonomike Maqedoni - Turqi (MATTO). Anëtarët e MATTO-s sot duhet të kenë takim me kryeministrin Zoran Zaev në të cilin, siç thonë nga MIA, do të flitet për këto, por edhe për propozime tjera në drejtim të përmirësimit të klimës afariste. Në

takimin do të flitet edhe për raportet bilaterale ekonomike Maqedoni - Turqi, si dhe për turizmin. Do të bëhet vërejtje, sipas MATTO, edhe për gjyqësinë joefikase dhe administratën joefikase me të cilat balafaqohen investitorët, si dhe për afatet e paparashikuara dhe të gjata për marrjen e lejeve për blerjen e patundshmërive ose shfrytëzimin e tyre, për kryerjen e veprimtarive,

për angazhim të profesionistëve sipas nevojës, për shkollimin e studentëve... "Moskonzistenca në implementimin e rregullativës juridike nga ana e administratës krijon ndjenjë të pasigurisë juridike" theksojnë anëtarët e Odës. Ata vlerësojnë se ligjet për disiplinën financiare, për noteri dhe për përmbartim duhet sa më shpejt të rishqyrtohen, siç ishte rasti

me Ligjin për furnizime publike. "Në këtë kontest është i domosdoshëm edhe rishqyrtimi i politikës së dënimit. E theksojmë edhe Ligjin për vlerën e shtuar sepse në nenin 32 parashihet që tatimi i paguar të paguhet dyfish, pa mundësi për kthim. Vlerësojmë se me ndryshime dhe plotësime të vendimeve të tilla do të kishim situatë "uin - uin", bëjnë të ditur nga MATTO.

KRONIKË

Aksident afër
Zherovjanit,
katër të lënduar

Të martën pasdite rreth orës 17.30 minuta, në autostradën Gostivar-Tetovë në afërsi të daljes për në fshatin Zherovjan, ka ndodhur një aksident komunikacioni në të cilin janë përfshirë dy vetura me targa të Tetovës respektivisht një veturë e tipit "Mercedes" të cilën e ka drejtuar 30-vjeçari me initiale B.L nga Tetova, si dhe një "BMË", të cilën e ka drejtuar 31-vjeçari me initiale R.A nga Odri. Në këtë aksident dy vozitësit si dhe dy bashkudhëtarët që janë gjendur në këto dy vetura S.XH 60-vjeçarë nga Zhelina, dhe J.Q 39-vjeçarë nga fshati Nerashit për pasojë kanë marrë lëndime trupore, dhe me anë të autoambulancës janë dërguar në spitalin klinik të Tetovës nga ku pas marrjes së ndihmës mjekësore janë lëshuar për mjekim shtëpiak. Sipas të dhënave fillestare që bazohen në ekspertizën e kryer në vendin e ngjarjes si shkak për këtë aksident është mosrespektimi i përparësisë së kalimit, përdorimi i shkakuar material vlerësohet të jetë rreth 80 mijë denarë.

Nxënësi denoncon
mësuesin për dhunë

Një pesëmbëdhjetë vjeçarë nga Zhelina nxënësi në shkollën fillore "Luigj Gurakuqi", të martën mbrëma, së bashku me xhaxhain e tij kanë denoncuar se gjatë ditës rreth orës 11.00, në orën e Historisë mësuesi me inicialet M.B 56-vjeçarë nga Zhelina sipas denoncuesit, pa kurrfarë arsye dhe shkak me shuplakë e ka goditur në pjesën e pasme të kokës, pas çka ai goditur bankën dhe ka thyer njërin prej dhëmbëve. Pak më vonë minorenin i lënduar është drejtuar për ndihmë mjekësore në spitalin klinik të Tetovës ndërsa më pas rastin e ka paraqitur në polici. Po punohet në zbardhjen e të gjitha detajeve që ndërlidhen me rastin në fjalë.

Tetovë,
38-vjeçari rrëmben
18-vjeçaren

Një vajzë njëzetvjeçare nga Tetova të martën pasdite është rrëmbyer nga ana e një tetovari 38-vjeçar i cili e ka rrëmbyer nga shtëpia e saj, ndërsa nënën e saj e ka sulmuar fizikisht. Ministria e Punëve të Brendshme bëri të ditur se rastin në polici është denoncuar nga nëna e saj F.S. sipas së cilët 38-vjeçari D.K. rreth orës 19 kanë ardhur në shtëpinë e tyre dhe me dhunë e ka rrëmbyer vajzën dhe kur nëna e saj ka tentuar t'i kundërshtohet, ai e ka goditur dy herë në kokë dhe me dhunë e ka futur vajzën E.S. në automjet dhe e ka dërguar në shtëpinë e tij. Pas masave të ndërmarra, D.K. dhe E.S. janë gjetur dhe dërguar në SPB Tetovë. Për ngjarjen është njoftuar prokurori publik dhe po punohet në ndriçimin e rastit. (O.Xh)

MBI 85 PUNIME NË KONKURSIONIN E AMEJL-së



Asociacioni i Mediave
të Evropës Juglindore

FITON LOGOJA E
TOSHIQIT

Autorja e punimit të zgjedhur, Zorana Toshiç është lindur më 17 maj 1996 në Llazarevc, Serbi. Shkollën fillore dhe të mesme ka mbaruar në Podgoricë. Për momentin është studente e vitit të tretë të Fakultetit të Artit figurativ në Cetinje, programi studimor dizajn grafik

Shkup, 14 mars - Punimi grafik i dizajneres Zorana Toshiç është zgjedhur për logotip të Asociacionit të Mediave të Evropës Juglindore (AMEJL), të cilin e përbëjnë gjashtë shtëpitë kryesore mediale nga Podgorica, Sarajeva, Beogradi, Prishtina dhe Shkupi. Në konkursin për punën logotipit kanë marrë pjesë 87 punime, mes të cilëve një prej Rumanisë, një prej Indonezisë dhe një prej Anglisë. Të gjitha të tjerat janë nga vendet prej të cilave vijnë mediat anëtare të AMEJL. Autorja e punimit të zgjedhur, Zorana Toshiç është lindur më 17 maj 1996 në Llazarevc, Serbi. Shkollën fillore dhe të mesme ka mbaruar në Podgoricë. Për momentin është studente e vitit të tretë të Fakultetit të Artit figurativ në Cetinje, programi studimor dizajn grafik.

Themeluesit e Asociacionit, selia e të cilit është në Podgoricë, janë Vijesti (Podgoricë), KOHA (Shkup, Oslobogjenje (Sarajevë), AMG (Beograd), Koha Ditore (Prishtinë) dhe Sloboden Peçat (Shkup). Kryetari i parë i Asociacionit është drejtori i "Vijesti", Zheljko Ivanović. Asociacioni rajonal është themeluar për qëllim të bashkëpunimit dhe mbështetjes së ndërsjellë, trajnimit të përbashkët të të punësuarve, këmbim të përmbajtjeve, qasjeve të koordinuara ndaj organeve dhe organizatave sh-

tetërore dhe ndërkombëtare për shkak të avancimit të cilësisë së gazetarisë dhe përmirësimit të kushteve dhe pozitës së mediave në treg. Në arsyetimin e zgjidhjes ideore të logotipit të AMEJL Toshiç ka theksuar se ideja e saj ishte që përmes shenjës të tregojë gjashtë shtëpitë mediale, të cilat janë bashkuar për të realizuar këtë projekt. "Janë paraqitur gjashtë vija të zeza, të cilat njëra mbi tjetrën shkojnë në një drejtim, për të njëjtin synim, ku jam munduar që vijat të sugjerojnë drejtimin përjetë. Vijat i ndërthurë një rreth ngjyrë portokalli i cili vizualisht bashkon shtëpitë mediatike. Ngjyra portokalli është zgjedhur që të jetë e dukshme, e ngrohtë dhe të simbolizojë entuziazmin dhe të kombinojë energjinë e së kuqes dhe lumturinë e së verdhës. Tipografia është e besueshme, e qartë dhe e lexueshme, e zgjedhur që vizualisht t'i përkojë frymës së logotipit", ka shpjeguar idenë e vet Zorana Toshiç. Çmimin në të holla në shumë prej 500 eurove për fituesit e konkursit do ta ndajë zyra e OSBE-së në Mal të Zi, e cila ka qenë sponsor i këtij konkursi të studentëve të dizajnit nga i gjithë rajoni. Synimi i Asociacionit të AMEJL, siç është theksuar në takimin themelues, do të jetë puna e zbatimit të standardeve evropiane, të cilat ju kërkohen të gjitha vendeve të rajo-



nit në fazën e bisedimeve paraqasëse me BE në drejtim të mbrojtjes së gazetarisë, të drejtës së lirisë së shprehjes, kushteve të drejta në treg, punës transparente dhe të pavarur të agjencive rregullatore. Gjithashtu, qasje të përbashkët kundrejt reklamuesve të mëdhenj ndërkombëtar, bashkëpunim me organizatat profesionale në Evropë, solidaritet mes mediave të rajonit, si shkëmbim të njohurive dhe përvojave mes anëtarëve të Asociacionit.

Planifikohet organizim i trajnimit të përbashkët për anëtarët e Asociacionit në lidhje me segmentet konkrete të biznesit (shitje, marketing, video produksion, e-paper, etj.), organizim të një konference të madhe vjetore tematike në një prej qendrave rajonale, ku do të ftoheshin të gjitha mediat relevante nga rajoni, BE, ekspertët nga këto fusha, liderë politik, përfaqësues të shoqatave profesionale të rajonit dhe BE. Një prej detyrave prioritare është edhe lidhja me asociacionet evropiane dhe botërore të botuesve (INMA i WAN).

LOGOS-A VAZHDON MË SHPËRNDARJEN E LIBRAVE

Shkup, 14 mars - Shtëpia Botuese Logos-A me aktivitetin të cilën e ka ndërmarrë, dëshmon se është në shërbim të kulturës së leximit dhe dijës. Titujt e librave të Logos-it, tanimë janë pjesë e bibliotekës së shkollave shqipe në rrethinën e Dibrës, Kërçovës, Strugës, Ohrit, Prilepit dhe Krushevës. Logos-A, gjithashtu furnizoi me libra shkollat fillore në Černilishte, Zhitoshë, Desovë, Debresh, dhe Presillë. Në kuadër të kësaj kampanje fisnike e cila filloi me rastin 7 Marsit Ditës së Mësuesit, Shtëpisë Botuese Logos-A, synon që të shpërndajë lektura dhe atlas shkollorë për nxënësit, ndërsa mësuesve të shkollave fillore iu dhurohen vepra të rilindësit shqiptarë Sami Frashëri. Ky aktivitet bëhet me qëllim që të pasurohen bibliotekat shkollorë të shkollave shqipe në Republikën e Maqedonisë si dhe të nxitet kultura e leximit tek moshatarët e rinj.



BANKAT ME REKORD FITIMI



Fitimi i bankave është rritur fitimi për katër herë nga 23 milion euro profit i tërë sektorit bankar në vitin 2006 në mbi 80 milion euro në vitin e kaluar, vetëm nëse llogarisim fitimin e treshes së bankave më të mëdha si Tutunska, Stopanska, Komercijalna...

BASHKË ME KREDITË, RRITET EDHE PROFITI

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 14 mars - Rritja e madhe e kredive në periudhën e kaluar ka rritur edhe fitimin e bankave në Maqedoni. Vetëm në periudhën dhjetor i vitit 2016 deri në janar të vitit 2018 shënon rritje kreditimi i popullatës prej 120 miliardë denarë në afër 143 miliardë denarë.

Rritja e fitimit të bankave, kryesisht vjen si rezultat i rritjes së profitit nga dallimi midis kamatave të kredive që miratohen dhe kursimeve që ju paguhen qytetarëve, uljes së harxhimeve të ndryshme të bankave, kompensimeve etj. Ekonomistët thonë se qytetarët të ballafaquar me pagat e ulëta që vështirë mbulojnë harxhimet mujore janë të detyruar të hyjnë në borxh për kredi konsumatore apo banesore, minuse në kartelat kreditore apo llogaritë rrjedhëse për të cilat bankat që e kanë biznesin dhënie e parave me qira, fitojnë shuma të mëdha të fitimit.

Për rritjen e madhe të fitimit të bankave në 12 vitet e fundit flet

edhe fakti se fitimi i tyre është rritur për katër herë nga 23 milion euro fitime të të gjithë sektorit bankar në vitin 2006 në mbi 80 milion euro vetëm nëse llogarisim vetëm fitimin e treshes së bankave më të mëdha si Tutunska Banka, Stopanska dhe Komercijalna.

Sipas raporteve të publikuara në Bursën e Maqedonisë, NLB Banka ka shënuar të ardhura prej 87 milionë euro dhe fitim prej 34.5 milionë euro që paraqet një rritje prej afër 9 milionë euro në raport me fitimin prej 25.7 milionë euro në vitin 2016. Të ardhurat e kësaj banke vijnë me afër 57 milion euro prej kamatave, me afër 24 milionë euro prej provizioneve dhe kompensimeve të ndryshme etj. Stopanska Banka ka realizuar në vitin e kaluar të ardhura prej 98 milion euro dhe fitim prej 33 milion euro. Të ardhurat prej kamatave kanë qënë 72 milion euro, nga provizionet dhe kompensimet shënohen fitime prej 17 milionë euro etj. Kjo bankë shënon ulje të butë të fitimit prej afër 3 milion euro në raport



Sipas raporteve të publikuara në Bursën e Maqedonisë, NLB Banka ka shënuar të ardhura prej 87 milionë euro dhe fitim prej 34.5 milionë euro që paraqet një rritje prej afër 9 milionë euro në raport me fitimin prej 25.7 milionë euro në vitin 2016

me vitin 2016 kur ka pasur fitim prej 36.5 milionë euro.

Banka Komerciale në vitin 2017 shënon të ardhura prej afër 97 milionë euro dhe fitim prej 13.814 milionë. Nga kamatat kjo bankë ka fituar afër 58 milionë euro, ndërsa nga kompensimet dhe provizionet ka fituar afër 19 milion euro. Kjo bankë shënon rritje të fitimit prej 1 milion euro në raport me vitin 2016. TTK Banka në vitin 2017 ka pasur profit prej 9.6 milionë euro dhe

fitim të pastër prej 1.6 milion euro, ndërsa Stopanska Banka e Manastirit ka pasur të ardhura prej 10.6 milionë euro dhe fitim prej afër 700 mijë euro.

Në ndërkohë, të ardhura të rëndësishme bankat vjelin nga neto të ardhurat e kamatave, apo nga dallimi midis kamatave të kredive që miratohen dhe kursimeve që ju paguhen qytetarëve. Nga ana tjetër, bankat harxhojnë një pjesë të fitimit edhe për të mbuluar pagat e të punësuarve, për rezervimin e kredive të këqija, ose humbjet për shkak të dëmtimit gjegjësisht përmirësimit të vlerës së mjeteve financiare. Ndryshe, një pjesë e ekspertëve financiar thonë se fitimet e mëdha në kamata të një pjese të bankave si rrjedhojë e marzhave që për një pjesë të bankave më të mëdha në vend arrijnë bile 500 për qind, shkaktojnë që bankat të jetojnë vetëm nga kamatat e kredive, dhe të mos jenë pjesëmarrësve aktive në rrjedhat financiare vendore dhe rritjen ekonomike të shtetit.

Shi i rrëmbyeshëm me bubullima të shtunën

Shkup, 14 mars - Mot i paqëndrueshëm me reshje të rrëmbyeshme të shiut të përcjella me bubullima pritet të shtunën drejtë të dielës dhe gjatë natës. Gjatë ditës do të fryjë erë jugore e cila do të shkaktojë temperatura dukshëm më të larta të ditës të cilat do të arrin madje deri në 25 gradë. Lokalisht priten procese më intensive, ndërsa reshje me intensitet të ndryshueshëm do të ketë edhe në ditët në vijim kur temperaturat do të jenë në rënie. Nga Drejtoria për Punë Hidrometeorologjike paralajmërojnë shi lokal dhe bubullima të rralla për sot pasdite, ndërsa shi afatshkurtër do të ketë edhe në luginën e Shkupit.

Sot nis vaksinimi kundër "lëkurës gungore"

Shkup, 14 mars - Prej sot fillon vaksinimi i gjedheve kundër sëmundjes "lëkura gungore", kumtoi sot Agjencia për ushqim dhe veterinarin (AUV). Vaksinimi do të zgjat deri më 31 maj, ndërsa zbatohet konform Programit vjetor për mbrojtje shëndetësore të kafshëve nga ana e shoqatave të autorizuara të veterinarisë. "Me 230.000 doza vaksinë, donacion nga BE-ja, do të përfshihen të gjitha gjedhet në vend. Sëmundja "lëkura gungore" në vend tash për tash është vendosur nën kontroll falë fushatave paraprake vaksinale dhe tash për tash nuk ka paraqitje të rasteve të reja", informoi Agjencia. Rasti i fundit i kësaj sëmundje tek gjedhet, pas paraqitjes në vitin 2016, është evidentuar në qershor të vitit 2017 në rrethinën e Kriva Pallankës.

Krusheva si destinacion për katër stinët

Shkup, 14 mars - Agjencia për promovim dhe mbështetje të turizmit të Republikës së Maqedonisë (APMT) do ta promovojë Krushevën si destinacion për katër sezonet. Drejtori i APMT-së, Lupço Janevski dhe kryetari i komunës së Krushevës, Tome Hristoski në takimin e

sotëm të punës diskutuan për format e qëndrueshme të turizmit dhe zhvillimit të qytetit në destinacionin aventuristik. Sipas Agjencisë, hedhja me parashutë (paragliding), historia, kultura, arkitektura unike, specialitetet gastronome, zejdet e vjetra dhe mikpritja e popullatës loka-

le, janë vetëm disa nga përparësitë e qytetit. Në Krushevë, sivjet janë paralajmëruar shtatë kupa në hedhjen me parashutë (paragliding), ndërsa në vitin 2019 pritet mbajtja e kampionatit botëror në këtë sport ekstrem dhe me adrenalinë. "Ky është një sport atraktiv garues dhe rek-

reativ dhe degë e aviacionit, i cili e tërheq vëmendjen e turistëve. Në kontekst të kësaj, numri i turistëve dhe bujtjeve të realizuara në Krushevë është në rritje të vazhdueshme", informon APMT. Agjencia e promovoi Krushevën në panairin international për turizëm në Sofje,

Beograd dhe Berlin, ndërsa në periudhën e ardhshme do të promovohet në Zagreb dhe në Tiranë. Është përpunuar edhe material promovues me të gjitha përmendoret e Krushevës, historinë, kulturën dhe arkitekturën e saj, si dhe mundësitë për turizëm dimëror.

Në programin 200, të fundit që realizova, pata si ide të shpalos pikëpamjet e ndryshme që ka shoqëria maqedonase rreth ligjit për gjuhët, ose më saktësisht ligjin për gjuhën shqipe. Nëse subjektet shqiptare kanë një konsensus për këtë ligj, pavarësisht se ai nuk është se gjuha shqipe është zyrtare plotësisht, për ato maqedonase ligji ngjall debat të madh. Gjatë debatit, ata që e panë programin, një nga folëset i referohej në mënyrë hipotetike, Trajçe. Pra një maqedonasi të zakonshëm dhe çfarë do të thoshte ai, çdo të thoshte për të dhe sa informacion kishte Trajçe për ligin në fjalë? Nuk dua të bëj një përshkrim të programit, por ajo që më bëri përshypje dhe që po më bën gjatë gjithë kësaj kohe është se si shoqëria liberale, e hapur dhe çliruar e maqedonasve (e një pjese të saj) nuk ka kuptuar rëndësinë e ligjit dhe sigurisht, pse nuk ia ka sqaruar ose tentuar tua sqarojë gjithë atyre Trajçeve se çdo të thotë ky ligj.

Në fakt në terma më politik, nëse e ndanim shoqërinë në të majtë e të djathtë, krijohet konfuzion. Këtu edhe majtët që do të duhet të ishin më të hapur, më pro grupeve të vogla, më pro më të ndjeshmëve, del se shfaqin rezerva të mëdha për ligjin. E nga ana tjetër të djathtët, janë të qartë në qëndrimet e kundërshtimeve të tyre, sepse gjithmonë janë shprehur kundër.

Tani "betejat" e shqiptarëve, në sferën publike, mbetet të bëhen në të dy kampet dhe ky është një shok. Për mos të folur për zgënjimin që sjellin "shokët" ideologjik. Megjithatë sigurisht, jo i pa pritur, kur dihet hist(e)oria e diskutimeve në Maqedoni, se për sa kohë debatohet për shqiptarët syzet që vihen pastaj s'janë më ato ideologjike por etnike. Në këtë kontekst, a ka Trajçe më faj që nuk di gjë se çfarë do të thotë ligji për gjuhët?

Një Trajçe nga Shtipi, që ka me mijëra halle, si gjithë të tjerët në fakt, me përditshmërinë, a do të duhet vetë të lexojë ligjet dhe të analizojë se çdo të thonë ata? Sigurisht që jo. Këtu ka rol pjesa e shoqërisë, ajo e letrave dhe studiove, që do të duhet ta shpjegojë rëndësinë e ligjit dhe Trajçet të rrinë të qetë në hallet e tyre. Por, tek shoh vrull reagimesh, për nenet, ligjet, procedurat, më vjen keq se si nuk arrihet të kuptohet esenca, sërish duke përjashtuar ata që e kanë kuptuar, nga profesorë, profesionistë, njerëz të lexuar, të jetuar jashtë ku vetë në raste të tjera kanë dhënë shembuj pa fund për praktika të ndryshme të shoqërive si e jona. Nuk e di Trajçet nëse do të mund ta lexojnë këtë tekst. Sepse shkruhet në shqip e shqipen ata nuk e dinë, sidomos jo ata të Shtipit e përtej. Por ndonjë tjetër mbase dhe do ta përkthejë. Dhe po unë dua që Trajçet, madje edhe këta Trajçet li-

Trajçe

beralë, liberalë për çdo gjë tjetër por të rremë për çështjet shqiptare, ta kuptojnë se pse ligji për gjuhën ka rëndësi për mua dhe gjithë shoqërinë tonë.

E para që më është thënë është se ai më shumë nxit ndarje! Nuk e kuptoj se si, por ja do jap një përgjigje. Brezi im, është rritur me ndjesinë e heqjes së një të drejte për arsimim në gjuhën shqipe. Diku në vitet '80, u hoq mundësia e edukimit në gjimnaz në shqip dhe gjithë duhej të mësonim maqedonisht. Ky moment nuk lidhet me arsimin, por lidhet me gjithë ndjesitë rreth gjuhës dhe autoritetit, shtetit. Qasjes që ka pasur për ne, si të tjerë me gjuhë tjetër në këtë vend. Më saktësisht, minimalisht diferencimin që e bënte, për mos të thënë diskriminim ndaj meje dhe Trajçes, tashme jo hipotetik, po një Trajçe që vërtetë e kisha shok në fëmijëri. Ligji ka të bëjë sjelljen e nje sensi barazie, e mos imponimit që është bërë nepërmejt gjuhës dhe që ska të bëjë me të tjerët. Prandaj fillimisht ligji për gjuhët, atë që do sjellë për mua dhe besoj dhe gjithë të tjerët, është ndjesia se shteti po rikthen qëndrimin e njëjtë ndaj nesh dhe Trajçeve të tjerë. Ne të gjithë e dimë se kjo nuk cenon njeri. Është thënë se ligji do të rrisë nacionalizmat mes mesh. Por, a ju kujtohet ligji

për flamurin? Çfarë nuk u tha atëherë për sovranitetin, irredentizmin, nacionalizmin... dhe gjithë izmat e tjerë, dhe ja sot askush nuk e përmend. Askujt nuk i ka shkaktuar asgjë dhe askush nuk abuzon. Ndjesia e të qenurit i lirë është e shenjtë. Ti atë liri mbase dhe nuk do ta përdorësh ndonjëherë, por vetë ideja se s'ke ndalesë, të jep qetësinë. Shqiptari është i lidhur shumë ngushtë me gjuhën, lirinë e percepton nepërmejt saj, sepse ajo i është ndaluar në vazhdimësi, ndërkohë ajo është bartësi kryesor i gjenezës tonë. Në kontekst modern, një shërbim më shumë në shqip, vetëm do sjellë një qetësi më shumë. E bëj këtë analogji, sepse jam i bindur, si në shumë rrethana të tjera, se e drejta dhe liria që do sjellë ligji për gjuhët nuk është se do sjellë një super përdorim të saj. Njerëzit do rëndin të mbarojnë punë, të mos zvarriten nëpër sportelet e administratës të mplakur, të vazhdojnë me jetën. Nuk do shkojnë në Shtip të kërkojnë shqip zgjidhjen e ndonjë halli, por të mbarojnë punë, dhe të ndjekin rrugëtimit e tyre. Megjithatë, veç liria dhe e drejta se këtë do të mund ta bëjnë edhe në shqip, do të sjellë një dimension të ri në mbamendjen tonë kolektive. Kjo s'duhet të trembë asnjë Trajçe, atë shokun tim, por edhe të tjerët kudo ku janë.

Ndjesia e të qenurit i lirë është e shenjtë. Ti atë liri mbase dhe nuk do ta përdorësh ndonjëherë, por vetë ideja se s'ke ndalesë, të jep qetësinë. Shqiptari është i lidhur shumë ngushtë me gjuhën, lirinë e percepton nepërmejt saj, sepse ajo i është ndaluar në vazhdimësi, ndërkohë ajo është bartësi kryesor i gjenezës tonë...



Në programin që bëra për debatet brenda maqedonase, Petar Arsovski, opinionisti i njohur tha në fund, se pas miratimit të ligjit, një numër i madh i qytetarëve të Maqedonisë do të jenë të gëzuar dhe kjo e gëzonte edhe atë. Sepse, siç tha ai, bëhet fjalë për një arritje historike për shqiptarët.

Këtë gjë duhet ta kuptonin ata liberalë e mendjehapur që nuk arrijnë e nuk arrijnë të kuptojnë lirinë e tjetrit. Megjithatë këtu është sfida e jonë, e shqiptarëve të tillë, të kënduar e të parë, ku nuk duhet për çështje të ngjashme të mbylлим sytë e të vëmë syze etnike me çdo kusht, kur dalin çështje të lirive të të tjerëve. Nëse shqiptari akomodohet tashmë në këtë shtet, është detyra e secilit prej nesh që të sqarojë, mbrojë madje dhe përfaqësojë Trajçet e mposhtur, apo edhe që mendojnë se janë të rrezikuar.

Petar Arsovski, tha në program se Trajçes s'ka ç'i duhet të dijë ligjin për gjuhët, se atij nuk i ndryshon asgjë miratimi i tij. Unë them se të gjithë duhet të dimë për ligjet e kësaj hapësire që ndajmë bashkë, sepse të tillë do jemi të qetë. Nëse për shqiptarët barazia sjell qetësi, qetësinë do të duhet tua sigurojmë dhe të tjerëve kur është në dorën tonë.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)



Nga
Nazim RASHIDI

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaska lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 14 mars | Numri i parë i gazetës do të 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Argumenti "më i fuqishëm" i kryeministrit sa herë që debaton në Kuvend, dhe sa herë që shpreh mospajtim me opozitën është: "Ku po ju dhemb?". Për ta bërë edhe më të fuqishëm "argumentin", patjetër do ta shtojë edhe fjalën "burra", duke i përjashtuar kështu plotësisht gratë nga vendimmarrja politike. Dhe në fakt nuk do të mund të ishte ndryshe kur merret parasysh se jo vetëm Qeveria, por edhe institucionet kosovare në përgjithësi u ngjasojnë odave të burrave, ku gratë shërbejnë për dekor.

Pos që është absolutisht irritues komunikimi kaq "popullor" - pra unë po flas me fjalët e popullit, është po aq irritues qëndrimi shpërfillës ndaj cilësdo kritikë apo fjale që nuk i shkon për shtat. Marrja e përgjegjësisë së udhëheqjes së Qeverisë nënkupton edhe rrezikun e të qenit të kritikuar gjithëherë, por ndaj së cilës kritikë do të duhej reaguar me veprime dhe fjalë të matura, posaçërisht jo ofenduese. Porse ja, Kosova ka pasur fatin që në katër mandatet e fundit të ketë në krye të ekzekutivit njerëz që kanë qenë shpërfillës, arrogantë e inatçorë, e që paafësinë e tyre politike e kanë shndërruar në luftë të kotë fjalësh, që kanë sjellë, jo njëherë, bllokimin e komplet shtetit.

DHJETË DHIMBJE

Pyetja e kryeministrit nuk më është drejtuar mua, se nuk jam as deputete e as burrë. Porse si qytetare e këtij vendi të hallakatur e kam një listë të gjatë dhimbjesh që do të doja t'ia bëja me dije. Nuk pres se ai do t'i shërojë këto dhimbje. Vetëm po frikësohem se lista do të zgjerohet edhe më dhe dhimbja do të bëhet dikur e padurueshme. Bile, bile, ende çuditë me popullin tim se sa i durueshëm tregohet ndaj krejt kësaj që po e jeton me vite të tëra. Nuk e di nëse do t'i lexojë e as nuk e di nëse do t'i mbajë mend dhimbjet që na shkaktohen kryesisht nga ai dhe institucionet e tjera, porse, megjithatë, unë do të ndihem më mirë që t'i lë të shkruara. Nëse për asgjë tjetër, atëherë për kujtim.

1) Shumë po dhemb kur kuptohet se Kosova përjashtohet nga EQAR-i për shkak se shkarkohet komplet Bordi i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës. Nëse problem paska qenë "hajni ordiner", lënda e të cilit është dashur të shkonte në Prokurori para pesë muajsh, pse shkarkimi i gjithë Bordit pra? Me siguri jo për cilësi më të mirë. Për biznes, pa dyshim;

2) Shumë po dhemb të dihet se ekziston një vendim gjyqësor që e obligon Qeverinë për ta shpalosur sekretin më të madh të Kosovës - kontratën me Bechtel Enkan për ndërtimin e autostradave. Shumë e dhimbshme që na shkuan 1,5 miliardë para të gatshme në dy objek-

Qe ku po na dhemb



Përderisa politikanët të mos e kuptojnë se popullit nuk i bën mirë po qe se mbetet pa pasuri, pa punë, pa shëndet, pa shkollë, pa kulturë, pa sport - ky popull do të vazhdojë ta vuajë dhimbjen e dyfishtë: të asaj që ia shkaktojnë politikanët injorantë, arrogantë dhe të pandërgjegjshëm, dhe të asaj që ia shkakton vetes me defetizmin e vet

te që kanë mundur të kushtonin shumë më lirë e që të kenë mundur të ndërtoheshin edhe me kredi, duke e ruajtur solvencën e shtetit;

3) Shumë po dhemb me e ditë që me një fjalë goje fillimisht iu falen 60 milionë euro obligime të paguara ambalazhuesve të ujit. Dikush ia tërhoqi vërejtjen se nuk është vendim ligjor, dhe tha ani prale t'iu krijohen lehtësira për ta përmbushur obligimin. Por kurrsesi nuk i shkoi në mendje të kërkonte nga Administrata Tatimore që këto firma të dënoheshin dhe t'iu mblidheshin obligimet me zor, ashtu siç e parasheh ligji. Dhemb me ditë që ATK-ja i ndjek taksapaguesit e rregullt kur ata vonohen, përderisa lejon që evazoni fiskal ta mbërrijë gjysmëmiliardëshin;

4) Po dhemb shumë të kuptosh se Kosova është futur në një marrëveshje për ndërtimin e një termocentrali nga e cila del gjithësi humbëse: po u realizua, Kosova do të punojë për firmën private, pothuajse fantome. Po nuk u realizua, do t'i humbë 19 milionë euro,

që duhet të na bëjë të kërcejmë prej gëzimit;

5) Po dhemb me ditë që 290 mijë euro tonat u janë falur të dënuarve për një incident të paprecedentë në Kumanovë, në kundërshtim madje me ligjin që ndalon luftimet jashtë vendit. Ata njerëz dikur do të dalin nga burgu - a mos ndoshta hapi i ardhshëm do të jetë futja e tyre në listat e veteranëve, nëse tashmë nuk janë aty;

6) Shumë po dhemb avullimi i 600 mijë eurove për kremtimin e 10-vjetorit të Pavarësisë. Me gjithë premtimin e organizatorëve, raporti financiar kurrë nuk u bë publik. E nëse pesë koncerte të dështuara në tri podiume të montuara nëpër sheshet e Prishtinës bëjnë kaq shumë para, krejt Kosova do të duhej të niste të merrej me muzikë, se ia qet me marrë para për "artin" që prodhon;

7) Edhe më shumë po dhemb që 1 milion euro janë ndarë nga buxheti për t'ia dhënë KOSTT-it, e që ky më pas do t'ia japë KESCO-s për t'iu mbuluar shpenzimet e paguara të rrymës së serbëve në veri. Deklarata se kjo është një zgjidhje provizore për nuk e di çka, se nuk e mora vesh çka deshi të thoshte autori, është rrenë e kulluar, sepse ne po vazhdojmë ta paguajmë rrymën në veri. Mbështetur në faturën e muajit të shkuar, gjendja nuk ka ndryshuar - pagesa vazhdon njësoj;

8) Shumë po dhemb kur po e di se 1 milion euro në vit do të na shkojnë për 70 badihavxinjtë zëvendësministra, të cilëve kryeministri as emrat nuk ua di. Po aq dhimbje po shkakton Qeveria më e madhe në botë, që shpenzon paratë publike kryesisht në shëtitje dhe në projekte fitimprurëse për partitë në pushtet, e që e gllabëron një pjesë të madhe të buxhetit;

9) Po dhemb me ditë që prioriteti i vetëm për kryeministrin është rritja e rrogave për veten dhe për anëtarët e kabinetit qeveritar, pa përfillur as ligj, e as një send;

10) Po dhemb me ditë që rezervat shtetërore të Kosovës janë shpenzuar në aktivitete improvizuese që lidhen për vendimet që i teken kryeministrit. Po dhemb, kur kuptohet lehtësia me të cilën kërkohen 1 milion euro për shënimin e 550-vjetorit të Skënderbeut. Me siguri me këto para janë paraparë të mbahen dhjetë koncerte në katër bina me 10 shikues edhe ndonjë flamur aty-këtu.

EDHE DHJETË DHIMBJE

11) Po dhemb shumë kur dihet se kjo Qeveri varet nga një a dy vota, apo më mirë thënë varet nga serbët që mund ta rrezojnë atë kur të donë dhe për çfarë të donë. Po dhemb edhe kur kupton se kauzat politike që kinse mbështeten në parime, në fakt avullohen si flluska sapuni vetëm për rehatinë personale. Po dhemb kur ke të bësh me njerëz që i hanë fjalët e veta për mungesë integriteti;

13) Po dhemb shumë kur kupton se e ke një Kuvend që merret me shfaqje e jo me punë; kur kupton se deputetët e partisë së kryeministrit, për të njëjtën çështje e flasin të kundërtën e asaj që e kanë thënë në legjislaturën e kaluar;

14) Shumë po dhemb kur e kupton me çfarë lehtësie është lejuar shkatërrimi i natyrës në grykën e Deçanit, kinse në kërkim të gjetjes së burimeve alternative të energjisë. Ndalja e rrjedhës së lumenjve veç do ta shkatërrtojë edhe më shumë biodiversitetin dhe do të na lërë edhe më të shkretët seç jemi;

15) Shumë po dhemb kur të bien në dorë raporte shkruar nga të huajt, që tregojnë për shkatërrimin

e pyjeve dhe shitjen e pishave të zeza në të zezën;

16) Edhe më shumë po dhemb kur e sheh se për pesë muaj Mitrovica as që është përmendur ndonjëherë në ndonjë mbledhje të Qeverisë apo të Kuvendit - thujase kemi çuar duar nga ajo;

17) Po dhemb shumë kur po e di se po shkojmë në Bruksel të bisedojmë për çështje teknike, derisa Serbia po bën plane si të na copëtojë e të na bëjë edhe më pak funksionale, sepse e fut krejt makinerinë diplomatike e shkencore për këtë punë. Ne kënaqemi me pranimin e këngëtarëve në audienca private/publike nëpër kabinete e zyra;

18) Po dhemb shumë me ditë se gjyqësia është aq e politizuar, saqë qëllimisht bëhet jofunksionale. Dhemb shumë kur kupton se nuk mund të kesh besim në asnjërin institucion, për shkak se gjithkush i ka shtrirë interesat personale në to, për ta mbajtur pushtetin;

19) Po dhemb lehtësia me të cilën EULEX-i për tre vjet i ka dorëzuar 20 lëndë "të mëdha", për shkak se nuk ka pasur vullnet as bashkëpunimi e as intence për t'i ndryshuar ligjet procedurale që do të rezultonin me bile ndonjë aktgjykim ndëshkues;

20) Po dhemb me ditë sesi dikur e vetmja ndërmarrje fitimprurëse e Kosovës u soll në buzë të falimentimit veç për t'u shitur më lirë, ose për të mbaruar në arbitrazh. Po dhemb që lihet ende pa udhëheqës, edhe pse prej kohësh është ditur që mandati i drejtorit do të skadonte në shkurt.

Me këso Qeverie, derisa t'i zgjatë jeta, Kosova do të përjetojë vetëm dhimbje. Të ngjashmet që ia shkaktojnë secila qeveri para-prake, me po të njëjtat parti politike që po dëshmojnë përherë më të pasinqerta dhe të papërgatitura për ta mbajtur pushtetin për të bërë ndryshime pozitive. Sepse të gjithë deri tash kanë dëshmuar se ndryshimi i vetëm që u intereson është emri i atij që do të ulet në këtë apo atë kolltuk. Dhe përderisa politikanët të mos e kuptojnë se popullit nuk i bën mirë po qe se mbetet pa pasuri, pa punë, pa shëndet, pa shkollë, pa kulturë, pa sport - ky popull do të vazhdojë ta vuajë dhimbjen e dyfishtë: të asaj që ia shkaktojnë politikanët injorantë, arrogantë dhe të pandërgjegjshëm, dhe të asaj që ia shkakton vetes me defetizmin e vet. Po dhemb që po ju durojmë! (koha.net)



Nga
Flaka SURROI

HISTORIA E JASHTËZAKONSHME E GANGSTERIT BUGSY SIEGEL DHE LAS VEGASIT

LUMË GJAKU DHE PARASH

Kontrabandist, vrasës me pagesë, trafikant droge, më i shpejtë për të tërhequr këmbëzën sesa për të menduar, fitoi famë jo vetëm për rekordet e tij të përgjakshme, por edhe për pamjen: i gjatë me sy bojëqielli, karizmatik, joshës, i pëlqenin veshjet e mira, vanitoz



Pak më vonë se ora 8 e mëbrëmjes së 20 qershorit të 1947 Benjamin Siegelbaum-i, 41 vjeç, i ulur me shpinë nga dritarja në vilën e tij në Beverly Hills hapi televizorin të shihte lajmet e "Los Angeles Times", por nuk pati mundësi t'i shihte lajmet e ditës: një shi plumbash, kalibri 30 dolën nga një karabinë M1 dhe hoqën qafe nga kjo botë. Dy në kokë, të tjerat në trup dhe disa të tjera në mobiljet e kushtueshme. Kishte lindur në 28 shkurt të 1906 në Williamsburg, Nju Jork, fëmijë i një çifti emigrantësh hebrej të varfër, Max Siegelbaum dhe Jennie Goldstein.

Vdiq në mesin e një karriere pa dyshuar që vepra e tij më e madhe kishte filluar në vitin 1829, atëherë kur udhëtari spanjoll Antonio Armijo mbi një mushkë zbuloi se ajo shkretëtirë e Mojave-s e përshtatshme për insektet dhe gjarpërinjtë kishte një sërë lëndinash (vegas), oaze që ngjyrosnin në jeshile atë botë të thatë e të paanë. Për këtë arsye, Armijo e pagëzoi Las Vegas. U themelua si qytet në 15 maj të 1905 me 352 km katrorë dhe me një ADN prej "Sin City". Në vitin 1931 u legalizuan lojërat e kazinove dhe Benjamin Siegelbaum që në atë kohë quhej Ben Siegel dhe që urrente nofkën Bugsy (i lojtur), ndërsa kalonte këtë shkretëtirë me Kadilakun e tij V16 i shkrepri një ide, një vizion që në atë vend do të ngrinte perandorinë e tij. Fëmija i dytë i Max-it dhe Jennie-it, adoleshent i përbetuar të dilte nga varfëria, braktisi shkollën dhe iu bashkua një grupi gangsterësh që vepronin në rrugën Lafayette Street, Lower East Side në Manhattan.

Nga hajdut ordiner filloi ngjitjen e tij si mbledhës taksash tek një mafioz i vogël, Moe Sedway. Shumë shpejt filloi një ngjitje tjetër, zuri miqësi me Meyer Lansky-in, shef të mafias hebreje dhe kështu filloi sagën e tij kriminale mes atyre radhëve. Kontrabandist, vrasës me pagesë, trafikant droge, më i shpejtë për të tërhequr këmbëzën sesa për të menduar, fitoi famë jo



vetëm për rekordet e tij të përgjakshme, por edhe për pamjen: i gjatë me sy bojëqielli, karizmatik, joshës, i pëlqenin veshjet e mira, vanitoz. Bleu një shtëpi në Scarsdale, u bë i njohur në jetën e natës njujorkeze dhe lidhi miqësi me emra të shquar të Hollivudit: George Raft, Clark Gable, Gary Cooper, Cary Grant, Jean Harlow, Tony Curtis, Frank Sinatra dhe me të pushtetshmit Louis Mayer dhe Jack Warner. Në vitin 1929 u martua me Esta Krakower, një e dashur e fëmijërisë. Nga kjo martesë lindën dy vajza. U divorcuan në 1946.

Ekstravaganti Bugsy kishte dhjetëra prona dhe kishte shpenzuar pasuri të tëra në festa në banesën e tij në Beverly Hills. Gjatë Luftës së Dytë Botërore premtoi një nga deliret e tij më të mëdha, të vriste Benito Musolinin, Hermann Göring-un dhe Joseph Goebbels-in. Në vitet 30, në mes të shkretëtirës e pa veten si monarkun më të madh të bizneseve të imagjinuar ndonjëherë. Një hotel gjigand me

dhjetëra tavolina loje, alkoolin më të mirë, ushqimin më të sofistikuar dhe me shfaqje të përhershme nga yjet më të njohur. Një hotel që do të quhej Flamingo për nder të së dashurës së tij, Victoria Hill, këmbët e gjata të së cilës i ngjanin me një flamingo. Kostoja do të ishte e lartë, por e bindi Lansky-in dhe ortakë të tjerë që të investonin në këtë vepër magjike të shkretëtirës. Punimet filluan në 1945, kostoja e vlerësuar 1 milionë dollarë dhe Bugsy Siegel si dizenjator, shef, mandator absolut me kapriço delirante dhe me modifikime të shumta të planeve. Në tetor të 1946 shuma fillestare u ngjit

në 4 milionë dhe pak më vonë në 6 milionë. Humori i keq dhe mosbesimi penetruan në lëkurën e investitorëve, por Flamingoja me figurën e tij prej neoni të kuq hapi portat në 26 dhjetor të 1946, kishte përfunduar vetëm kazinoja, salloni, teatri dhe restoranti. Një katastrofë erdhi për Bugsy-in, sepse atë natë shpërtheu në një stuhit biblike. Për dy javë kazinoja kishte humbur 275 mijë dollarë. U rihap në 11 mars të atij viti me Meyer Lansky-in prezent dhe filloi të nxjerrë fitime, por grupi i investitorëve mafiozë e kishin dhënë verdiktin e tyre. Jo vetëm që kishte kaluar koston 7 herë nga ajo

fillestare, por për diçka më të rëndë. Bugsy kishte vënë si administratore gjatë ndërtimit Victoria Hill që me duart e gjata, ashtu si edhe këmbët kishte vjedhur 2 milionë dollarë dhe i kishte fshehur në një parajsë fiskale. Sipas raportit të policisë 4 nga 9 plumbat e qëlluar atë natë ishin mbi një statujë të perëndisë Baku, mbi një piano dhe që kishin mbetur në mur. 5 të tjera ishin mbi Bugsy-n. Të nesërmen u shfaq në faqen e "Los Angeles Herald-Express", por jo me sjelljen e të fortit, vetëm në një pozë me etiketën e emrit të lidhur në gishtin e këmbës së djathtë, si çdo kufomë tjetër morgu. Tek Flamingoja kishte vetëm një pllakat që jo gjithmonë pastrohej.

Ajo që mbeti nga hoteli origjinal u shemb në vitin 1993. Bugsy-i është i varrosur në varrezën e "Hollywood Forever", në mesin e asaj Kalifornie që mbyti në gjak. Lansky, Dutch Schultz, Frank Costello, Vito Genovese, Albert Anastasia, Joe Adonis dhe Salvatore Maranzano, gangsterët e famshëm vdiqën keqazi. Al Capone nga sifiliz, pasi doli nga burgu, Lucky Luciano nga infarkti. Ishte fundi i një epoke, por jo i mafias që me kalimin e kohës riciklohet, transformohet, vesh veshje të tjera, shkon në lartësi të tjera, mëson teknologjinë dhe vazhdon ende të vrasë. (bota.al)

GJITHMONË NË DUART E MAFIOZËVE

Pas vdekjes së Bugsy Siegelit dhe gjithmonë në duart e mafiozëve, Las Vegas u rrit në progresion gjeometrik. Flamingoja ishte fara e artë e një korrije të paimagjinueshme dhe aq më pak në shkretëtirë. Aty mbretëruan për vite Frank Sinatra dhe Rat Pack, Dean Martin, Sammy Davis Jr., Joey Bishop, Peter Lawford dhe sigurisht Elvis Presley. Në hotelet e këtij qyteti dashuruan, fjetën dhe u droguan, sfiluan prostituta të klasit A dhe tutorët e tyre zbuluan një mënyrë për të ndaluar kohën. Marramendja e dritave dhe e tingujve, fluksi i dollarëve shembën katedrale dhe ndërtuan të tjera më të mëdha, imituan Venecian dhe varkat pirate, vullkane, malet ruse. Las Vegas, parku më i madh i dëfrimeve në planet. Nëse dikush do t'i avitet varrit të Bugsy Siegel-it dhe t'i pëshpëritë: 122 kazino, 1700



tavolina loje, 180 000 makina paranxjerrëse, 500 kisha, norma të larta vetëvrasjesh, fitohen shuma kolosale, por edhe humben dhe 42 milionë njerëz pelegrojnë për zotërit e kumarit. Dhe ka të ngjarë që ky gangster i pamëshirshëm t'jua kthejë përgjigjen: "Nuk u gabova!".

Nuk ka asnjëherë një moment të mërzitshëm në Shtëpinë e Bardhë të Donald Trumpit. Së fundmi, Trump e ka tronditur me themel ekipin e tij të sigurisë kombëtare, vetëm pak ditë pasi shpalli një sipërmarrje diplomatike me përmasa historike me Korenë e Veriut. Të martën në mëngjes, presidenti largoi pa shumë ceremoni Sekretarin e Shtetit, Rex Tillerson (që thuhet se e mësoi shkarkimin prej postimit të Trumpit në Twitter), duke e zëvendësuar atë me drejtorin besnik të CIA-s, Mike Pompeo. Trumpi promovoi edhe Gina Haspelin, zëvendës drejtore e CIA-s, duke e vënë në krye të agjencisë. Ajo do të jetë e para grua që merr frenat e agjencisë 70-vjeçare të spiunazhit. Të dy pozicionet duhet që të marrin konfirmimin në Senat, por gjasat janë që Pompeo dhe Haspel të konfirmohen (edhe pse dëgjesa për Pompeon mund të jetë pak më e vështirë).

Po pyetja është: Përse largohet Tillerson? Çfarë e shkaktoi këtë shkundje të madhe në sigurinë kombëtare? Gjithçka mund ta dallosh në vlerësimin që presidenti i bëri Pompeos: "Shumë energji, shumë intelekt. Ne jemi gjithmonë në të njëjtën gjatësi vale. Marrëdhënia ka qenë shumë e mirë, dhe këtë kam nevojë unë nga një Sekretar Shteti".

Jemi në të njëjtën gjatësi vale. Kjo është kyçe. Që nga dita e parë, refuzimi i Pompeos për t'u ndarë publikisht nga Trumpi, gatishmëria e tij për të dalë garant për informacionet dhe besueshmërinë shpesh të dyshimtë të shefit të tij, e kanë bërë Trumpin të mendojë se mos Pompeo, i cili e informon Trumpin përditë dhe e takon më shpesh se sa Sekretari i Shtetit, do të ishte më mirë si kryediplomat i tij? Pompeo është tipi që i përshtatet Trumpit.

"DON'T CROSS THE BOSS"

Përse Trumpi largoi Tillersonin

Ai do e mbrojë shefin me çdo kusht. Kjo lloj besnikërie ka qenë gjithmonë absolutisht kritike për Trumpin. Tillerson, sigurisht, nuk ishte i tillë.

Ish-drejtori i Përgjithshëm i ExxonMobil e ka quajtur presidentin "moron", pas një mbledhje verën e kaluar - dhe më pas nuk e mohoi. Që nga ajo kohë, ai i ka kaluar gjashtë muajt e fundit duke luajtur një pjesë shumë të vogël në procesin e politikave egocentrike të presidentit. Tillerson e kundërshtonte Trumpin për gjëra të mëdha e të vogla. Sa për një shembull, pak orë përpara se të shkarkohej, Tillerson u duk se u distancua nga presidenti duke fajësuar Rusinë për një sulm me gaz nervor në Angli. Gjëra të til-

la zor se i shpëtojnë vëmendjes së Trumpit. "Marrëveshja e Iranit. Ai mendonte se ishte në rregull. Nuk mendonim njësoj", tha presidenti.

Por le të jemi të sinqertë. Në të vërtetë ka qenë ajo shprehja "moron". Ai ishte fillimi i fundit. Nëse ka një gjë që komandanti ynë i përgjithshëm "gjeni shumë i qëndrueshëm" nuk e duron dot, është që të fyhet dhe të pengohet. Nuk kish shanse që Tillersoni të zgjaste. Në disa drejtime, është e habitshme që zgjati edhe kaq shumë. Dhe tani Amerika do të ketë një tjetër Sekretar Shteti, më besnik. Si do të jetë Departamenti i Shtetit i Pompeos? Kur të jetë përballë komitetit të marrëdhënieve me jashtë në Senat, ai me siguri do të merret në

pyetje nga demokratët dhe republikanët, nëse do ta ribëjë departamentin, i cili është dobësuar në Tillersonin. Megjithatë, çfarëdo që ai të thotë, nuk do të jetë shumë pengesë. Senati do të dojë që Trumpi të ketë një ekip të plotë përpara fillimit të negociatave serioze me Korenë e Veriut. Ata gjithashtu mund ta shohin Pompeon si dikë që mund ta shtyjë Trumpin të bëjë një hap prapa, kur flitet për luftën tregtare. Ndërkohë, Haspel, një njeri i respektuar në CIA, do të përballlet me pyetje në lidhje me njohuritë e saj për politikën e CIA-s për ndalimin, marrjen në pyetje si dhe gatishmërinë për të thënë të vërtetën para presidentit, sidomos kur flitet për Rusinë. Ajo do të

Gjasat janë që Trumpi të lëvdohet nga profesionistët e sigurisë kombëtare për këtë zgjedhje. Mësimet e largimit të Tillerson duhet të jenë të qartë për anëtarët e ekipit të Trumpit: Don't cross the boss! (Mos ia zër rrugën shefit). Ai thjesht nuk e duron dot

mbikëqyrë reagimin e fshehtë të Amerikës ndaj ndërhyrjeve ruse në zgjedhje, dhe në fund të fundit, njohuria e saj është më e thellë se e Pompeos. Gjasat janë që Trumpi të lëvdohet nga profesionistët e sigurisë kombëtare për këtë zgjedhje. Mësimet e largimit të Tillerson duhet të jenë të qartë për anëtarët e ekipit të Trumpit: Don't cross the boss! (Mos ia zër rrugën shefit). Ai thjesht nuk e duron dot. (The Week)

Berners-Lee, paralajmëron se kompani të tilla si Google, Facebook dhe Twitter janë bërë me pozita shumë dominuese në treg, promovojnë dezinformacionin dhe reklamat manipuluese politike si dhe shfrytëzojnë të dhënat personale të përdoruesve

World Wide Web festoi më 12 mars ditëlindjen e tij të 29 dhe themeluesi britanik, Tim Berners-Lee zgjodhi pikërisht këtë ditë për të dhënë alarmin se disa kompani të mëdha të teknologjisë kanë shumë pushtet dhe se duhen imponuar rregullime dhe kufizime ndaj tyre. Në një letër të hapur të Fondacionit të Fondacionit World Wide Web dhe të nënshkruar nga

BABAI WEB-it JEP ALARMIN!

vetë ai, por edhe në një intervistë për Financial Times, Berners-Lee, paralajmëron se kompani të tilla si Google, Facebook dhe Twitter janë bërë me pozita shumë dominuese në treg, promovojnë dezinformacionin dhe reklamat manipuluese politike si dhe shfrytëzojnë të dhënat personale të përdoruesve. Ai thotë se, ka nevojë urgjente për një kuadër të ri ligjor dhe rregullator që do të kufizonte fuqinë e kompa-

nive të mëdha të teknologjisë, të cilat janë bërë të pakontrollueshme, pa u dhënë llogari përdoruesve. Ndër të tjera, propozon që kompanitë e mediave sociale t'u japin përdoruesve më shumë kontroll mbi të dhënat e tyre.

"Është koha për një reagim nga ana e njerëzve në Europë. Sigurisht që ne mund të imagjinojmë një botë më të mirë ... ku të kemi mundësi zgjedhjeje për motorët e

kërkimit dhe rrjetet sociale. Në një botë më të mirë dikush duhet të ketë një kontroll të plotë mbi informacionin që i serviret"-shprehet Lee, cituar nga ResPublica. Google zotëron tani mbi 87% në kërkimet në internet në mbarë botën, ndërkohë që Facebook ka tejkaluar 2.2 miliardë përdorues në muaj. Së bashku të dy kompanitë (duke përfshirë filialet e tyre Instagram dhe YouTube) thithin më shumë

se 60% të shpenzimeve globale për reklamat dixhitale.

"Web-et në të cilat hyje vite më parë, nuk gjenden nga përdoruesit e rinj sot. Ajo që dikur ishte një gamë e gjerë e blogjesh dhe faqesh e internetit, është kufizuar në disa platforma, që kontrollojnë cilat ide dhe mendime duhet të ndash"- thotë ai në letëren e hapur. Ai thekson se disa nga gjigandët e teknologjike rriten vazhdimisht nëpërmjet blerjeve të kompanive më të vogla konkurruese, ndërsa thithin talentet e reja, duke vendosur hegjemoninë edhe mbi risitë në këtë fushë. "Unë dua që interneti të reflektojë shpresat tona në vend se të thellojë frikën dhe ndarjet midis nesh". Në vitin (2018), për herë të parë më shumë se gjysma e banorëve të Tokës janë me akses në internet, çka sipas vërteteton ekzistencën e një ndarje dixhitale. Tim Berners-Lee u bën thirrje qeverive, kompanive dhe aktorëve të tjerë për të përmirësuar qasjen në internet nëpërmjet rrjeteve të komuniteteve dhe sigurimin e qasjes (Wi-Fi) në vende publike.





PLANI AMERIKAN SIPAS MEDIAVE SERBE

Pavarësisht se nuk përmendet fjala apo termi termi "Pavarësi", plani e shtyn në njohjen de fakto të Kosovës nga Serbia

Pas paketave të përgatitura për Korënë e Veriut, Washingtoni mendohet se ka gati një plan prej 4 pikash, që nxit njohjen përfundimtare të pavarësisë së Kosovës nga Serbia.

Mediat serbe shkruajnë se plani i është dërguar presidentit serb Aleksandar Vuçiç dhe do të shqyrtohet javën e ardhshme në Beograd e Prish-

tinë gjatë vizitës së ndihmës-sekretarit amerikan të shtetit Ues Miçell.

Sipas planit duhet që: Bashkësia e Komunave serbe të marrë kompetenca ekzekutive të gjera, veçanërisht në shëndetësi, arsim e kulturë; Qeveria e Kosovës duhet të ketë një zv/kryeministër nga radhët e komunitetit serb, i cili do të ketë rolin e drejtuesit të ekzekutivit për këtë bashkësi; Bashkësia do të jetë e lidhur ngushtë me nënkryetarin e qeverisë së Kosovës, i cili do të vijë nga radhët e popullit serb; Beogradi të lejojë Prishtinën të bashkohet me organizatat ndërkombëtare;

Nëse pala serbe bie dakord me këtë paketë, Serbia do të lejohet të bashkohet me Bashkimin Evropian pasi Shtetet e Bashkuara do të garantojnë

mbështetjen e saj më të gjerë ekonomike dhe diplomatike në arenën politike ndërkombëtare.

Pavarësisht se nuk përmendet fjala apo termi termi "Pavarësi", plani e shtyn në njohjen de fakto të Kosovës nga Serbia.

Por gjatë vizitës në Kosovë ndihmës-sekretarit amerikan të shtetit Ues Miçell u pyet nga gazetarët nëse në Beograd e Prishtinë sjell ndonjë plan të ri për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, plan që u spekulua shumë në mediat serbe e që u transmetua edhe në ato të Kosovës. Mitchell u shpreh se vizita e tij nuk kishte asnjë plan të tillë.

'Po i kam lexuar këto spekulime, por unë kam ardhur për t'i dhënë shtysë dialogut ndërmjet Prishtinës e Beogradit', tha ai.

Kwai Hong Ip - Prokuror i ri Special



Zyrtarët e Prokurorisë Speciale kanë deklaruar se në fund të këtij muaji i skadon mandati kryeprokurorit David Schwediman, ndërsa nga fillimi i muajit të ardhshëm kompetencat do t'i kalojnë prokurorit Kwai Hong Ip. Ata thonë se Hong Ip do ta sigurojë vazhdimësinë

dhe do ta ruajë ritmin e hetimeve.

Por nga korriku i vitit të kaluar, kur ky institucion ndërkombëtar i drejtësisë është plotësisht funksional, ende nuk është ngritur asnjë aktakuzë.

Pavarësisht se kryeprokurori i Gjykatës Speciale David Schwediman

përfundon mandatin e tij në fund të këtij muaji, Dhomat e Specializuara do ta vazhdojnë punën e tyre pa kurrfarë pengese. Kështu kanë bërë të ditur si nga Zyra e Prokurorit Special, ashtu edhe nga Zyra e Dhomave të Specializuara.

Christopher Bennett, zëdhënës në Zyrën e Prokurorit Special, ka thënë për "Zërin" se Kwai Hong Ip do të bëhet prokuror special më 1 prill, në mënyrë që ta sigurojë vazhdimësinë dhe ta ruajë ritmin e hetimeve, porse nga Dhomat e Specializuara kanë bërë të ditur se shumë shpejt do të fillojë procesi i zgjedhjes së prokurorit të ri, me ç'rast do të shpallet edhe ftesa për aplikim për prokurorin special.

Maja Kocijançiq, zëdhënëse për Politikën e Jashtme të BE-së dhe për Politikën e Sigurisë, ka thënë se procesi për emërimin e një prokurorit të ri do të bëhet në përputhje me Ligjin mbi Dhomat e Specializuara, Prokurorinë Speciale, legjislacionin dhe procedurat e tjera përkatëse.



Ja kushtet e punës në BE për kosovarët

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale Skender Reçica, tha se në një të ardhme të afërt Kosova do të ketë marrëveshje për punësime sezonale me shtetet e BE-së. 'Brenda këtij viti së paku me një shtet të BE-së, do të ketë marrëveshje për punësim sezonal me shtetet e BE-së', tha ai. Sipas tij Kosova ka kuadro për të punësuar në BE punëtorë. Ai ka folur edhe për punësimet që po bëhen në Gjermani. Reçica ka folur edhe marrëveshjen për sigurime sociale në mes të Kosovës dhe Belgjikës. "Përfitimet do të mund t'i marrin pa pasur nevojë për të shkuar në Belgjikë. Jemi në fazën finale dhe të ratifikohen në Parlamentet përkatëse", tha ai në RTK.

Ai ka paralajmëruar se do të ketë marrëveshje edhe me shtetet e tjera si me Zvicrën, Austrinë, etj. Ministri foli edhe për angazhimet e tij në fushën e punësimit etj. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale Skender Reçica, ka paralajmëruar edhe ndryshime për skemat pensionale. Reçica tha se në një të ardhme do të ketë edhe marrëveshje për punësime sezonale. 'Brenda këtij viti do të ketë punësime sezonale me shtetet e BE-së', tha ai. Ai ka vlerësuar se për herë të parë në Kosovë do të ofrohet trajtim meritore edhe për nënat lehone të punësuarra dhe të papunësuarra.

"Ujqërit e natës" të Putinit, turne në Serbi dhe Bosnje

Klubi i motoristëve rusë "Ujqërit e natës", i njohur për nacionalizëm dhe besnikëri ndaj presidentit Vladimir Putin, ka njoftuar se do të bëjë një turne në Bosnje dhe Serbi në mes të marsit. Dhjetëra anëtarë të grupit, i cili është nën sanksione të SHBA-së për shkak të rolit të tij në luftën e separatistëve pro-rusë në lindje të Ukrainës, do të bëjë turne në vendet ballkanike "për të hulumtuar ndikimin kulturor të Perandorisë Ruse në Ballkan", tha grupi në ueb-faqen e tij. Ministri për Siguri Kombëtare i Bosnjës, Dragan Mektiq, i ka kritikuar me herët "Ujqërit e natës", duke thënë se ata synojnë të frikësojnë serbët e moderuar të Bosnjës dhe jo-serbët, përpara zgjedhjeve në tetor. "Ujqërit e natës" nuk janë "klub i motoristëve tipikë, ata bartin mesazhe të fuqishme politike", ka thënë Mektiq, duke cituar raportet e mëhershme se grupi planifikon të hapë një zyrë në Banja Llukë për të monitoruar zgjedhjet. "Ujqërit e natës" thanë se anëtarët e tyre do të vizitojnë Bosnjën dhe Serbinë për rreth nëntë ditë, nisur nga 19 marsi, në Beograd.



HELMIMI I ISH AGJENTIT RUS SERGEI SKRIPALIN

KEQËSOHEN MARRËDHËNIET NË MES TË LONDRËS DHE MOSKËS

Prokurorët rusë deklaroi se Skripal ishte paguar rreth 100,000 dollarë nga MI6 për informacion dhe ai i kishte furnizuar britanikët me të dhëna që nga vitet 1990 kur ishte oficer shërbyes. FSB, agjencia ruse e sigurisë, tha se informacioni i kaluar në MI6 nga Skripal përbënte sekrete shtetërore

Kryeministrja e Britanisë, Theresa May, pritet të shpallë një sërë masash kundër Rusisë, pasi kjo e fundit nuk e ka përmbushur afatin e saj për të shpjeguar se si një agjent nervor, prodhim rus, është përdorur për të helmuar një ish-spiun rus në Britani.

Rusia ka mohuar çdo përfshirje në përpjekjen për të vrarë Sergei Skripalin dhe vajzën e tij Yulia, në Sallsbëri.

May do të takojë zyrtarë të lartë



të inteligjencës, ndërsa më pas do t'iu drejtohet ligjvënësve britanikë.

Moska ka thënë se nuk do t'i përgjigjet ultimatumit të Britanisë derisa nuk i jepet qasje në substancën kimike të përdorur në sulm.

Zyra e kryeministres May tha se ajo ka marrë mbështetje nga presidenti amerikan, Donald Trump, me të cilin janë pajtuar gjatë një bisede telefonike se Moskë "duhet të ofrojë përgjigje të qarta për atë se si është përdorur agjenti nervor".

Kërcënimet nga Britania e Madhe për sanksione kundër Rusisë për shkak helmimit të ish-spiunit Sergei Skripal, nuk do të mbe-

ten pa përgjigje, kumtoi Ministria ruse e Punëve të Jashtme.

"Çfarëdo qoftë kërcënim për sanksione ndaj Rusisë nuk do të mbeten pa përgjigje. Pala britanike duhet ta kuptojë këtë", thekson Ministria. Sipas tyre, pohimet se Rusia është involvuar, janë të rrejshme dhe "ky është provokim".

"Rusia nuk do t'i përgjigje ultimatumit të Britanisë, derisa nuk i merr analizat nga substanca kimike e përdorur gjatë helmimit të Skripalit dhe derisa Londra nuk fillon të veprojnë në pajtim me obligimet nga Konventa për ndalesë të armëve kimike me të cilën është paraparë hetim i përbashkët për raste të tilla", përmendet në kumte-

sën e Ministrisë ruse të Punëve të Jashtme.

Ndërkaq, Presidenti amerikan Donald Trump deklaroi se "tingëllon" sikur Rusia është përgjegjëse për helmimin e ish spiunit Sergei Skripal dhe vajzës së tij në Britani duke shtuar se për këtë do të bisedojë me Kryeministren britanike Tereza Mej.

"Tingëllon sikur besojnë që Rusia është përgjegjëse dhe gjithësi këto dyshime do t'i kuptojë si fakt. SHBA-ja do ta dënojë Rusinë nëse kjo përputhet me rezultatet britanike", deklaroi Trump para se të udhëtojë në Kaliforni.

Sipas informacioneve të deritanishme të Britanisë, Skripal dhe

vajza e tij janë helmuar më 4 mars me agjens nervor ushtarak i prodhuar në Rusi.

Por edhe ministri gjerman i Punëve të Jashtme Zigmari Gabriel deklaroi se Berlina është "shumë i shqetësuar për shkak helmimit të ish-spiunit Sergei Skripal dhe vajzës së tij në Sallsbëri dhe se shpreh solidaritet me Britaninë.

Ai kumtoi se në telefon ka biseduar me ministrin britanik të Punëve të Jashtme, Boris Xhonsen dhe ka shtuar se "Berlina e dënon sulmin me armët e ndaluara kimike me termet më të ashpra".

"Nëse konfirmohet se Rusia qëndron pas sulmit, kjo do të jetë vërtetë punë serioze", shkroi ai në kumtesë. Skripal shërbeu në inteligjencën ushtarake të GRU të Rusisë deri në vitin 1999, duke arritur gradën e kolonelit. Ai pastaj punoi në zyrën e ministrisë së jashtme ruse në Moskë deri në vitin 2003, kur ai hyri në 'biznesin e spiunazhit'.

Ai rezultoi i dënuar me 13 vjet burg, pasi në gusht të vitit 2006 u dënua për "tradhti të lartë në formën e spiunazhit".

"Prokurorët rusë deklaroi se Skripal ishte paguar rreth 100,000 dollarë nga MI6 për informacion dhe ai i kishte furnizuar britanikët me të dhëna që nga vitet 1990 kur ishte oficer shërbyes.

FSB, agjencia ruse e sigurisë, tha se informacioni i kaluar në MI6 nga Skripal përbënte sekrete shtetërore.", shkruan 'The Guardian'.

Refugjatët që kalojnë kufirin italo-francez përshkojnë një rrugë të rrezikshme për jetën. Popullsia vendase i ndihmon

"Katër vetë, po kalojnë kufirin. Duhet të nisemi, ndryshe nuk i arrijmë", thotë Philippe Zanetti. Së bashku me dy fqinjët e tij ai ndihmon refugjatët në kufirin italo-francez në zonën e Alpeve. Policia kufitare është në ndjekje të refugjatëve që fshihen kudo në pikë kalimin kufitar në Montgenèvre.

Ndihmësit u japin atyre gjëra të ngrohta që të mos ngrijnë gjatë rrugës kur kapërcejnë kufirin. Njerëzit që u ndihmojnë refugjatëve që të kalojnë ilegalisht kufirin,

Shpëtimtarët e refugjatëve në Alpe



rrezikojnë pesë vjet burg dhe gjobë prej 30 mijë eurosh. Por Philippe Zanetti thotë: "Ne e marrim parasysh rrezikun. Për ne ka rëndësi jeta e njerëzve". Para dy vjetësh dy refugjatë nga Mali ngrinë në përpjekje për të kaluar kufirin italo-francez. Njërit iu desh t'i prisnin

këmbët, tjetrit duart. Që atëherë banorët e zonës përpiqen që ngjarje të tilla të mos përsëriten. Gjithnjë e më shumë refugjatë vijnë me trena nga jugu në veri të Italisë, prej nga kalojnë kufirin për në Francë gjatë natës. Në stacionin e trenit në Bardonecchia është një

grup prej rreth 15 refugjatësh. "Ne do ta vazhdojmë rrugën më këmbë, do të shkojmë në Francë, sepse në Itali nuk kemi ç'bëjmë më. Nuk na i japin dokumentet", thotë një refugjat. Ata kanë qenë në kampet e torturave në Libisë dhe kanë kaluar nëpër Detin Mesdhe, prandaj nuk ka frikë të vazhdojnë rrugën as këtu mes Apleve, edhe pse deri në kufirin francez duhen edhe 32 kilometra. Në 1800 metra mbi nivelin e detit gjendet posta e kufirit. Policia kontrollon me kamera me rreze infra të kuqe. Prej motit të ftohtë disa refugjatë ngrijnë dhe në raste të tilla Philippe Zanetti dhe shokët e tij u vijnë në ndihmë, edhe pse e dinë se nëse kapen me refugjatë në makinë, rrezikojnë të futen në burg.

Philippe Zanetti thotë se ata nuk marrin para për këtë punë, ata ndihmojnë vullnetarisht që refugjatët të mos ngrijnë nga të ftohtët dhe të vdesin. Në Briançon, ka rreth 200 banorë, mes të cilëve edhe mjekë, që u ndihmojnë refugjatëve. Kryetari i komunës, Gérard Fromm, ka vënë në dispozicion qendrën e komunës për strehimin e refugjatëve, dhe paguan për ushqimin për rreth 2.000 ilegalë që ndodhen këtu në rrugëtim. "Kur ata vijnë këtu tek ne, na i ka sjellë Zoti për t'i ndihmuar që të marrin forcë dhe të vazhdojnë rrugën më tej. Në fakt më vonë ata do kenë probleme me legalizimin. Por fillimisht askush nuk merret me këtë çështje", thotë Gérard Fromm.



Prodhon shumë, 24-vjeçarja shet 500 litra qumësht gjiri për 7 muaj

Pak më shumë se shtatë muaj më parë lindi fëmijën e saj të parë, djalin e quajtur Anjelo. 24-vjeçarja Rafaela Lamprou nga Qipro, thotë se ndryshe nga shumë familje që njeh, asaj nuk i janë shtuar shpenzimet për rritjen e djalit. Përkundrazi, i janë shtuar të ardhurat. Trupi i Rafaelas nisi të prodhojë më shumë qumësht gjiri nga sa kishte nevojë djali i saj, Anjelo dhe 24-vjeçarja, për të mos e shpërdoruar vendosi që të kërkojë në internet. Aty gjeti në disa faqe persona, kryesisht meshkuj që kanë për pasion "bodybuilding" të interesuar që të paguanin për qumështin e gjirit.


Pa u menduar dy herë, 24-vjeçarja u vendos në kontakte me ta dhe nisi që të shesë qumështin e saj. Thotë se deri më sot ka shitur rreth 500 litra qumësht gjiri dhe vetëm nga shitjet ka grumbulluar rreth 6 mijë euro. Meshkujt që ushtrojnë "bodybuilding" besojnë se qumështi i gjirit ndihmon në rritjen e sasi-së së muskujve të tyre.



TAVOLINAT E QËNDRIMIT NË KËMBË MUND TË MOS JENË AQ TË MIRA PËR SHËNDETIN

Më mirë lexojeni këtë lajm ulur: tavolinat e qëndrimit në këmbë mund të mos jenë ndihmë për shëndetin sa mendonin disa që janë. Qëndrimi pranë tavolinës tuaj mund të krijojë "parehati dhe përkeqësim të reagimit mendor", gjë që mund të çojë në probleme të tjera me shëndetin dhe produktivitetin, raportojnë studiuesit në një studim të fundit të publikuar në revistën Ergonomics.

Gjetjet e reja janë në kundërshtim me hulumtimet e mëparshme, të cilat sugjeronin se ulja në një tavolinë për një kohë të gjatë mund të çojë në probleme afatgjata shëndetësore. Këto gjetje në vitet e fundit çuan në atë që kompanitë të ofrojnë "tavolina të qëndrimit në këmbë", si dhe tavolina të zakonshme që ngrihen në pozitë të qëndrimit në këmbë. Punëtorët kanë shprehur se qëndrimi në këmbë do të çojë në humbje peshe, zvogëlimin e dhimbjes së shpinës, shëndet më të mirë të zemrës dhe produktivitet më të mirë, sepse janë më të vëmendshëm. Studimi i ri, megjithatë, e kundërshton këtë pritje, thonë studiuesit. "Parehatia e qëndrimit të zgjatur u rrit (në të gjitha zonat e trupit), koha e reagimit dhe gjendja mendore u përkeqësuan ndërkohë që zgjidhja kreative e problemeve u përmirësua", shkruajnë hulumtuesit në studimin e ri. "Qëndrimi i zgjatur në këmbë duhet të ndërmerret me



Megjithëse shqetësimet shëndetësore për qëndrimin e zgjatur në pozitë të ulur janë reale, studimet e reja sugjerojnë se tavolinat e qëndrimit në këmbë nuk janë domosdo më të mira për shëndetin - ato mund të ndikojnë në qarkullimin e gjakut...

kujdes".

Për studimin e ri, të kryer në universitetin Curtin në Australi, 20 persona u vëzhguan gjatë dy orëve të punës me kompjuter duke qëndruar në këmbë në laborator. Studiuesit i ekzaminuan nivelet e parhatisë dhe funksionit kognitiv, së bashku me lodhjen e muskujve, lëvizjen, ënjtjen e gjymtyrëve të ulëta dhe gjendjen mendore. Me kalimin e kohës, raportuan studiuesit, parehatia u rrit në të gjitha

fushat e trupit dhe gjendja mendore e pjesëmarrësve filloi të ngadalësohet pas rreth 75 minutash - edhe pse vendim-marrja "kreative" u tregua të përmirësohej paksa.

"Konkludimi është se kjo përhapje e tavolinave të qëndrimit në këmbë është nxitur më shumë nga shkaqe komerciale sesa nga dëshmitë shkencore", tha Alan Taylor, ekspert i fizioterapisë në universitetin e Nottinghamit, për The Telegraph. "Por dëshmitë tashmë po arrijnë dhe po tregojnë se ekzistojnë disa të meta". Në vend të përdorimit të tavolinave për qëndrim në këmbë, Taylor i inkurajon njerëzit që të bëjnë më shumë ecje gjatë ditës së tyre të punës, një koncept ky që është mbështetur në studimet e mëparshme. Një

studim i vogël në universitetin e Missouriit në vitin 2015, ndër të tjerë, rekomandoi pauza periodike 10 minutëshe për ecje. Gjetjet e fundit gjithashtu lidhen me një studim 12-vjeçar të më shumë se 7.000 punonjësve të zyrave, të publikuar në janar, i cili zbuloi se njerëzit të cilët shpesh qëndronin në këmbë në punë kanë pothuajse dy herë më shumë të ngjarë të zhvillonin sëmundje të zemrës, në krahasim me ata që qëndronin më shpesh ulur. "Zemra duhet të punojë shumë më shumë, trupi duhet të punojë shumë më shumë, sepse po luftoni me gravitetin kur jeni duke qëndruar në këmbë", tha Alan Hedge, hulumtues i faktorit njerëzor dhe ergonomikës në universitetin Cornell.

Të dhëna alarmuese nga studimi për fëmijët mbipeshë

Të dhënat më të fundit për obezitetin tek fëmijët janë të frikshme. Sipas një studimi, 41% e 16-19 vjeçarëve janë mbipeshë, një rritje prej 36% kjo krahasuar me dy vite më parë. Shifrat janë akoma më shqetësuese për vajzat në këtë grupmoshë. 47.9% e tyre janë mbipeshë, krahasuar me 35.6% në vitet 2013-2014. E kjo nuk është një tendencë e mirë. Për ekspertët, shqetësuese



është edhe situata mes grupmoshës 2-5 vjeç, ku 26% e tyre janë

mbipeshë. Nëse krahasohen përqindjet, jo vetëm të fëmijëve

mbipeshë, por edhe atyre obezë, mes viteve 2013-2014 dhe 2015-2016, përqindja ka shkuar nga 9.3 në 13.7. Tendencat mes parashkollorëve janë veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh se studimet e kohëve të fundit kanë zbuluar se nëse një fëmijë është mbipeshë në periudhën parashkollorë, shanset janë që ata të qëndrojnë të tillë edhe kur të rriten.

Sëmundja X mund të zhdukë njerëzimin

Ata nuk e dinë se çfarë është Sëmundja X, por kushtet për shpërthimin janë të përsosur. Organizata Botërore e Shëndetësisë mban një listë të sëmundjeve të rrezikshme që përbëjnë një kërcënim serioz të shpërthimit. Gjatë një takimi të nivelit të lartë të shkencëtarëve më të mirë mjekësorë në botë, ata shtuan një tjetër në listën e rrezikut të lartë, të cilën e quajtën "Disease X".

Grupi, i bazuar në Gjenevë,

mblidhet çdo vit për të diskutuar se cilat sëmundje të reja përbëjnë potencialin më të madh për t'u kthyer në një epidemi globale. Ata kanë pranuar se nuk e dinë se çfarë është Sëmundja X, por llogaritjet e tyre paralajmërojnë se kushtet janë perfekte për shfaqjen e saj, raporton News.com.au. "Sëmundja X përfaqëson njohurinë se një epidemi serioze ndërkombëtare që mund të shkaktohet nga një patogjen që aktualisht

është i panjohur", tha OBSH në një deklaratë. Ajo beson se bota nuk është në një pozitë të mirë për t'u përgjigjur një surprize të tillë. "Historia na tregon se ka të ngjarë që shpërthimi i ardhshëm i madh do të jetë diçka që nuk e kemi parë më parë", tha për Telegrafin këshilltari i OBSH-së, John-Arne Rottengen. "Çështja është të sigurohemi që ne të përgatisim dhe të planifikojmë vaksinat dhe testet diagnostikuese".



SIMPTOMAT E DIABETIT QË NDOSSHTA NUK I NJIHNIT

Simptomat e diabetit janë të gjitha rreptësisht të lidhura me fenomenin e hyperglycemisë dhe shpesh janë veçanërisht debilitante për organizmin. "Ndërhyrja në kohë është thelbësore për diagnozën e sëmundjes së parakohshme dhe ndërhyrjen, e pasuar me një trajtim të përshtatshëm", shpjegon Alberto De Micheli, diabetolog i ACISMOM në Xhenova. Ja cilat janë simptomat



yndyrës në gjak, hipertension, pirja e duhanit, qëndrimi ulur për një kohë të gjatë, si dhe familjariteti. Tipari i përbashkët i dy llojeve të diabetit është përqendrimi i lartë i glukozës në gjak (hiperglicemia)

URINIM I BOLLSHËM DHE I SHPESHTË. Kur niveli i sheqerit në gjak është i lartë, trupi e eliminon atë me urinë: kjo rrit sasinë e urinës të dëbuar në 24 orë, e cila përmban sasi të larta të sheqerit. Zgjidhja dy herë në natë për të urinuar, kur nuk kishte ndodhur kurrë më parë mund të jetë një thirrje zgjidhje. Është pak a shumë e ngjashme kur fëmija urinon në shtrat.

NJË ETJE E FORTË. Me një eliminim më të madh të lëngjeve ju dehidratoni, kështu që pini sa më shumë. Disa pacientë që nuk e dinë se janë diabetikë shuajnë etjen e tyre me pije të ëmbla me sheqer ose me lëngje frutash, duke rritur kështu sheqerin në gjak dhe duke përkeqësuar situatën. Pra, fakti që ju ndjeheni veçanërisht të etur pa djersitje për shkak të nxehtësisë së tepruar ose trajnimit intensiv mund të jetë simptomë e diabetit.

ERË E KEQE NGA GOJA. Era e keqe e gojës, ashtu si ajo që është

përdorur për të hequr manikyrin e thonjve nga thonjtë, është një simptomë klasike, veçanërisht e diabetit tip 1, tregon një dekomensim serioz metabolik. Kjo erë është rezultat i të ashtuquajturës ketoacidosis: në thelb organizmi i diabetikëve, i cili nuk ka insulinë, nuk arrin që të përdorë glukozën si një burim energjie, kështu që ajo djeg acidet yndyrore. Në këtë proces janë formuar disa trupa, që shkaktojnë erën e acetonit në frymëmarrje. Kjo simptomë mund të jetë e dobishme për të vlerësuar, kur një pacient vjen në dhomën e urgjencës në koma: koma mund të ketë arsye neurologjike, apo metabolike, por era e keqe e gojës është një tregues i rëndësishëm për mjekun në mënyrë që të adresohet për të zgjidhur problemin lidhur me diabetin e tipit 1.

HUMBJE PESHE E PAPIRUR DHE LODHJE. Humbja e menjëhershme e peshës ndikon kryesisht tek pacientët me diabet të tipit 1, në diabetin e tipit 2 mund të jetë më gradual. Normalisht sheqerna e humbur nga dieta, pasi zhyten transportohen në gjak në të gjitha rrethet e trupit ku qelizat janë në gjendje të përdorin ato për

shkak të insulinës. Nëse kjo substancë mungon ose prodhohet në sasi të vogla, energjia e prodhuar nga sheqernat nuk është më në dispozicion dhe trupi bëhet i lodhur. Trupi përdor depozita yndyrore për nevojat ushqyese të tij dhe, në raste të rënda, indet e muskujve. Kjo rezulton në humbje peshe.

URI E TËPRUAR. Kur jeni të uritur pa arsye, mund të jetë simptomë e diabetit. Sëmundja e pengon trupin që të shndërrojë sheqernat në energji, kështu që ju ndiheni të uritur dhe jeni gjithmonë në kërkim të ushqimit për t'u karikuar. Në diabetin e tipit 1, një simptomë tipike është polyphagia e shoqëruar me humbje peshe: rritja e oreksit dhe marrja e ushqimit është pasuar nga një humbje paradoksale e peshës (në vend të shtimit të peshës që pritet). Ky fenomen ndodh më pak intensivisht në diabetin e tipit 2 ku pacienti është shpesh mbipeshë ose obez dhe mund të vëzhgojë humbjen e peshës duke ruajtur dietën e zakonshme të tepërt. Në raste të tjera të diabetit të tipit 2, humbja e peshës nuk ndodh.

SHËRIMI I NGADALTË I PLAGËVE. Diabeti është një faktor i rëndësishëm kufizues në shërimin e plagëve. Nivelet e larta të sheqerit zvogëlojnë aftësinë për të shëruar plagët dhe një plagë aksidentale që nuk shërohet shpejt mund të jetë spiun i diabetit.


INFEKSIONET GJENITALE OSE URINARE (CYSTITIS, VAGINITIS, BALANITIS). Nivelet e larta të sheqerit në gjak krijojnë një mjedis të favorshëm për rritjen e baktereve. Diabeti dobëson përgjigjet imune dhe aktivitetin e qelizave të bardha të gjakut dhe organizmi bëhet më i ekspozuar ndaj infeksioneve të

llojeve të ndryshme, sidomos nga kërpudhat (candida) ose madje edhe nga bakteret. Kërpudhat dhe bakteret shpërthejnë në mjedis të pasura me sheqer. Nëse ndodhin më shumë infeksione (sidomos nga kërpudhat) në disa muaj dhe trajtimet standarde nuk funksionojnë, është e mundur që shkak është diabeti. Pasi niveli i sheqerit në gjak të mbahet nën kontroll, shpeshësia e infeksioneve duhet të ulet.

SHIKIM I PAQARTË. Kur sheqernat janë shumë të larta në gjak, syri ndikohet gjithashtu. Glikemia shumë e lartë shkakton ndryshime në lentet kristalore dhe në lëngun endokular që zvogëlon aftësinë për të parë, zakonisht duke e bërë vizionin të paqartë. Për të korrigjuar këtë lloj problemi tek sytë është e nevojshme që të ulet niveli i glukozës në gjak. Problemi i vizionit të paqartë mund të jetë vetëm i përkohshëm. Disa pacientë me diabet të padiagnostikuar shkojnë te oftalmologu duke u ankuar që shohin turbull dhe kthehen në shtëpi me syze me recetë. Në fakt, duke korrigjuar nivelet e glukozës, efekti kthehet dhe vizioni i paqartë zhduket. Ky problem vizual nuk është retinopati diabetik, i cili është një ndërlikim i diabetit që zakonisht lind pas viteve të sëmundjes. Ajo mund të jetë e pranishme në fillim vetëm nëse diabeti diagnostikohet me vite vonesë në lidhje me fillimin e tij aktual.

RRITJA E KARIËSIT. Hiperglicemia dëmton dhëmbët dhe mishrat, duke e bërë më të mundshëm kariesin dhe infeksionet. Nëse vëreni një rritje në këto çështje është e mundur që shkak mund të jetë diabeti.

Gripi që mund të vrasë 33 milionë njerëz për 200 ditë!



Njerëzimi nuk do të jetë në gjendje të ndalë një grip vrasës që mund t'u marrë 33 milionë personave vetëm në 200 ditë e para të tij, ka thënë së fundmi një ekspert.

Profesor Robert Dingwall foli për "The Sun", duke thënë se do të jetë shumë e vështirë për të ndaluar

përhapjen e gripit, sepse, sipas tij, njerëzimi mund të infektohet katër ditë para se të shfaqet simptoma e parë e gripit. Parashikimi i zyrtarë dhe i frikshëm vjen vetëm dy ditë pasi Dr. Jonathan Quick, një nga profesionistët më të mirë mjekësor në botë, paralajmëroi se kushtet ishin të duhura për përhapjen e një gri-

pi që mund të "fshinte" miliona njerëz nga planeti.

"Një grip i madh po vjen. Një pandemi virusi global që mund të vrasë 33 milionë njerëz në 200 ditë e para", shkroi ai të martën. "Brenda dy viteve të ardhshme, më shumë se 300 milionë njerëz mund të vdesin në të gjithë globin. Furnizimi i çrregullt me ushqime dhe me ilaçe, ekonomia globale do të shembet". Dr. Quick paralajmëroi se një mutacion i një gripit të shpejtë mund të zhdukë një pjesë të rëndësishme të globit, pasi mund të përzihet me gripin në kafshë të tjera të egra përpara se të arrijë njerëzit, duke e bërë atë më të fuqishëm dhe vdekjeprurës.

"Virusi i gripit po vlon në gjakun e një zogu, majmuni apo një derri, duke u përgatitur për të kaluar te qenia njerëzore. Kur ky kombinim i zogjve dhe kafshëve të gjejë rrugën për të kaluar te njerëzit mund të na vrasë me lehtësi sepse është një lloj i panjohur gripit dhe trupat tanë kanë zero imunitet ndaj tij".

Fruti që do të shpëtojë botën nga uria

Një frut ekzotik që ka shijen e mishit të derrit mund të jetë zgjidhja për të gjithë njerëzit nëpër botë që vuajnë nga uria. Artocarpus heterophyllus rritet vetëm në jug dhe juglindje të Azisë dhe peshon nga 4.5 deri në 45 kg. Përmban qindra fara që janë të pasura me kalcium, proteina, hekur dhe potas. Mjafton një frut i vetëm për të ushqyer në një vakt një familje të tërë. Studiuesit mendojnë se një frut i tillë mund të zëvendësojë grurin dhe misrin, që po kërcënohen nga ndryshimet klimaterike. Fruti është shumë i përdorur në Bangladesh, por në Britani po bëhet përpjekje që të futet nëpër markete në mënyrë që të zëvendësojë mishin e derrit.



NDËRROI JETË STEPHEN HAWKING



Shkencëtari anglez, Stephen Hawking, ka ndërruar jetë të mërkurën në moshën 76 vjeçare.

Ai njihet për punën e tij me vrimat e zeza dhe relativitetin, si dhe ka shkruar disa libra të famshëm shkencorë.

Jeta e tij ka qenë përplot sfida, prej kur u diagnostifikua me sëmundjen që e bëri të palëvizshëm – gjë që nuk e ndali të studioje dhe të nxirrte teoritë për të ua lehtësuar njerëzve të kuptonin kosmologjinë.

Kjo është biografia e tij:

Stephen Hawking ka lindur më 8 janar 1942 në Oksford të Anglisë – në 300 vjetorin e vdekjes së Galileos.

Prindërit e tij po banonin në

veri të Londrës gjatë Luftës së Dytë Botërore, pasi që po llogaritej si vend i sigurt për foshnjat. Kur mbushi tetë vjet, Stephen, familja e tij emigroi në St. Albans, një vend rreth 25 kilometra larg Londrës. Në moshën 11 vjeçare, Stephen nisi shkollën dhe më pas u bë pjesë e University College në Oksford më 1952 – ish kolegjin e babait të tij. Stephen donte që të studioje matematikë, por që babai i tij donte që ai të studioje për medicinë. Të studiohej matematika ishte e pamundur në University College, kështu që në vend të saj ai u drejtua në fizikë. Pas tre vjetësh me pak punë, ai ishte dekoruar me shkalën e parë të nderit në shkencat natyrore.

Në tetor të vitin 1962, Stephen, u bë pjesë e Departamentit të Matematikës së Aplikuar dhe Fizikës Teorike në University of Cambridge, për të bërë hulumtime për kosmologjinë – ku në këtë fushë askush s'po punonte në atë kohë në Cambridge. Mbikëqyrësi i tij ishte Dennis Sciama, edhe pse ai e donte që ta kishte Fred Hoyle që po punonte aty. Pasi mori titullin PhD më 1965 me tezat e tij që i quajti "Vetitë e zgjerimit të Universit", ai u bë i pari, që bëri hulumtim për diçka si kjo, ai vazhdoi me thellimin në shkencë në Gonville dhe Caius College.

Më 1966 Hawking fitoi Adams Prize me esenë "Vecoritë Gjeometrike dhe Hapësira Kohore".

Pas kësaj ai kaloi në Institutin e Astronomisë më 1968, për t'u rikthyer përsëri në Departamentin e Matematikës më 1973 – për t'u punësuar si asistent hulumtues ku dhe publikoi librin e tij të parë akademik me George Ellis "Shkalja e Lartë e Strukturës së Hapësirës-Kohore". Në vitet e mëtejme, Stephen ishte zgjedhur Partner në Shoqërinë Mbretërore më 1974 dhe në Sherman Fairchild Distinguished si shkencëtar i dalluar në Institutin e Teknologjisë në Kaliforni në të njëjtin vit. Ai u bë më pas recensent në Departamentin e Matematikës DAMTP në Fizikën Gravitacionale nga viti 1979 deri më 2009.

Gjatë jetës së tij Hawking punoi në ligjet bazike me të cilat drejtohej universi.

Gjatë jetës ishte dekoruar me shumë tituj, si Urdhri më i Lartë nga Mbretëresha, Shoqërues Nderi, me Medaljen Presidenciale për Liri dhe po ashtu me tituj, medale si dhe çmimin për Fizikë Fundamentale dhe të tjera.

Më 1963 Hawking ishte diagnostifikuar me sëmundjen e ALS, një formë e rregullimit motorik të neuroneve, qysh në moshën 21 vjeçare. I ulur në karrige invalidore dhe me një aparat që i mundëson të fliste ai vazhdoi jetën me familjen e tij – tre fëmijët dhe më pas nipërit e mbesat.

Pavarësisht sëmundjes ai nuk u ndal së studiuar në teoritë fizike.



Komedia "Tartufi" në Festivalin Ballkanik të Teatrit në Bursa

Komedia "Tartufi" vepër e Moliere me regji nga Kushtrim Bekteshi në skenë me aktorët e teatrit "Migjeni" është dhe përfaqësimi i Shqipërisë në Festivalin Ballkanik të Teatrit në Bursa, Turqi. Kjo vepër teatrore që deri tani është vlerësuar me disa çmime dhe erdhi premierë vjeshtë e vitit që kaloi në skenën e teatrit në Shkodër ku nuk mungoi në Tiranë apo dhe në skenën e tjera këtë herë do të jetë në një prej festivaleve të rëndësishme në fushën e teatrit. Drejtoresha e teatrit "Migjeni" Rita Gjeka pohon se shfaqje do të jetë dy net në skenën e festivalit, që ka nisur më datë 8 dhe zhvillohet deri më 25 mars. "Kjo komedi u përzgjodh nga vetë ata që të ishte pjesëmarrëse në festival, ne do të jemi me dy shfaqje në skenë në Bursa në Turqi. Festivali ka nisur dhe do të jemi dhe ne me "Tartufin" me regji nga Kushtrim Bekteshi në datat 22 dhe 23, një shfaqje që ka marrë deri tani pesë çmime", pohon drejtoresha Gjeka, njëkohësisht dhe aktore në këtë komedi. Në komedinë me regji të Kushtrim Bekteshit e kostume nga Samka Ferri janë aktorët Besfort Berberi, Pjerin Vlasi, Rita Gjeka, Krist Lleshi, Jozef Shiroka, Sara Smaja, Simon Shkreli, Merita Smaja, Nikolin Ferketa, Kristina Dodaj dhe Enver Hyseni. Teksti ka pësuar adoptime të lehta, e ndërsa hipokrizia është një dukuri e rëndomtë në shoqërinë njerëzore. Besfort Berberi nga Kosova do luajë rolin e Tartufit, Elmira i është besuar aktore Kristi Lleshi, që janë edhe dy aktorët jashtë trupës permanente të teatrit "Migjeni". Komedia "Tartufi" solli për herë të parë në Shkodër një bashkëpunim të gjerë kombëtar duke bashkuar artistët nga trojet shqiptare, Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Premiera e komedisë ishte më 15 shtator të viti që kaloi në teatrin "Migjeni" të Shkodër.

Teatri me 6 kulla, fasadë e një maskarallëku financiar

Teatri është mënyra për të fshehur një krim urban, që do të shtojë çmendurinë e betonit, në një qytet të bastardizuar me ndërtime marramendëse.

Nga Ergys Mërtiri

Pra nuk do të kemi teatër me kullë, por teatër me 6 kulla me rreth 96 kate gjithsej! Bukur. Ua qepën gojën artistëve, me marifet dhe tani po i përdorin për dekor në takime ku flet vetëm Rama dhe ata dëgjojnë. I trajtuan si dele, duke iu thënë si studentëve njëherë vakti: Shikoni se nuk i dini mirë ca gjëra ju!

Qeveria po përpiqet ta spostojë debatin në një diskutim estetik mbi godinën e teatrit. Kjo është një farsë. Zërat që duan të na mbushin mendjen mbi vlerat arkitekturore të projektit, në fakt kërkojnë vetëm të spostojnë vëmendjen nga krimi i vërtetë: Kullat.

Reagimet kundër projektit nuk kanë qenë për cilësinë e tij, pasi në fakt, deri tani nuk ka pasur fare



projekt. Reagimet kanë qenë kundër kullave që do të ngrihen pranë tij, të cilat, fillimisht qeveria i mohoi. Pasi e shfrytëzoi situatën, sot ajo pohon me gojën e saj se këto kulla janë të domosdoshme, pasi askush nuk ta ndërton godinën qyl. Në fakt, ndërtimi i këtyre kullave që, edhe sikur të mos kishte fare teatër aty, do të ishte një maskarallëku urban, nuk mund të shpjegohet në asnjë mënyrë tjetër përveç se nëpërmjet interesave

financiare që lidhen me afera korruptive prapa shkëlqimit të vizatimeve në 3D që u ofrohen artistëve. Kur janë në lojë rreth 300 milion euro, natyrisht që askush nuk e çan kokën për teatër.

E kuptueshme është që, nuk po ndërtohen 6 kulla për të krijuar mundësinë të ndërtojmë një teatër, por po ndërtohet një teatër, për të gjetur një mënyrë sesi të justifikohet ndërtimi i 6 kullave, në zemër të Tiranës. Teatri është

mënyra për të fshehur një krim urban, që do të shtojë çmendurinë e betonit, në një qytet të bastardizuar me ndërtime marramendëse.

Teatri është vetëm fasada e një maskarallëku financiar që do të shkatërrojë pejzazhin e të vetmit oaz kulturor të mbetur në këtë qytet, të dënuar tashmë të vegjetojë nën hijen e grataciellave monstruoze që gërrvishtin qiellin e korrupsionit?

Me këtë rezultat ku Shkëndija kushtimisht ishte nikoqir, më të kënaqur mbetën futbollistët e Renovës, të cilët më 11 prill do të hynë me një epërsi minimale, pasi me 0-0 do të jenë pikërisht ata që do të plasohen në finale

KUPA E MAQEDONISË, GJYSMËFINALE

SHKËNDIJA - RENOVA, FINALISTI PËRCAKTOHET NË PRILL

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 14 mars - Shkëndija dhe Renova kanë luajtur baras 1-1 në ndeshjen e parë gjysmëfinale të Kupës së Maqedonisë në futboll. Edhe pse krijoi më shumë raste për gol, lideri aktual në Ligën e parë futbollistike të Maqedonisë në fund u desh të pajtohet me rezultatin e barabartë, ndërsa të përgjedhurit e trajnerit të Renovës, Vllatko Kostov, u treguan të shkathhtë, shënuan një gol, dhe më pas u përqendruan në mbrojtje, duke e rruajtur me sukses deri në fund.

Pjesa e parë është mbyllur me barazim 1-1. Dominuan kuqezinjtë, krijuan më shumë raste prej fillimit të ndeshjes, por ishin bardhekaltërit ata të cilët kaluan të parët në epërsi me 0-1 në minutën e 12-të. Autor i golit ishte Stojanovski, i cili shfrytëzoi gabimin e mbrojtësit Musliu, dhe mposhti portierin Zahov. Pas kësaj, rastet e kuqezinjve radhiteshin si në shiritin filmik. Në dy herë u kërcënua Izair Emini dhe njëherë Besart Ibraimi. Derisa, kjo iniciativë e futbollistëve të Shkëndijës rezultoi me gol në mi-



nutën e 26-të kur në tentimin e tij të tretë, Emini më në fund mposht portierin Kobetiç. Në pjesën e dytë, të kënaqur nga rezultati i pjesës së parë, futbollistët e Renovës u përqendruan në mbrojtje, duke mos u lejuar futbollistëve të Shkëndijës të rrezikojnë portën e tyre. Në anën tjetër, referi kryesor Josip Barton ishte në qendër të vëmendjes pasi ai

në momentet kur futbollistët e Renovës shtriheshin për toke, kërkonte të ndërtonjë stafi mjekësor i Renovës, ndërsa kjo shkaktonte nervozizëm tek futbollistët e Shkëndijës. Kjo ndodhi disa herë, ndërkohë që pas përfundimit të ndeshjes ku rezultati mbeti i pandryshuar 1-1, futbollistët dhe nga banka rezerve e kuqezinjve prote-

stuan kundrejt referit Barton, por në fund gjithçka përfundoi pa ndonjë incident. Me këtë rezultat ku Shkëndija kushtimisht ishte nikoqir, më të kënaqur mbetën futbollistët e Renovës, të cilët më 11 prill do të hynë me një epërsi minimale, pasi me 0-0 do të jenë pikërisht ata që do të plasohen në finale. Në përballjen tjetër, Pelisteri me

përmbysje ka mundur skuadrën e Akademia Pandevit dhe në Strumicë do të udhëtohet me epërsi prej 2-1. Të parët në epërsi kaluan mysafirët me golin e Atanasov në minutën e 31, ndërsa në minutën e 61 të pjesës së dytë fillimisht Mançevski barazon rezultatin në 1-1, kurse në minutën e 90-të Ilijovski përmbys rezultatin në 2-1.

Abrashi nuk luan ndaj Norvegjisë

Amir Abrashi siç duket nuk do të jetë i gatshëm për Kombëtaren Shqiptare për ndeshjen me Norvegjinë. Ai ka lënë fushën e lojës në minutën e 29-të të ndeshjes në përballjen që skuadra e tij Freiburg e zhvilloi ndaj Herta Berlin. Të shtunën edhe pse e nisi nga minuta e parë ai u desh të largohet, pasi dëmtimi ishte i madh. Mesfushori i Kombëtares Shqiptare iu nënshtrua analizave të detajuara, që për fat të keq u konfirmua një këputje e ligamentit të gjurit. Kjo do të thotë se Amir Abrashi do të duhet t'i nënshtrohet një operacioni, që do ta mbajë larg për disa muaj. Ende nuk mund të thuhet me siguri nëse do të rikthehet për këtë sezon apo jo, por ajo që dihet është se Abrashi nuk do të jetë në dispozicion të Panuçit, në sfidën miqësore me Norvegjinë, më 26 mars.



SKUADRAMË E MIRË, KAMPI MË I MIRË

Fondacioni Real Madrid organizon kamp në Shkup

Shkup, 14 mars - Maqedonia nga muaji qershor do të inkuadrohet në familjen e fondacionit të Real Madridit si organizator i kampit „Campus Experience“. Kompania "Sport Arena" fitoi mundësinë të bëhet partner i licencuar i "Real Madrid Foundation Campus Experience" dhe dje e prezantoi projektin në konferencën për shtyp. Ndryshe, kampi do të mbahet në fushat e FFM-së nga 11 e deri më 15 qershor. Nga kompania "Sport Arena" shprehen të kënaqur që kanë fituar mundësinë të bëhen partner të licencuar të "Real Madrid Foundation Campus Experience" dhe të organizojnë kampion e parë internacional në Maqedoni. Ky kamp do të rruajë të gjitha standardet në të cilën fëmijët dhe pjesëmarrësit do të jenë në fokus të projektit, respektivisht nga ai do të duhen të dalin si njerëz të mirë dhe shumë më të mirë si futbollist. Derisa, në këtë kamp do të punojnë trajner të licencuar nga Fondacioni i Real Madridit, të cilët do ti zbatojnë metodat origjinale në stërvitje dhe gara, ndërsa në fund pjesëmarrësit do të marrin edhe certifikata zyrtare për pjesëmarrjes. Mu për këtë arsye ky kamp është si kampi me reputacion më



të madh në botë. Sipas standardeve të këtij fondacioni, në çdo 20 pjesëmarrës do të ketë nga një trajner, ndërsa në mënyrë plotësuese dhe në kuadër të edukimit do të marrin pjesë edhe përkthyes, si nga Spanja poashtu edhe nga Maqedonia.

Kampi do të jetë në dispozicion për meshkuj dhe vajza në moshë prej 7 e deri 17 vjeç, kurse pagesa do të jetë në përdorim në shumë këste nëpërmjet institucioneve bankare, kurse në mënyrë plotë-

suese, partnerët e këtij kampi për secilin pjesëmarrës do të sigurojnë benefite të mëdha duke filluar nga pajisjeve origjinale sportive si dhe numër të madh të vauçerëve. Çmimi për pjesëmarrje në këtë kamp, është 18.999 denarë për akreditim, i cili mundëson 8-10 orë (varësisht nga kushtet klimatike) pjesëmarrje në kam gjatë ditës ose akreditim për 24 orë (këtu përfshihen edhe shfrytëzimi për vendosje, ushqim dhe transfer) për çmim prej 26.999 denarë.

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1, nenit 15 dhe nenit 18 të Ligjit për tekstet shkollorë për arsim fillor dhe të mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 98/2008, 99/2009, 83/2010, 36/2011, 135/2011, 46/2012, 24/2013, 120/2013, 29/2014, 146/2015, 217/2015, 30/2016 dhe 21/2018) dhe në pajtim me Rregulloren për kriteret për përcaktim të shumës së kompensimit për transferim të së drejtës materiale autoriale për tekstet shkollorë në arsim fillor dhe të mesëm nr. 22-10483/1 të datës 18.07.2013, nr. 22-10483/2 të datës 16.09.2013 dhe nr. 03-6645/1 të datës 18.03.2015, Ministria e Arsimit dhe Shkencës – Shërbimi pedagogjik, publikon

KONKURS

për botim të një teksti shkollor për lëndët mësimore

Shoqëria për klasën e IV të arsimit fillor nëntëvjeçar, Informatika për klasën e VI të arsimit fillor nëntëvjeçar, Gjeografia për klasën e VII të arsimit fillor nëntëvjeçar, Gjeografia për klasën e VIII të arsimit fillor nëntëvjeçar dhe Gjeografia për klasën e IX të arsimit fillor nëntëvjeçar,

1. KUSHTET E PËRGRJITHSHME

- **Porositës:** Ministria e Arsimit dhe Shkencës – Shërbimi pedagogjik, bul. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54, Shkup.

Lënda e konkursit: Ofertat për botim të një teksti shkollor për lëndët mësimore:

- **Shoqëria për klasën e IV të arsimit fillor nëntëvjeçar**, kompensim për transferim të së drejtës materiale autoriale në shumë neto prej 202.725,00 (dyqind e dymijeshatëqindnjzetepesë) denarë.
- **Informatika për klasën e VI të arsimit fillor nëntëvjeçar**, kompensim për transferim të së drejtës materiale autoriale në shumë neto prej 202.725,00 (dyqind e dymijeshatëqindnjzetepesë) denarë.
- **Gjeografia për klasën e VII të arsimit fillor nëntëvjeçar**, kompensim për transferim të së drejtës materiale autoriale në shumë neto prej 202.725,00 (dyqind e dymijeshatëqindnjzetepesë) denarë.
- **Gjeografia për klasën e VIII të arsimit fillor nëntëvjeçar**, kompensim për transferim të së drejtës materiale autoriale në shumë neto prej 202.725,00 (dyqind e dymijeshatëqindnjzetepesë) denarë.
- **Gjeografia për klasën e IX të arsimit fillor nëntëvjeçar**, kompensim për transferim të së drejtës materiale autoriale në shumë neto prej 202.725,00 (dyqind e dymijeshatëqindnjzetepesë) denarë.

1.1. Të drejtë për pjesëmarrje në Konkurs kanë autorët të cilët përbushin kushtet e caktuara me nenin 10 të Ligjit për tekstet shkollorë për arsim fillor dhe të mesëm.

1.2. Konkursi është publik, i hapur dhe anonim. Autorësia dhe pronësia e tekstit të miratuar shkollor dëshmohet me botimin e gjashtë të tekstit shkollor.

1.3. Në konkurs mund të merr pjesë autori i tekstit shkollor vetëm me një dorëshkrim për tekst shkollor për një lëndë mësimore.

1.4. Autor i tekstit shkollor nuk mund të jetë personi i punësuar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në organet në përbërje të Ministrisë, në Qendrën për arsim profesional dhe trajnim, në Qendrën për arsim të të rriturve, kryetarin dhe anëtarin e Komisionit nacional dhe anëtarit të komisionit recensues.

1.5. Dorëshkrimi i tekstit shkollor përpilohet sipas planit dhe programeve mësimore për klasën përkatëse, lëndën dhe Konceptin për tekstin shkollor për arsim fillor dhe të mesëm.

1.6. Dorëshkrimi i tekstit shkollor duhet të përbushë kushtet dhe standardet në pajtim me Konceptin për tekst shkollor për arsim fillor dhe të mesëm.

1.7. Dorëshkrimi për tekst shkollor parashtrohet në formë të shtypur në 5 (pesë) kopje të rregulluara figurative, grafike dhe gjuhësore (3 kopje me ngjyra dhe 2 kopje bardh e zi), të përpiluara sipas planit dhe programeve mësimore për klasën përkatëse, lëndë dhe Konceptin për tekst shkollor për arsim fillor dhe të mesëm.

1.7.1. Dorëshkrimi për tekstin shkollor nuk duhet të përmbajë fotografi, ilustrime dhe përmbajtje të marra nga persona të tretë për të cilat autorët nuk kanë leje që t'i përdorin.

1.8. Dorëshkrimi i tekstit shkollor parashtrohet edhe në formë elektronike.

1.9. Autorët dorëshkrimin e tekstit shkollor e parashtrorin në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik.

Për nxënësit e përkatësive të bashkësive etnike që mësimin e përcjellin në gjuhën dhe alfabetin ndryshe nga gjuha maqedonase dhe alfabeti cirilik, dorëshkrimet e teksteve shkollorë parashtrorin në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik.

1.10. Ministri dhe autori i tekstit shkollor lidhin marrëveshje për transferim të së drejtës materiale dhe autoriale ku përcaktohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella.

1.11. Nëse autori i tekstit shkollor ka ofruar literaturë shtesë në pajtim me nenin 15 paragrafi 2 të Ligjit për tekstet shkollorë për arsim fillor dhe të mesëm, të njëjtën është i obliguar që ta heqë pa transferim të së drejtës materiale autoriale në pajtim me nenin 18 paragrafi 2 të Ligjit.

2. AFATET

2.1 Afati për parashtrimin e dorëshkrimeve për tekstet shkollorë është deri më **14.05.2018**.

3. DOKUMENTACIONI KONKURRUES

3.1. Dokumentacioni konkurrues përmban: Planin dhe programin mësimor për klasën përkatëse, lëndën, Konceptin për tekstin shkollor për arsim fillor dhe të mesëm dhe Ligjin për tekstet shkollorë për arsim fillor dhe të mesëm.

3.2. Dokumentacioni konkurrues mund të merret në lokalet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës – Shërbimi pedagogjik bul. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54, Shkup ose në www.bro.gov.mk, www.mon.gov.mk

4. PARASHTRIMI I TEKSTEVE SHKOLLORE

4.1. Ofertat për tekstet shkollorë parashtrorin me rekomandim përmes postës ose parashtrorin në Arkivin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës – Shërbimi pedagogjik – ndërtesa e Nova Makedonisë – bul. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54, Shkup.

4.2. Në pjesën e përparme të dërgesës, në këndin e epërm të majtë, duhet të shënojë "**MOS HAP**" dhe "**KONKURS PËR BOTIM TË TEKSTEVE SHKOLLORE**", titulli i tekstit shkollor, klasa, ndërsa në mes adresa: **MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS – SHËRBIMI PEDAGOGJIK, bul. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54 Shkup.**

4.3. Autorët e dorëshkrimeve në pakon e parashtruar në të cilin shënon "**MOS HAP**" duhet të parashtrorin edhe zarf të mbyllur në të cilin gjithashtu duhet të shënojë "**MOS HAP**" me të dhënat dhe dokumentet në vijim: emri dhe mbiemri i saktë i autorit/ëve, adresa e banimit, numri i telefonit, institucioni ku janë të punësuar, certifikata ose diploma për arsimin e mbaruar përkatës, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter (autorët të cilët kanë mbaruar arsimin jashtë vendit obligohen që të parashtrorin diplomë të nostrifikuar nga Republika e Maqedonisë), pasqyrë të të dhënave të regjistruara në evidencën amë nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidit të Maqedonisë, deklaratë se përbushë kushtet e dhëna në pajtim me nenin 11 të Ligjit për tekstet shkollorë për arsim fillor dhe të mesëm, deklaratë nga lektori për rregullim gjuhësor të tekstit dhe vërtetim për provim të dhënë për lektor (origjinal ose kopje të vërtetuara në noter), deklaratë se dorëshkrimi nuk përmban fotografi, ilustrime dhe përmbajtje të marra nga persona të tretë për çka autorët nuk kanë të drejtë përdorimi.

4.4. Nëse emri dhe mbiemri i autorit në fletëparaqitje dallon me emrin dhe mbiemrin e dhënë në certifikatë ose diplomë për arsim të mbaruar përkatës, parashtrorin dëshmi përkatës për njëjtshmërinë e të dhënave.

4.5. Zarfi "**MOS HAP**", hapet me miratimin e shifrave të teksteve shkollorë.

4.6. Materialet nën pikën 4.1., 4.2., 4.3. dhe 4.4. parashtrorin në pako të mbyllur në të cilin është shënuar vetëm "**KONKURS PËR BOTIM TË TEKSTIT SHKOLLOR**" dhe emri i tekstit shkollor, adresa – Ministria e Arsimit dhe Shkencës – Shërbimi pedagogjik, bul. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54, Shkup.

5. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

5.1. Ofertat për tekstet shkollorë të cilat nuk do të parashtrorin brenda afatit të caktuar dhe ato të cilat nuk janë përpiluar në pajtim me kushtet e këtij Konkursi, do të diskualifikohen.

Në bazë të nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/41, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 14 paragrafi 1, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), nenit 110-g dhe 110-e të Ligjit për mbrojtje sociale ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 72/15, 104/15, 105/15, 173/15, 192/15 dhe 30/16), pas Pëlqimit të marrë nga Ministria e punë dhe politikës sociale nr. 04-174/4 të datës 22.02.2018, dhe Vendimit të UD Drejtorit të IP Enti special Demir Kapia, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të:

- 4 (katër) realizues/ve për kohë të pacaktuar për vendin e punës – përkëdhelës
- 3 (tre) realizues/ve për kohë të pacaktuar për vendin e punës – motër medicinale

Kandidatët të cilët do të konkurrojnë për secilin prej vendeve të theksuara të punës, është e nevojshme të përbushin kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligj:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe

Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë dhe detyrës.

Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

Për vendet e lartpërmendura të punës:

- Fillimi dhe mbarimi i orarit ditor dhe javor të punës të përkëdhelësit është puna me tre ndërrime ose 40 orë në javë
- Ndërrimi i parë prej ora 6,30 deri në ora 14,30
- Ndërrimi i dytë prej ora 12,20 deri në ora 19,20
- Ndërrimi i tretë prej ora 18,30 deri në ora 6,30
- Fillimi dhe mbarimi i orarit ditor dhe javor të punës të motër medicinale është puna me tre ndërrime ose 40 orë në javë
- Ndërrimi i parë prej ora 6,30 deri në ora 14,30
- Ndërrimi i dytë prej ora 12,20 deri në ora 19,20
- Ndërrimi i tretë prej ora 18,30 deri në ora 6,30

-shuma në të holla e neto pagesës fillestare për përkëdhelës është: 12.379,00 denarë.

- shuma në të holla e neto pagesës fillestare për motër medicinale është: 14.644,00 denarë.

2. Kandidatët obligohen të parashtrorin dëshmi përkatës në formë origjinale ose kopje të vërtetuara në noter, si për përbushjen e kushteve të përgjithshme, ashtu edhe të parashtrorin dëshmi për përbushjen e kushteve të posaçme, edhe atë:

-Për përkëdhelës për nivelin B3 së paku niveli i kualifikimeve III, 180 kredi sipas ECVET ose arsim të mesëm trevjeçar. Pa përvojë pune

-Për motër medicinale për nivelin B2 së paku niveli i kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose arsim të mesëm katërveçar (arsim i mesëm i medicinës)

- Pa përvojë pune
- Diplomë/Certifikatë/Dëftesa për shkallën e mbaruar të arsimit përkatës që kërkohet për vendin e punës;
- Shtetësi dhe
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë gjyqësore për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës – jo më të jetra se 6 (gjashtë) muaj.

Dokumentet e kërkuara parashtrorin me zarf të mbyllur me shënim "Të mos hapet" në adresën në vijim:

IP Enti special Demir Kapia
rr. Naum Naumovski nr. 4
Demir Kapia
Arkivi i Institucionit
(me shenjë "për shpallje")
Fletëparaqitja dhe dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.
IP Enti special Demir Kapia
UD Drejtor
Aleksandra Vellkovska

Në bazë të nenit 89-a dhe nenit 91 të Ligjit për arsim të mesëm (Gazeta Zyrtare e RM nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13,41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17), nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15), nenit 92, nenit 97 dhe nenit 98 të Statutit të SHMTK "Nace Bugjoni" Kumanovë, pas marrjes së vendimit për publikim të shpalljes publike nr. UP1 08-4536 të datës 07.03.2018 të Kryetarit të Komunitetit të Kumanovës dhe Vendimit të Këshillit të shkollës nr. 02-211/2 të datës 12.03.2018, Këshilli i shkollës pranë SHMTK "Nace Bugjoni" Kumanovë, publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të drejtorit të SHMTK "Nace Bugjoni" Kumanovë

Zgjedhja do të realizohet për periudhë prej 4 (katër) vjet.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP, kandidatët duhet të përbushin edhe kushtet e posaçme të përcaktuara me Ligjin për arsim të mesëm dhe Statutin e shkollës:

- të përbushë kushtet për mësimdhënës, pedagog ose psikolog në arsim të mesëm
- të ketë arsim sipëror të mbaruar
- të ketë 5 (pesë) vjet përvojë pune në institucion për punë edukativo-arsimore të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- të ketë të dhënë provimin për drejtor në shkollë të mesme

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen obligohen të parashtrorin dokumentet në vijim:

- Biografi të shkurtë
- Diplomë për arsim të mbaruar (kopje të vërtetuara në noter)
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë – origjinal/kopje të vërtetuara në noter
- Certifikatë për provim të dhënë për drejtor në arsim të mesëm – origjinal/kopje të vërtetuara në noter
- Vërtetim për përvojë pune në punë edukativo-arsimore – origjinal
- Dëshmi se nuk është shqiptuar sanksion për kundërvajtje – ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- Të ketë certifikatë përkatëse, jo më të vjetër se pesë vjet, për njohje të gjuhës angleze TOEFL IBT – së paku 30 pikë, IELTS – së paku 3 pikë, BULATS – së paku 20 pikë ose KET (Cambridge English) – të dhënë
- Të ketë të dhënë test psikologjik ose test për integritet.

Orari i punës është me autorizime të posaçme.

Orari ditor i punës është prej ora 7-15, ndërsa orari javor i punës është 40 (dyzet) orë pune prej ditës së hënë deri ditën e premte.

Neto pagesa fillestare është 31.600,00

Shpallja është e hapur 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit dhe fillon të rrjedhë ditën tjetër nga dita e publikimit, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve.

Fletëparaqitja me biografi të shkurtë dhe me dokumentet e posaçme parashtrorin deri te Këshilli drejtues i SHMTK "Nace Bugjoni" Kumanovë në adresën rr. "Bajram Shabani" pn, 1300 Kumanovë, me shenjë "PËR SHPALLJE PUBLIKE PËR DREJTOR".

Kontakt telefoni 031/432-180, personi për kontakt Voislav Veličkovski.
Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruar pas afatit nuk do të merren parasysh.

nga

Këshilli drejtues

SHMTK "Nace Bugjoni"

Kumanovë

Në bazë të nenit 17 të Rregullores për mënyrën dhe realizimin e ekskursioneve për nxënësit dhe aktivisteve tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore nr. 07-9992/2 të datës 05.06.2014, Drejtori i SHFK "Sando Masev" Strumicë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për organizim të ekskursionit njëditor me nxënësit e klasës së tretë dhe Mësim në natyrë me nxënësit e klasës së pestë

Përmbajtjet dhe kushtet janë dhënë në dokumentacionet tenderues që mund merren nga lokalet e shkollës. Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave është 20.03.2018 deri në ora 12:00.

Adresa: rr. "Moshë Pijade" nr. 6, Strumicë,
Kontakt tel. 034 325 532.

SHFK "Sando Masev" Strumicë

Në bazë të nenit 14, paragrafi 1 dhe 3, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – teksti i pastruar (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 167/2015),nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 27/14 dhe 199/14), dhe në lidhje me Mendimin e pranuar pozitiv për Planin vjetor për punësim gjatë vitit 2018 me nr. 12/6-2060/11 të datës 18.12.2017, NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup shpall:

KONKURS PUBLIK nr. 02/2018
për plotësimin e vendeve të lira të punës në kohë të pacaktuar të angazhimit punes

1. NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, ka nevojë për punësimin e:

Nr. rend.	Shifra	Emri i vendit të punës	Nr. i realizuesve
1	KDR.04.02.A02.006	Roje të sigurisë – patrulla	2

2. Marrëdhënia e punës për të gjitha vendet e punës themelohet në kohë të pacaktuar të angazhimit punes.

3. Marrëdhënia e punës themelohet në orar të plotë të angazhimit punes.

4. Çdo kandidat duhet ti përmbush kushtet e përgjithshme:

- Të jetë nënshtrës i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të shfrytëzoi gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të jetë i moshës së pjekur;
- Të posedoj aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësorë të mos i jetë shqiptuar dënimi me ndalesë të ushtrimit të profesionit.

5. Kandidatët që do të paraqiten duhet ti përmbushin kushtet e veçanta të parapara me LMP ose të Marrëveshjes kolektive për veprimtaritë komunale si dhe kushtet e përcaktuara në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, përkatësisht:

Kushtet e posaçme të përcaktuara me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe LMP ose me Marrëveshjen kolektive për veprimtaritë komunale për të gjithë personat ndihmës – teknik, përfshijnë: Kualifikimet profesionale:

- Persona ndihmës – teknik të nivelit të dytë (A2), me nivelin më të ulët të kualifikimit III, 180kredi sipas ECVET ose arsim të mesëm trevjeçar, dhe Përvoja e punës, me sa vijon:

Për nivelin A2së paku një vit të përvojës punuese në profesionin përkatës.

6. Orari i angazhimit punes është 40 orë gjatë javës (dhe angazhimi punes në ndërrime).

7. Neto paga themelore për vendin e punës Roje të sigurisë – patrulla është 18.375,00 denarë për orar të plotë pune,

8. Kandidatët për punësim, paraqiten në konkursin publik përmes fletëparaqitjes së plotësuar.

Fletëparaqitjen për punësimin e kandidatëve, mund ta marrin në zyrat e ndërmarrjes publike ose në ueb faqen www.parkovi.com.mk

9. Së bashku me fletëparaqitjen, kandidatët për të gjitha vendet e punës duhet të dorëzojnë edhe:

- Biografi të shkurtër;
- Dëshmi për nivelin e përfunduar të arsimimit (origjinali i diplomës ose kopje e verifikuar te noteri);
- Vërtetim për posedimin e nënshtrës së Republikës së Maqedonisë (origjinali ose kopja e verifikuar te noteri);
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënimi me ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (origjinali ose kopja e verifikuar te noteri).

10. Fletëparaqitjet së bashku me shtojcat dorëzohen personalisht në ndërmarrjen publike ose përmes postës në adresën NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, rr. “Ilinden” nr. 104, 1000 Shkup. Kontakt telefoni: 02/3070 112 e-mail: rovecki.resursi@parkovi.mk.com

Konkursi zgjat 5 ditë, duke llogaritur nga dita e shpalljes së fundit në shtypin ditorë.

Fletëparaqitjet e dorëzuara me vonesë, fletëparaqitjet e plotësuara në mënyrë të parregullt, nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit.

NP “Parqe dhe gjelbërime” U.D. Drejtor Ardijan Muça

Në bazë të nenit 14, paragrafi 1 dhe 3, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – teksti i pastruar (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 167/2015),nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 27/14 dhe 199/14), dhe në lidhje me Mendimin e pranuar pozitiv për Planin vjetor për punësim gjatë vitit 2018 me nr. 12/6-2060/12 të datës 18.12.2017, NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup shpall:

KONKURS PUBLIK nr. 01/2018
për plotësimin e vendeve të lira të punës në kohë të pacaktuar të angazhimit punes

1. NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup ka nevojë për punësimin e:

Nr. rend.	Shifra	Emri i vendit të punës	Sektori	Nr. i realizuesve
1	KDR.04.03.C01.014	Punëtorë me makina ndihmëse	Gjelbërimi urban	8
2	KDR.03.05.C02.031	Punëtorë i përgjithshëm	Gjelbërimi urban	8
3	KDR.03.05.C02.031	Punëtorë i përgjithshëm, Seksioni Parku 2	Gjelbërimi urban	4
4	KDR.03.05.B04.048	Roje pylli në objektin pylli Vodno dhe Gazi Babë	Gjelbërimi jashtë urban	2
5	KDR.03.05.C01.014	Punëtorë me makina ndihmëse	Gjelbërimi jashtë urban	2
6	KDR.03.05.C02.031	Punëtorë i përgjithshëm	Gjelbërimi jashtë urban	2
7	KDR.03.05.C02.031	Punëtorë i përgjithshëm	Ngjitja e gjelbërimit	8
8	KDR.03.05.C01.014	Punëtorë me makina ndihmëse	Aletë e drunjve	4
9	KDR.03.05.C02.031	Punëtorë i përgjithshëm	Aletë e drunjve	2

2. Marrëdhënia e punës për të gjitha vendet e punës themelohet në kohë të pacaktuar të angazhimit punes.

3. Marrëdhënia e punës themelohet në orar të plotë të angazhimit punes.

4. Çdo kandidat duhet ti përmbush kushtet e përgjithshme:

- Të jetë nënshtrës i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të shfrytëzoi gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të jetë i moshës së pjekur;
- Të posedoj aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësorë të mos i jetë shqiptuar dënimi me ndalesë të ushtrimit të profesionit.

5. Kandidatët që do të paraqiten për vendet e punës nga nr. 1 deri në nr. 9 duhet ti përmbushin kushtet e veçanta të parapara me LMP ose të Marrëveshjes kolektive për veprimtaritë komunale si dhe kushtet e përcaktuara në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, përkatësisht:

Kushtet e posaçme të përcaktuara me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe LMP ose me Marrëveshjen kolektive për të gjithë ofruesit e shërbimeve për të gjitha kategoritë, janë:

Kualifikimet profesionale:
- Ofrues të shërbimit Kategoria C për të gjitha nivelet, me nivelin më të ulët të kualifikimit I, ose arsimi fillor.
- Ofrues të shërbimit, persona të nivelit të katër (B4), së paku niveli i kualifikimit IV, 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose arsimi i mesëm katër vjeçar, dhe

Përvoja e punës, me sa vijon:

Për nivelin C1 me së paku një vit përvojë pune në profesionin përkatës,

Për nivelin C2me ose pa përvojë pune,

Për nivelin B4me ose pa përvojë pune,

6. Orari i angazhimit punes është pesë ditë pune gjatë javës (nga e hëna deri të premtën) dhe do të jetë nga ora 7 deri në ora 15.

7. Neto paga themelore për vendin e punës nr. 1 është 18.252,00 denarë për orar të plotë pune.

Neto paga themelore për vendin e punës nr. 2 është 16.660,00 denarë për orar të plotë pune.

Neto paga themelore për vendin e punës nr. 3 është 17.885,00 denarë për orar të plotë pune.

Neto paga themelore për vendin e punës nr. 4 është 18.865,00 denarë për orar të plotë pune.

Neto paga themelore për vendin e punës nr. 5 është 18.742,00 denarë për orar të plotë pune.

Neto paga themelore për vendin e punës nr. 6 është 17.150,00 denarë për orar të plotë pune.

Neto paga themelore për vendin e punës nr. 7 është 17.640,00 denarë për orar të plotë pune.

Neto paga themelore për vendin e punës nr. 8 është 19.110,00 denarë për orar të plotë pune.

Neto paga themelore për vendin e punës nr. 9 është 17.640,00 denarë për orar të plotë pune.

8. Kandidatët për punësim, paraqiten në konkursin publik përmes fletëparaqitjes së plotësuar. Fletëparaqitjen për punësimin e kandidatëve, mund ta marrin në zyrat e ndërmarrjes publike ose në ueb faqen www.parkovi.com.mk

9. Së bashku me fletëparaqitjen, kandidatët për të gjitha vendet e punës duhet të dorëzojnë edhe:

- Biografi të shkurtër;
- Dëshmi për nivelin e përfunduar të arsimimit (origjinali i diplomës ose kopje e verifikuar te noteri);
- Vërtetimi për posedimin e nënshtrës së Republikës së Maqedonisë (origjinali ose kopja e verifikuar te noteri);
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënimi me ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (origjinali ose kopja e verifikuar te noteri).

10. Fletëparaqitjet së bashku me shtojcat dorëzohen personalisht në ndërmarrjen publike ose përmes postës në adresën NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, rr. “Ilinden” nr. 104, 1000 Shkup.

Kontakt telefoni: 02/3070 112 e-mail: rovecki.resursi@parkovi.mk.com

Konkursi zgjat 5 ditë, duke llogaritur nga dita e shpalljes së fundit në shtypin ditorë.

Fletëparaqitjet e dorëzuara me vonesë, fletëparaqitjet e plotësuara në mënyrë të parregullt, nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit.

NP “Parqe dhe gjelbërime” U.D. Drejtor Ardijan Muça

SHPALLE

Shitet tokë në Shkup,e cila gjendet në PK 3407/1, Vendi i quajtur GLAVIČICA, me sipërfaqe prej 48 m2, e regjistruar në Fletë Pronësi nr. 2830 për KK GLUVO BRAZDA, në pronësi të Sabit Kovaçi.

Të interesuarit dhe të gjithë ata që kufizohen me parcelën në fjalë, ofertat mund ti paraqesin në zyrën e Noterit Naser Zyberit, rr. Xhon Kenedi nr. 9A, Shkup.

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar Po+Pr+2 menjëherë në fillim të Industrisë së lehtë “Momin Potok” – Shkup, me sipërfaqe të përgjithshme prej 890 m2 së bashku me objektet ekzistuese prej 180 m2. Çmimi 178.000 euro. Numri i telefonit: 078 – 201 – 960

Shitet lokal afarist në Q.T. Mavrovka me 326 m2. Çmimi sipas marrëveshjes. Kontakt telefoni 078/386 386



Државен Музичко Балетски Училишен Центар “Илија Николовски-Луј” - Скопје
Црвена Скопска Општина бр.4, Скопје, Македонија
тел.: 02 3115 527, факс: 02 3119 004
e-mail: dmbuc.mk@gmail.com web: www.dmbuc.edu.mk

State Music and Ballet Education Centre
“Ilja Nikolovski - Luj” - Skopje
Crvena Skopska Opština no.4, Skopje, Macedonia
tel.: +389 2 3115 527, fax: +389 2 3119 004
e-mail: dmbuc.mk@gmail.com web: www.dmbuc.edu.mk

Nr. 03-229/2
14.03.2018

Qendra shkollore shtetërore për muzikë dhe balet “Ilja Nikolovski – Luj” – Shkup, në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1, paragrafi 3 dhe neni 23 paragrafi 1 e LMP, nenit 59-a të Ligjit për arsim të mesëm, ndërsa në lidhje me pëlqimet e miratuara për punësim për kohë të pacaktuar të punës për vitin shkollor 2017/2018 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nr. 12-610/8 të datës 07.02.2018, publikon:

SHPALLE PUBLIKE

QSHSHMB “Ilja Nikolovski – Luj” – Shkup ka nevojë për themelim të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar për vendet e punës në vijim:

1. Nëngrupi 1 kategoria A niveli A1 **Mirëmbajtës të higjienës – katër (4) realizues**

Kushtet e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Të jetë i moshës së rritur
- Të ketë të mbaruar arsimin fillor

Orari i kohës së punës

Orari i punës është 40 orë në javë prej ditës së hënë deri ditën e premte, me dy ndërrime, ndërrimi i parë prej ora 6,00 deri në ora 13,00, ndërsa ndërrimi i dytë prej ora 13,00 deri në ora 20,00. Secila e shtunë e dytë është ditë pune, gjithashtu me ndërrime.

Neto pagesa fillestare për vendin e punës **mirëmbajtës të higjienës** është 12.000,00 denarë.

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të paraqesin:

- Dëftesë për arsimin e mbaruar fillor (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë të shtetësisë (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- CV

Afati për parastrimin e dokumenteve është pesë (5) ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes.

Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes publike.

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet përmes intervistës me secilin kandidat të paraqitur.

Kandidatët dokumentet e tyre ti dorëzojnë deri në arkivin e Shkollës në adresën rr. “Crvena Skopska Opština” nr. 4 Shkup.

Personi për kontakt – Sonja Simovska, sekretar.

QSHSHMB “Ilja Nikolovski – Luj” – Shkup
Drejtor
Jovan Bicevski

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, alineja 16 dhe nenit 41 të Ligjit për energjetikë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 16/11 dhe nr. 136/11) dhe nenit 20, 21 dhe 22 të Rregullores për licenca për kryerje të veprimtarive energjetike (Gazeta Zyrtare e RM nr. 143/11, 78/13, 33/15 dhe 207/16) Shoqëria aksionare MAKSTIL – Shkup me seli në rr. 16-ta Makedonska Brigada nr. 18, Gazi Babë, Shkup, në vijim publikon:

LAJMËRIM

Informohet opinioni se Shoqëria aksionare MAKSTIL – Shkup më datë 27.02.2018 ka parashtuar Kërkesë për dhënie të licencës për tregti me energji elektrike deri te Komisioni rregullator për energjetikë të Republikës së Maqedonisë të shënuar me numër arkivues UP1 nr. 12-10/18.

Emri i kërkuesit:

Shoqëria aksionare MAKSTIL – Shkup

rr. 16-ta Makedonska Brigada nr. 18, Gazi Babë, Shkup

Lloji i veprimtarisë energjetike:

Tregti me energji elektrike

Rajoni ku do të kryhet veprimtaria:

Veprimtaria do të kryhet në ndërtesën administrative të Çelikanës me PK 2232, objekti afarist nr. 27 hyrja 1, kati 2, zyra nr. 203.

Përshkrimi i mënyrës, objekteve dhe mjeteve për kryerje të veprimtarisë:

Veprimtarinë energjetike, tregti me energji elektrike, do ta bëjmë përmes lidhjes së marrëveshjeve për furnizim dhe dhënie të energjisë elektrike në vend dhe jashtë vendit, marrëveshjeve me operatorët për përcim dhe distribuim dhe shërbime sistemore, si dhe për nevoja personale.

Kohëzgjatja e licencës:

Kërkuesi kërkon licencë me kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vjet.

Afati për parastrimin e propozimeve, mendimeve dhe sugjerimeve në lidhje me Kërkesën për dhënie të licencës:

Subjektet e interesuara juridike dhe fizike mund me shkrim të parashtojnë deri te Komisioni rregullator për energjetikë e Republikës së Maqedonisë mendimet dhe propozimet në lidhje me Kërkesën në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të Lajmërimit për kërkesë në shtypin ditor.

Adresa e Komisionit rregullator për energjetikë të Republikës së Maqedonisë:

rr. Makedonija pn, Pallati Llazar Pop Trajkov, kati i 6, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

SHA Makstil – Shkup
Ivan Banovski, Drejtori gjeneral

“Nuk është fundi i botës. Ulem në këtë karrige dy herë në Ligën e Kampionëve dhe eliminohem me Mançester Junajtedin në shtëpi, në “Old Trafford”, u tha portugezi gazetarëve

Trajneri i Mançester Junajted, Hoze Murinjo, kishte një mbrojtje të çuditshme në ekipin e tij, për fatkeqësinë e Ligës së Kampionëve, duke tërhequr vëmendjen në kohën kur të tijtë e shohin veten jashtë konkurrencës që në 1/8 finale. Vendimi i çuditshëm për të aktivizuar Marouane Fellaini nga fillimi, çka ndodhte për vetëm herën e pestë të këtij sezoni dhe herën e parë që nga nëntori. Një dopietë e Vissam Ben Jedder bëri dallimin për miqtë, me golin e fundit të Romelu Lukaku si një ngushëllim të vogël për “djajtë e kuq”, pas një shfaqjeje të keqe. Por, Murinjo preferoi të shikojë prapa, në humbjet e mëparshme të Mançesterit në duart e tij, në vend se të qëndrojë në këtë dështim të fundit.

“Nuk është fundi i botës. Ulem në këtë karrige dy herë në Ligën e Kampionëve dhe eliminohem me Mançester Junajtedin në shtëpi, në “Old Trafford”, – tha portugezi për gazetarët. – Jam ulur në këtë karrige me Porto-Mançester Junajted jashtë, po në këtë karrige me Real Madridi-Mançester Junajted jashtë. Kështu që, unë nuk mendoj se kjo është diçka e re për klubin. Sigurisht, duke qenë trajner i Mançester Junajtedit dhe duke humbur një ndeshje e kualifikim të Ligës së Kampionëve në shtëpi, është një zhgënjim, padyshim”, shtoi për “BT Sports” portugezi. “Mendoj se goli i parë do të ishte gjithmonë i rëndësishëm, jo vetëm për shkak të rezultatit të

LIGA E KAMPIONËVE, SEVILJA ELIMINON JUNAJTEDIN

NUK ËSHTË FUNDI I BOTËS, ASGJË E RE PËR MANÇESTERIN



parë të ndeshjes, por edhe për profilin e lojës. Ne u përpoqëm të ishim agresivë dhe intensivë që nga minuta e parë. Nuk shënuam

dhe Sevija e mbajti në mënyrë progresive topin, e kontrolloi mirë lojën. Ne patëm shanse të mira për të shënuar, por pësua një gol dhe që nga ai moment gjithçka u bë

shumë më emocionuese. Goli i dytë e bëri të pamundur. Kishim periudha të mira, nuk kemi pasur kontroll të madh në lojë, por nuk mund të them se ka ndonjë gabim te lojtarët e mi. Ky është futboli, kemi humbur, por nesër është një ditë tjetër dhe e shtuna mbart një tjetër ndeshje. Jam i kënaqur që lojtarët nuk e fshehin trishtimin e tyre, por nuk kemi kohë për dramë”, përfundoi Murinjo.

tastik. Ai ka treguar përparimin e madh që ka bërë. Jam i lumtur për të. “Nëse arrijmë në finale? E pra, kemi edhe dy eliminatore të tjera, prandaj më mirë të flasim për ndeshjen e radhës”, – tha transalpini, kur u pyet për “çatinë” e skuadrës së tij.

Ndërkohë, në ndeshjen tjetër të mbremjes së martë, Roma ka arritur të përmbysë humbjen 2-1 të pësuar 3 javë më parë në Ukrainë dhe ka mundur Shakhtar Donetsk 1-0 në “Olimpico”, Verdhekuqtë kanë siguruar kështu një vend mes tetë më të mirave të Ligës së kampionëve. Fitorja e italianëve ka qenë e merituar dhe mund të kishite qenë më e thellë, nëse lojtarët e Eusebio Di Franceskos do të kishin shfrytëzuar isç duhet rastet e shumta të krijuara në pjesën e dytë. Në këtë pjesë ka ardhur edhe goli që ka vendosur sfidën. Kevin Strootman ka dhënë një pasim të bukur për Xheko, me këtë të fundit që nuk ka gabuar dhe ka shënuar duke kaluar topin mes këmbëve të portierit.



ROMELU LUKAKU

Disa gjëra nuk shkuan mirë me disa lojtarë, ndërsa disa lojtarë fshehshin në fushë. Zhgënjimi është shumë i madh, pasi e nisëm shumë mirë lojën, pastaj ua lamë kontrollin e lojës. Kishim disa gjysmë raste, por nuk shënuam dhe pastaj ata shënuan golin e parë. Që nga ai moment u përpoqëm ta ndiqnim ndeshjen, por ata shënuan të dytin dhe ishte goditje e madhe. Në fund ne vazhduam të sulmonim, por nuk ishte e mjaftueshme. Duhet të kishim bërë më mirë për shkak të cilësisë që kemi në ekip, duhet të kishim kaluar tutje. Nuk e meritua sepse nuk ishim të mirë

MONTELLA: ËSHTË NJË REZULTAT HISTORIK PËR SEVILJAN

Trajneri i Seviliës, Viçenzo Montella, mbërriti në dhomën e ndritshme të shtypit në “Old Trafford” tejet i lumtur. “Jam shumë i gëzuar që kam fituar këtu, në një stadium të veçantë. Është një rezultat historik për këtë klub”, – tha ai. “Ne gjithmonë rrezikojmë në punën tonë. Në ndeshjen kundër Valencia, në fundjavë, luajtëm njësoj, por një gabim na dënoi. Sot ekipi ka qenë pothuajse i përsosur. Ben Jedder ka qenë fan-

NUK KA KRYER USHTRINË

Heung-Min Son, dy vjet larg Totenhemit?

Te Totenemi i tremben faktit se mund të humbasin sulmuesin Heung-Min Son për dy vite. Arsyeja? Lojtari nuk ka kryer ushtrinë në vendlindjen e tij dhe sipas ligjit atje të gjithë meshkujt duhet të bëjnë rreth 21 muaj shërbim ushtarak para se të mbushin 28 vjeç. Son e arrin këtë moshë në Korrik të 2019-ës dhe thirrja nga ushtria do ta përjashtonte nga sezonet e 2019-2020 dhe 2020-2021. Megjithatë qeveria e Koresë së Jugut bën edhe përjashtime për “yjet” e sportit, të cilët marrin pjesë në eventet e mëdha. Që do të thotë se, nëse lojtari i Totenemit zhvillon një paraqitje të mirë me Kombëtaren në Botërorin e Rosisë, nuk do ta kryejë ushtrinë.



Shau gjyqtarin, rrezikon dy vite burg

Telashe për ish-futbollistin turk të Interit, Xhaner Erkin. I ardhur në verën e vitit 2016 te skuadra zikaltër, ai u dha në formë huazimi te Beshiktashi, pasi nuk bindi trajnerin Mançini gjatë ndeshjeve miqësore. Por tashmë ai rrezikon deri në dy vite burg, pasi ka sharë rëndë gjyqtarin e ndeshjes në momentin kur është ndëshkuar nga ky i fundit me kartonin e verdhë. Episodi ka ndodhur në ndeshjen e 23 tetorit të vitit të kaluar midis Beshiktashit dhe Bashakshehir. Akuza ndaj Erkin është se ka sharë dhe fyer me fjalë të rënda një funksionar shteti që ndodhej në fushë për të mbajtur rregullin publik. Sipas mediave turke, Erkin do të dalë gjatë ditëve



të ardhshme para një gjykatësi, që më pas do të japë edhe vendimin. Lojtari i Beshiktashit ka mohuar gjithnjë faktin se ai ka përdorur fjalë fyese karshi gjyqtarit, por parësishëm kësaj Erkin rrezikon të kalojë 2 vite pas hekurave, në burgjet turke.



DASHI 21. mars - 20. prill

Ju do të jeni gati të përjetoni momente të mira bashkëpunimi me të dashurin/en tuaj. Nëse jeni çift ju mund të ndani një ditë dedikuar qetësisë. Beqarët do të jenë në gjendje për të nisur aventura interesante, është koha për të bërë njohje të reja. Sot ju do të keni kënaqësi të mëdha në fushën e punës.



DEMI 21. prill - 21. maj

Nëse jeni çift, nuk mund të miratoni disa qëndrime të të dashurit/ës dhe kjo mund të shkaktojë grindje. Beqarët do të mbrohen nga Urani dhe do e ndjejnë veten gati për të nisur histori të reja dashurie. Ju do të keni detyra të reja dhe gjithashtu shpërblime interesante. Ata që kërkojnë punë duhet të përveshin mëngët.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Një ish-e kaluar mund të shkaktojë nervozizëm në marrëdhënien tuaj në çift. Për fat të mirë, Merkuri ju ndihmon dhe lehtëson komunikimin, gjithashtu sqaron çështjet e pazgjidhura. Për beqarët, vijën aventura guximtare, largohuni nga e kaluara. Një lajm i madh vjen së shpejti, një detyrë e re do t'ju japë kënaqësi të mëdha.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Saturni në opozitë mund të shkaktojë tensione me partnerin/en. Sqaroni keqkuptimet dhe përpikuni të krijoni një dialog që do të rivendosë balancën në çift. Beqarët sot mund të bëjnë hapin e parë drejt asaj që mund të jetë partneri ideal/e. Do të jesh shumë komunikues në punë. Zgjidhni disa polemika të vogla me kolegët.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Stresi dhe ndryshimet e humorit do ta bëjnë disi të vështirë marrëdhënien me të dashurin/en tuaj. Por Venusi do t'ju ndihmojë, gjë që do t'ju bëjë të ndjeshëm dhe do t'ju rikthejë harmoninë me partnerin/en. Beqarët do të njohin njerëz të rinj. Mos u ndalini në projektet e nisura në punë edhe nëse gjithçka duket se po shkon mirë.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Thojini një moment stop punës dhe përqendrohuni tek dëshirat tuaja. Nëse historia juaj është lot në të gjitha anët kthe faqen dhe filloni nga e para. Zemrat e vetmuara mund të mbyten nga një pasion i papërmbyshëm, me Uranin e favorshëm do të ketë shumë takime interesante! Jini të kujdesshëm dhe vazhdoni projektet tuaja. Jini më bashkëpunues dhe shmangni mosmarrëveshjet me kolegët.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Planetët janë në anën tuaj dhe ju ftojnë që të jeni më në dispozicion të partnerit/ës. Edhe nëse po kaloni një kohë të vështirë, mos i lini tensionet tuaja te të tjerët. Beqarët do të shohin se miqësia po shndërrohet në tërheqje. Marrëdhënie të shkëlqyera me kolegët dhe eporët, nuk do të mungojnë idetë për të zgjidhur një çështje pune.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Kaloni më shumë kohë me partnerin/en për të gjetur bashkëpunimin. Ju do të ndodheni midis romancës dhe racionalitetit, por nuk mund ta mbani nën kontroll zemrën tuaj. Beqarët do të jenë të pavendosur nëse do të fillojnë një histori dashurie, ndoshta sepse duan të jenë pak të qetë. Me vendosshmërinë tuaj do të jeni në gjendje të zhblllokoni situata të rëndësishme në punë.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Nëse vini nga një zhgënjim dashurie, hapni veten për takime të reja, për shumë prej jush vjen një pasion që do të lërë shenjën e saj. Beqarët do të luftojnë me njerëz romantikë dhe të këndshëm. Merkuri do të nxisë marrëdhëniet me kolegët. Mos i nënvlerësoni disa mundësi të mira për karrierën tuaj.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Me Marsin në shenjë do të jeni të shqetësuar. Nëse jeni një çift i zgjedhur mirë, dëshira për të ecur përpara do të bëjë që të ndërmerri edhe hapa të mëdhenj. Beqarët do të ndihen gati për t'u përballur me ndryshime radikale. Është koha e duhur për të folur për projekte të reja në punë dhe për të nisur bisedimet.




UJORI 21. janar - 19. shkurt

Një ditë ideale për të bërë plane të reja për të ardhmen, jeni në një ekuilibër të përsosur me partnerin/en tuaj dhe çdo dëshirë mund të kurorëzohet. Beqarët do të jenë pak stimulues gjatë kësaj të mërkure, prandaj përpikuni të reagoni edhe nëse ndiheni të nënshtruar. Është mirë që të gjeni dialogun e duhur me kolegët tuaj, por edhe me shefat.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Sot nuk do të ketë grindje me të dashurin/en për arsye të kota, ngulmimi juaj mund të shkaktojë tensione. Nëse jeni një çift i qëndrueshëm, mund të jetoni ditë fantastike. Beqarët do të duhet të zgjidhin një situatë delikate, më mirë të mos marrin vendime të nxituara. Do jeni të gatshëm të pranoni sfida të reja, do jeni të vendosur dhe bindës.



SOT 15 VITE PA TY, GËZIMI, JETA E FAMILJES BULI.


BURHAN JONUZI – BULI

27.03.1982 – 15.03.2003

Edhe pse kaloi një periudhë shumë e gjatë, dhembja e freskët në zemrat tona.

Edhe pse u ndamë shumë herët fizikisht, shpirtërisht nuk ndahemi kurrë, gjithmonë je prezent në mendjen tonë me ato shakatë tua të ëmbla. Të gjithë e mbajmë në vete mungesën tënde, Buli. Asgjë nuk është si më parë, por shpresojmë të çmалlesh me nënën dhe të dashurit tanë që të erdhën pas. Pusho i qetë në amshim, Buli.

E përkujtojnë: Babi, vëllai me familje dhe motrat me familjet e tyre.



NE KETE DATE

Mensur Mamuti	ISH POLITIKANI KOSOVAR NE FOTO	HYJNESHË HITITE	KËNGËTARJA SHQIPTARE, ANXHELA DASHURI AMENORE	P	
LLOJ MAKARONASH, FIDHE	QENGI I BUTË				
M					
MASHKULLI I DELES	MIKROORGANIZËM, SHKAKTAR I SEMUNDJEVE				
V					
JO POSHTË					
HIDROGJENI		INTERNET EXPLORER	ISH PRESID. I AFRIKËS JUGORE, NESLON		
AKTORI SHARIF					
PERËNDIA E BUKURISË TE GREKËT					
KOHA	LOPAR AMERIKAN	KËNGËTARE IZRAELITE, "IM NIN ALU"	METRI	ORGANIZMI QË BEN FRYMËMARRJE AEROBIKE	KËNGËTARJA J ONE, LUMTURIE SHKËPUT, VEÇON
FUNKSIONI I PERSONIT NE FOTO NE ARADHEN PARTIZANE "EMIN DURAKU"					
SHKËLQIMI I NJË STOFI			PERIUDHË HISTORIKE NE JAPONI		
VEPËR E PERSONIT NE FOTO, "... VONOHET			PRISHTINA		AKTORI ZHAN KLOD VAN VOLT
K					
TITULL I PRONARËVE FEUDALË					MONEDHA SHQIPTARE
					AKTORI AMERIKAN, NJUMEN
OHRI		BELGIJKA	SHOK, JARAN	BANJË MJEKIMI	AKTORI AMERIKAN, KROSTOFER
EGZISTOJ				LUMË (SPANJ.)	
				UJË (FRENGJ.)	ASTATI
					U. Q.
KOHA	SMIRË, RESË				VEGËL USHQIMI
	GJ				AUSTRIA
VENDLINDJA E POLITIKANTIT NE FOTO					
					FITIM

ZGJIDHJET: P, FIDE, MANAR, DASHI, VIRUS, LART, H, IE, OMAR, AXHAMI, KOMANDANT, AF, EDO, DAM, KUR PRANVERA, BARONI, LEK, OH, B, SPA, E, JAM, RIO, AT, ZILI, LUGA, GJAKOVA, QAR

Film mbi jetën e Berlusconi



Jeta private e karriera politike e mbushur me skandale seksuale e ish-kryeministrit italian Silvio Berlusconi, vjen në një film. Prodhimi italo-francez, me regji të Paolo Sorrentinos, titullohet "Loro". Në pamjet e para të publikuar së fundi shfaqet një kërcimtare gjysmë e zhveshur përpara Kavalierit. Filmi është një pasqyrim i plotë i periudhës kur ylli Silvio Berlusconi reshti së shkëlqyeri në momentin e tij më të mirë, i tronditur nga skandali seksual "Bunga Bunga", me asokohe 17-vjeçaren marokene e njohur me emrin "Ruby". Disa vajza dëshmuar në procesin gjyqësor se paguheshin nga Berlusconi për t'i bërë shoqëri në vilën e tij private në Arcore. 1 vit më parë, kur Sorrentino përgatiste skenat e para të filmit, mendohej se ishte përshkrimi i një kapitulli të mbyllur, por tashmë që Silvio Berlusconi është rikthyer protagonist në skenën politike, "Loro" është më aktual se kurrë.

Një letër e Karl Marxit shitet për më shumë se 53 mijë dollarë



Një letër jashtëzakonisht e rrallë e shkruar nga filozofi gjerman Karl Marx dhe që mban datën 1 tetor 1879 u shit për më shumë se 53 mijë dollarë në një ankand në Boston (Massachusetts). "Kur u ktheva nga bregu i detit, gjeta kartën tuaj të 23 shtatorit. Do të më pëlqente të më dërgonit disa kopje të "Zbulimit" sepse nuk kam asnjë", shkruante në atë letër Marksi. Publikimi që Marksi aludon qartazi është mbi "Zbulimin e historisë diplomatike të shek XVIII" që u publikua me disa numra në shtyp në gusht të 1856 deri në prill të 1857. Letrat e Marksit janë jashtëzakonisht të rralla dhe jashtë institucioneve inekzistente dhe kjo është e vetmja që kemi gjetur, — shprehet në një komunikatë Bobby Livingston, zëdhënës i ankandit. E njëjta shtëpi ankandi shiti një fotografi të Mahatma Gandhi-t të firmosur nga ai vetë për 41.806 dollarë. Fotografia, në të cilën shihet Gandhi duke ecur bashkë me politikanin indian, Madan Mohan Malaviya pas ciklit të dytë të konferencës së tavolinës së rrumbullakët indiane është e firmosur me penë stilografike me iniciale "MK Gandhi".



Gjermania i vë përballë Rita Orën dhe Dua Lipën

Janë shqiptare dhe mjaft të famshme në skenat muzikore ndërkombëtare. Por duket se midis tyre ka një armiqësi të hershme. Në koncertin e Pavarësisë së Kosovës, ku Rita ishte e ftuar speciale, e pyetur nëse në një të ardhme planifikonte një koncert me Dua Lipën dhe Bebe Rexhën, Rita foli vetëm për Beben, me të cilën ka një marrëdhënie shumë të mirë. Por duket

se për Ritën dhe Duan ka menduar ECHO Awards, ngjarja muzikore e cila do të mbahet më 12 prill në Berlin të Gjermanisë. Në këtë ngjarje dy vajzat shqiptare janë përballë njëra-tjetrës, pasi të dyja janë të nominuara për të njëjtin çmim, "Artistja më e mirë ndërkombëtare". Mbetet për tu parë reagimi i vajzave në momentin kur të shpallet fituesja.

Të jesh inteligjent ka edhe anë negative, mund të vuani...

Studiuesit kanë anketuar 3715 anëtarë të 'MENSA-së', ku të pasurit një nivel të inteligjencës (IQ) mbi 130 është kriter për t'u bërë anëtar, transmeton Telegrafi. Rezultatet e tyre kanë treguar se njerëzit inteligjentë kanë një tru 'hipernervoz'. Kjo do të thotë se truri i tyre është më i alarmuar se çfarë po ndodhë rreth tyre, e kjo ndikon që sistemi i tyre qendror nervor të jetë më reaktiv. Reagimet mund të jenë si frikësimi nga një zhurmë, etj. Shkencëtarët thonë se personat inteligjentë kanë dy deri në katër herë më shumë shanse të diagnostikohen me ndonjë sëmundje mendore - siç është



ADHD, shqetësimi, depresioni, etj - krahasuar me ata të cilët kanë inteligjencë më të vogël. Vlen të ceket se rezultatet e këtij anketimi janë publikuar në 'Science Direct'.

Qeni pret 4 muaj në derën e spitalit, i zoti kish ndërruar jetë



Hachiko është gjallë dhe ai jeton në Sao Paulo të Brazilit! Një qen refuzoi që të largohet nga dera e një spitali në këtë qytet prej katër muajsh dhe arsyeja është prekesë. Qeni priste të zotin e tij, një i pastrehë që ndërroi jetë katër muaj më parë si pasojë e një sulmi me thika. Banorët lokalë thonë se i pastrehu dhe qeni ndanin bashkë të njëjtën shtëpi; rrugën. Ata ishin të pandashëm në çdo hap prej disa vitesh. Fotot e

qenit besnik u bënë virale pas publikimit nga një avokate. "Qeni rri tek dera e spitalit prej katër muajsh. Kur kalojnë njerëz u shmanget me delikatesë pak centimetra dhe rikthehet sërish në pritje të të zotit që ka ndërruar jetë", thotë avokatja. Pak ditë pas postimit të avokates, qeni u dorëzua dhe u adoptua nga një tjetër familje. Kjo nuk është historia e parë që provon besnikërinë e një qeni. Rasti më i famshëm është ai i Hachikos, qeni që priti thajse 10 vite të zotin e tij në stacionin e trenit ku u panë për herë të fundit. I zoti kishte ndërruar jetë papritur. Për të nderuar besnikërinë e Hachikos, në stacionin Shibuya të Tokios është ngritur një statujë e tij, ndërsa historia është përjetësuar në kinema nga Richard Gere në filmin "Hachi: A dog's tale".

44 BC - Jul Cezari, Diktatori i Republikës romake, theret deri në vdekje nga Mark Jun Bruti, Gai Cassi Longini, Decimi Juni Bruti dhe disa senatorë të tjerë romak.

1493 - Kristofer Kolombo kthehet në Spanjë pas lundrimit të parë nëpër botë.

1744 - Mbreti francez Luigji XV i shpall luftë Anglisë.

1812 - Vendbanimi i parë rus në Kaliforni, Lumi rus.

1848 - Fillon Revolucioni i Hungarisë.

1901 - Ndalohej gara me kuaj në San Francisko.

1907 - Finlanda shpallet shteti i parë evropian që i jep grave të drejtën e votës.

1919 - Formohet Legjioni amerikan në Paris.

1939 - Hitleri okupon Boheminë dhe Moravinë (Çekosllovakinë).

1968 - Kryengritje në Jeminin Jugor.

1969 - Kontest i dhunshëm kufitar mes Kinës dhe Rusisë duke lënë 100 të vdekur.

2003 - Hu Xhintao bëhet Kryetari Republikës Popullore të Kinës.

Emocionet tona nuk ndikojnë në mënyrën se si ne komunikojmë. Në fakt, e kundërta është e vërtetë: mënyra se si ne komunikojmë ka një ndikim në disponimin tonë.



Burrat nuk janë më qesharak se gratë: ata thjesht bëjnë më shumë shaka, dhe nuk iu intereson nëse njerëzit e tjerë pëlqejnë humorin e tyre apo jo.



Gratë kanë dy herë më shumë receptorë dhimbjeje në trupin e tyre sesa meshkujt, por ata kanë një tolerancë shumë më të lartë të dhimbjes.



TATUAZHET

Një grua ka si tatuazh mbi gjinj të fytyrat e dy dashnorëve të saj të parë. Natën e dasmës i shoqi e merr këtë fakt me filozofi:

- Po mendoj, pas ndonjë viti sa do t'u zgjatet turiri...



Kam mësuar se vetëm dy gjëra janë të nevojshme për të mbajtur gruan të lumtur. Së pari, lëreni të kuptojë se do të dalë e saja. Së dyti, lëreni t'i dalë e saja!

(LYNDO B. JOHNSON)



KALENDARI HISTORIK 15 MARS



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS